Xhafer Durmishi

SKENDER

DËSHMI E DËSHMORË

Letra, letërkëmbime e publikime të zgjedhura

1.Letër e Xhafer Durmishit shokëve në Shtutgart dhe Zurich
4 qershor 1988
2.HYRJE E LIBRAVE QË DO TË SHKRUHEN ME KËTË TEMË
Letër nga Kadri Rexha për Xhafer Durmishin,, 20 nëntor 2006
3.Njeriun të cilin e ka dashur dhe respektuar më së shumti Remzi Ademi gjatë veprimtarisë së tij në mërgim
4. Kumtesa e Prof. Dr. Abdyl Kadollit, 23 janar 2009
5.Xh.D. Skenderi dhe Kadri Osmani

6.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 30 prill 2009
7.Letër nga Xhafer Durmishi Faridin Tafallarin, 3 qershor 2009
8.RP: ”Besnik Prishtina”, alias Abdullah Prapashtica, 5 nëntor 2009
9.Të vërtetën e mësova sot
Letër nga Begzad Baliu për Xhafer Durmishin, 7 dhjetor 2009
10.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 9 dhjetor 2009
11.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 10 dhjetor 2009
12.Më ke detyruar - kuptohet për të mirën time
13.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 17 dhjetor 2009
14.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 18 dhjetor 2009
15.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 19 prill 2010
16.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 8 korrik 2010
17.Letër për Faridin Tafallarin nga Xhafer Durmishi, 25 shtator 2010
18.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 1 dhjetor 2010
19.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 2 dhjetor 2010
20.Letër nga Xhafer Durmishi për Asllan e Shaban Muharremin,
21 dhjetor 2010

21.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 21 dhjetor 2010
22.I Madhi Zot të ruajtë nga djalli i mallkuar, 20 janar 2011
23. Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 22 janar 2011
24.Letër nga Xhafer Durmishi për Shaban Muharremin, 26 janar 2011
25.Një kallap burri
26.Letër nga Avdi Ibrahimi për Faidin Tafallarin, 27 janar 2011
27.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 29 janar 2011
28.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 19 mars 2011
29.Letër nga Xhafer Durmishi për mbesën e Hoxhë Kadri Prishtinës, 24 mars 2011
30.Letër nga Nevila Nika për Xhafer Durmishin, 28 mars 2011
31.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 1 maj 2011
32.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 10 maj 2011
33.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 24 shtator 2011
34.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 12 tetor 2011
35.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 14 tetor 2011
36.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 18 tetor 2011
37.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 19 tetor 2011
38.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 23 tetor 2011

39.FAZLI GREIÇEVCI DHE SHABAN MUHARREMI
40.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 8 nëntor 2011

41.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 20 tetor 2011
42.Fantazmat e kokave të Partisë Komuniste-PKMLSHJ, 2011
43.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 10 nëntor 2011
44.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 14 nëntor 2011
(Përcjellje e letrës së shokut nga Tirana)
45.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 16 nëntor 2011
46.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 19 nëntor 2011
47.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 21 nëntor 2011
48. Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 22 nëntor 2011
49.Letër nga Xhafer Durmishi për A., shokun e F.Tafallarit në Tiranë,

23 nëntor 2011
50.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 25 nëntor 2011
51.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 26 nëntor 2011
52.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 26 nëntor 2011
53.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 12 dhjetor 2011
54.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 24 dhjetor 2011
55.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 26 shkurt 2012
56.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 4 mars 2012
57.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 26 prill 2012
58.Letër e Xhafer Durmishit për Sabri Novosellën, shkurt 2012
59.Fjalë nga Sabri Maxhuni-Novosella për Xhafer Durmishin, shkurt 2012
60.Shpifjet e shpifarakve

61.Letër nga Shefqet Jashari për Xhafer Durmishin, 13 shkurt 2012
62.Kadri Osmani-E di se është më i miri nga ne të gjithë, 21 shkurt 2012
63.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 22 qershor 2012
64.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 5 korrik 2012
65.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 8 korrik 2012
66.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 18 korrik 2012
67.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 13 nëntor 2012
68.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 1 dhjetor 2012
69.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 15 maj 2013
70.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 5 korrik 2013
71.Pjesë nga një reagim i Faridin Tafallarit kundër Skënder Blakajt,
16 shtator 2014
72.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 11 nëntor 2013
73.Letër nga Xhafer Durmishi për Asllan Muharremin, 11 nëntor 2013
74.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 11 nëntor 2013
75.Letër nga Xhafer Durmishi për Asllan Muharremin, 19 qershor 2014
76. Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 3 dhjetor 2014
77.Faridin Tafallari - Analizë e thellë dhe reale, 2015
78.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 5 maj 2015
79.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 5 maj 2015
80.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 23 korrik 2015

81.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 17 nëntor 2015
82.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 18 nëntor 2015
83.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 30 dhjetor 2015
84.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 30 dhjetor 2015
85.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 21 korrik 2016
86.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 17 korrik 2017
87. Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 18 korrik 2017
88.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 1 korrik 2019
89.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 24 korrik 2019
90.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 8 prill 2020
91.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 2 maj 2020
92.Mendime nga Zeqir Rama, 2 maj 2020
93.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 8 janar 2021
94.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 10 prill 2022
95.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 16 tetor 2022

96.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 16 tetor 2022
97.Mendime të publikuara nga Kadri Rexhaj, 17 janar 2023
98.Mendime të publikuara nga Xhemajl Shatri, shkurt 2023
99.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 3 mars 2023

100.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 13 mars 2024
101.Mendime të publikuara nga Kadri Rexhaj, prill 2024
102. Letër nga Shaban Muharremi, 5 maj 2024

1.Letër e Xhafer Durmishit shokëve në Shtutgart dhe Zurich, 4 qershor 1988

Në këte letër do të shtrojë këtë çështje: Si e mendoj unë qëndrimin tuaj, dhe çfarë do t'i kisha propozuar çdo grupi apo partie kosovare që përpiqet ta vejë në baza të drejta punën e saj në raport me Partinë e Punës të Shqipërisë (PPSH) apo qeverinë e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (RPSSH).

DISA PARIME THEMELORE LIDHUR ME PPSH-në DHE QEVERINE E RPSSH-së

Diskutimi i çështjes së bashkimit kombëtar nuk i takon kësaj teme.
Diskutimi i relacioneve të KSA të Kosovës dhe RPSSH nuk i takon kësaj teme.
Këtu do të shtrojë vetëm ato çështje se si duhet të sillet (sipas pikëpamjeve të mia) një shoqatë, organizatë, grup apo parti kosovare që vepron në Evropën Perëndimore në vitin 1988.

Duke pasë parasysh
-se për çdo grup e organizatë politike të Kosovës, çështja kryesore e politikës së saj të jashtme (dhe ndikimin e saj jashtëzakonisht të rëndësishëm edhe në atë të brendshme) është qëndrimi i saj që do të marrë ndaj PPSH dhe RPSSH,
-se në kushtet që mbretërojnë sot as që mund të bëhet fjalë për marrëdhënie zyrtare të çfardo organizate kosovare ilegale (në mërgim apo brenda) me PPSH-në,
-faktin se përkundër çështjes së lartpërmendur kontaktet e organizatave kosovare jashtë dhe PPSH, si dhe ndeshja e pikëpamjeve të tyre është e pashmangshme, dhe mund të zhvillohen për një kohë të gjatë,
çdo organizate të mirëfillt kosovare i propozoj me sa vijon:

1.Qëndrimi ndaj diplomatëve të RPSSH në Evropën Perëndimore dhe vendet tjera në përgjithësi
Kur unë flas për diplomatët si kapitull i veçantë të kësaj teme, flas jo për atë se ata i vej në një rang më të ulët apo më të lartë se rrethet qendrore të PPSH e të Shtetit Shqiptar, por vetëm e vetëm për faktin se pikërisht përmes tyre ngjajnë kontaktet, fërkimet dhe ndeshja e drejtpërdrejtë e pikëpamjeve për gjërat më të ndryshme.

a) Çështja e kontakteve
-A të jenë ato të rastit apo të organizuara?
-A të jenë kontakte personale apo në grupe?
-A të jenë të shpeshta apo të rralla dhe kujt duhet t'i takoj iniciativa?

Pasi fjala është për një palë me të cilën marrëdhënie zyrtare nuk mund të kesh, dhe kur qe pesë vite ka pasur aq shumë deklarata të qarta se PPSH nuk njeh kurrfarë organizate jashtë, për takime të organizuara nuk mund të bëhet fjalë. Pra mund të flitet vetëm për takime të rastit.

A të jenë kontakte personale apo në grupe? Kjo çështje nuk ka nevojë të precizohet, për të thënë se bënë vetëm kështu apo ashtu. Këtu mund të flitet vetëm për rekomandime (dhe e quaj të rrugës) që të kontaktohet kur të jenë të pranishëm të paktën dy veta. Përndryshe kjo mbetet që secili të vendosë vetë. Duhet pasur parasysh se kontaktet vetëm kur ke të bësh me një problem të rëndësishëm mund të qesin në pozitë të palakmueshme. Unë nuk jamë ithtar i takimeve personale.

b) Çështje e materialeve me shkrim dhe letrave

Në shumicë ata i marrin vesh botimet publike, sikurse edhe të tjerët. Nuk jamë as për fshehjen e një shume të madhe letrash e materialesh që nuk ka nevojë dhe nuk mund të arrijnë të botohen tani. Por nuk bënë të pranohet sa të zbritet gjer në atë shkallë sa kur t'u jipet një material të të thonë: "Ne nuk na interesojnë çështjet tuaja, por meq i keni sjellë ne i marrim. Kushdo që të na jep çfardo qoftë ne e kemi për detyrë që ta përcjellim në qendër."

Prej atyre fshehtësive vitale që janë për një organizatë, të cilat nuk bënë t'i dij askush jashtë (dhe përveç kësaj edhe vetë brenda organizate se si rregullohet ky problem e kujt t'i besohen lidhjet kryesore e emrat e shokëve) nuk ka nevojë të bëhet përjashtim as për diplomatët shqiptarë.

2. Çështja ndaj vizitave turistike në Shqipëri

Nuk ka nevojë të ketë një qëndrim të prerë. Mund të shkoj çdo kush, qoftë vetëm, qoftë në grup apo me familje. Po që se dikush kthehet prej andej me mendime të kundërta për organizatën e vetë dhe lufton kundër saj duke u thirrur në mësimet që i ka marrë gjatë vizitës duke shkaktuar përçarje e huti, duhet pasur parasysh se për një problem të tillë lind nevoja të diskutohet në shtyp. Pra mvaret nga shkalla e problemit, por teorikisht një mundësi e tillë ekziston plotësisht.

3. Shokët në Kosovë dhe qëndrimi ndaj PPSH

Të gjithë shokët në Kosovë njoftohen me qëndrimet e marra lidhur me problemin që e kemi në shqyrtim.

4. Shokët nga Kosova që përkohësisht dalin jashtë

Duhet t'u lihet mundësia që të krijojnë vetë pikëpamjet e tyre. Në rast të kërkesës së tyre, e sipas rastit mund të takohen me diplomatët shqiptarë.

5. Për kontaktet personale

Mbajtja e kontakteve të tilla nuk përjashtohet si mundësi. Eshtë mirë që ato të jenë të rastit. Mbajtja e tyre e rregullt e mosinformimi i shokëve për to konsiderohet punë agjenturore.

6. Mbi çfarë bazash duhet duhet ndërtuar taktika ndaj qëndrimeve të PPSH

Taktika duhet ndërtuar vetëm në bazë të qëndrimeve zyrtare të PPSH-së ndaj problemit të Kosovës. Fjalët jo zyrtare, si "qëndrime personale", si "mendime të kosovarëve në Shqipëri", fjalët e diplomatëve unë jamë për t'i dëgjuar me kujdes, por kurrën e kurrës ndaj fjalëve të gojës e nën ndikimin e tyre të merret ndonjë vendim me shkrim. Eshtë tjetër çështje nëse arrihet në konkluzione të ngjashme që më parë d.m.th. para sygjerimeve të tilla apo në bazë të fakteve tjera.

2.HYRJE E LIBRAVE QË DO TË SHKRUHEN ME KËTË TEMË
Letër nga Kadri Rexha për Xhafer Durmishin, 20 nëntor 2006

Publicistit Xhafer Durmishi me rastin e botimit të librit "Protesta e Aspirata" 1981-1985, Prishtinë, 2006

I nderuari Xhafer,
Librin tënd „Protesta e aspirata" që ma keni dërguar e mora sot. Që në fillim të falënderoj për këtë dhuratë të çmuar (edhe më e çmuar për mua do të ishte me nënshkrimin tënd). Të falënderoj për punën, përkushtimin dhe botimin e këtij libri. Shkrimet tuaja për ato vite të stuhishme, vendimtare për këto ditë dhe për ditët që do të vijnë, kujtimet tuaja për
punën, aktivitetin dhe sakrificën e Jusufit, për veprimtarinë e rrethit të Jusufit në Gjermani dhe më gjerë në Evropë si dhe ato për veprimtarinë e grupeve dhe organizatave tjera në E. Perëndimore ka kohë që i pres. Ato ua ke borxh gjeneratave të kohës sonë dhe historisë. Gjithë ajo punë e bërë asokohe duhet të dritësohet. Brezat e sotme dhe ato që do të vijnë duhet ta kuptojnë se asgjë nuk ka pikur nga qielli. Se as bombat e NATO-s pa ato përpjekje të mëdha të asaj kohe nuk do të zbrazeshin mbi caqet e armikut tonë shekullor.

Nga shfletimi i parë që ia bëra këtij libri mbeta me përshtypje se ky libër do të jetë si hyrje e librave të tjerë që ti do t'i shkruash lidhur me këtë temë. Po marr guximin të flas kështu nga se në këtë libër nuk i pashë të përmbledhur artikujt tuaj të botuar në tre numrat e gazetës "Zëri i Kosovës", organ i LNÇKVSHJ-së, artikujt e botuar në gazetën "Zëri i Kosovës", organ i LRSSHJ-së dhe as artikujt me karakter polemik të botuara në revistën "Zëri". Artikujt tuaj të botuar në shtypin revolucionar të asaj kohe si dhe kujtimet tuaja lidhur me aktivitetin e Lëvizjes gjatë asaj kohe si dhe ato lidhur me qëndrimin dhe aktivitetin e veprimtarëve veç e veç në atë orkestër liridashësish kanë një vlerë të madhe njohëse dhe në të njëjtën kohë do të trajtohen si një dëshmi e paçmuar historike. Se ke talent dhe guxim ta bësh një punë të tillë e ke dëshmuar qysh si i ri. Kur në vitin 1986, në saje të Haxhi Berishës, i kam lexuar të gjithë numrat e gazetës të cilën ti e ke udhëheqë jam mrekulluar, sa e kam thënë, thuaja, para të gjithë ish bashkëveprimtarëve tuaj se "Xhaferi është një nxënës i shkëlqyeshëm i një mësuesi të madh." Këtë mendim e ruaj edhe sot.

Xhafer i nderuar, urime botimin e librit. Uroj që nga dora jote të shohin dritën edhe libra të tjerë.
Me respekt, Kadri Rexha, Altstätten, 20.11. 2006 (Marrë nga libri THIRRJET E KOHËS, i Kadri Rexhës, Prishtinë 2014, faqe 400-401)

3.Njeriun të cilin e ka dashur dhe respektuar më së shumti Remzi Ademi
gjatë veprimtarisë së tij në mërgim

Tungjatjeta zotëri Xhafer Durmishi!, 26 shtator 2007 Prizren

"E di se nuk më njihni. Unë quhem N. Si ish pjesëtar i UÇK-së gjatë ditëve të luftës, por edhe më herët kam pasur nderin që ta takoj Remzi Ademajn, komandant Petriti. Ai më ka folur për

juve shumë herë dhe më ka treguar se ka bashkëpunuar me ju, ndërsa pas ndarjes së grupit ai iu është bashkuar grupit tuaj dhe nuk ka pranuar që të bashkëpunoj me Xhafer Shatrin dhe grupin e tij".

***

Mirë mbrëma i nderuari N., 27 shtator 2007

Më vjen shumë mirë të kontaktohem me njerëz që e kan njohur dhe luftuar me Remzi Ademajn dhe që duan ta nderojnë punën e tij.

Porosinë që ma ke ngarkuar do ta kryej në atë mënyrë që e konsideroj më së miri.

Prej teje do të dëshiroja ta kem një ide rreth afatit kohor. Cilën datë të fundit ti e konsideron të domosdoshme ta kesh të gatshëm shkrimin tim.

Sa për sonte po e përfundoj me kaq.

Përshëndetje

Xhafer Durmishi

***

N. nga Prizreni, 28 shtator 2007

"I nderuari dhe shumë i respektuari Skender!

Sot për mua është dita më e lumtur e jetës sime që nga pas lufta, për faktin se arrita që të lidhem më njeriun të cilin **komandanti im e ka dashur dhe respektuar më së shumti** gjatë veprimtarisë së tij në mërgim."

Kulla e Remzi Ademajt, Zhur

4. Kumtesa e Prof. Dr. Abdyl Kadollit, 23 janar 2009

Prof. Abdyl KADOLLI: "Serbia fillon ekzekutimin pa gjyq të republikanëve shqiptarë: Kadri Zeka, Jusuf e Bardhosh Gërvalla, Rexhep Mala e Nuhi Berisha, Afrim Zhitia e Fahri Fazliu etj. Më 17 shkurt 1982 formohet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, që më vonë quhet Lëvizja Popullore e Kosovës, nga shkrirja e tri organizatave politike: LNÇKVSHJ, OMLK dhe PKMLSHJ."
(Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Demonstratat e vitit 1968, Prishtinë më 24 e 25 nëntor 2008, pashtriku.org, 23 janar 2009)

5.Xh. D. Skenderi dhe Kadri Osmani

NJË ARTIKULL SATIRIK I NIVELIT TË LARTË FILOZOFIK

Kadri Osmani: "Falënderojmë shokun tonë të ilegales e të burgjeve, zotin Xhafer Durmishi (paçka se ende nuk jemi takuar ndonjëherë!), për satirën e stilit të lartë: »Baci, Baca dhe Bacaloku», alias për Ëndrrimtarin-Kryeparin-Bixhozxhiun!!!

Këta janë të "pushkatuarit" nëpër artikujt e mi dhe tuajt, por publicisti Xhafer Durmishi jua gdhendi arkivolet dhe jua nguli edhe gozhdën e fundit! E pas tyre janë turmat pa tru, në të gjitha ngastrat tona shqiptare!!!

Për ata që nuk e dinë serbokroatishten: MUP-i është sigurimi serb!

Shqiptarë të të gjitha vendeve- mençurohuni!" (www.zemrashqiptare.net, 24 gusht 2009)

Shukrija dhe Kadri Mani

Kadri Osmani: "*Unë ta kam heq kapelën për publicistikë, e ti duhet të ma heqësh kapelën për gjuhësi.*" (Fjalë të dërguara Xhafer Durmishit, 25 gusht 2009)

6.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 30 prill 2009

Mirë dita shoku Faridin,
Po ta dërgoj këtë letër lidhur me disa gjëra që folëm.
E ke në filin e bashkangjitur.

Interesant sa shpejt po kalon koha. Po ia nisi së pari me përbërjen e KQ të Lëvizjes në Zvicër/Gjermani në shkurt 1985. Nga leximi i librit tënd të parë dhe dokumenteve të shumta që përmban, ma ka pas marrë mendja se në KQ dhe në mbledhjen e 10 shkurtit 1985 kanë marrë pjesë:
-Mustafë Xhemaili, Emrush Xhemaili, Saime Isufi, Fazli Veliu dhe ti Faridin, por ti ma sqarove se në mbledhje kanë marrë pjesë Mustafë Xhemaili, Saime Isufi, Hasan Mala, Fazli Veliu dhe Faridin Tafallari, ndëra Emrushi ka punua në revistën "Zëri i Kosovës". Mendoj se tani për këto ngjarje dhe protagonistët e asaj kohe të flitet konkretisht pasi veç po bëhen gati 25 vjet nga ajo kohë.

Shumë të fala
Xhafer Durmishi

7.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 3 qershor 2009

Mirë mëngjes shoku Faridin,
Këtu po ta dërgoj shkrimin me disa nënvizime me ngjyrë dhe një letër i ke të bashkangjitura.
Shoku Faridin,

Po të jap disa vërejtje themelore që mi ke kërkuar ndaj shkrimit që ma ke dërguar.
Që në fillim dua të them se jo vetëm ky shkrim por sipas mendimit tim asnjë shkrim tjetër i yti nuk e mbërrin nivelin e asaj që e ke thënë në librin e parë "Terror, dhimbje, qëndresë". Megjithatë unë ende nuk e kam dhënë një mendim të përmbledhur për librin tënd të parë.
Forcë të librit tënd të parë pos tjerash e konsideroj faktin se ti aty Riza Salihut e Hysen Gegës në cilësinë e shokut të Rizahut ua kushton 5-6 rreshta e jo më shumë.
Në reagimin tënd të mëparshëm "Zhgënjim" dhe në këtë që ma ke dërgua shumë qëndrime që i ke pas p.sh. për Hysen Gegën, Riza Salihun e Nuhi Sylejmanin në librin e parë tani i ke ndryshue.

Mendimi im është se me pasojat juridike të librit dhe deklaratave të Ibrahimit do të duhej të merreshin gjykatat dhe jo të tjerët. Eshtë për keqardhje që në këtë drejtim gjykatat dhe juristët e Kosovës nuk janë marrë gjer më sot

Aspektet e ndryshme të luftës për pushtet me mënyra që i përdorin shumica e partive sot mendoj se duhet veçuar nga rasti i 17 janarit 1982.
Unë nuk jam duke u marrë me shkrime, por po të shkruaja në këtë temë do të shkruaja më ndryshe. Nuk i kam hy punës me të dhënë vërejtje në çdo pjesë të shkrimit pasi me atë rast mendimet e tuaja do të ndryshoheshin, tjetërsoheshin tepër. Vërejtjet e rezervimet më kryesore ndaj disa pjesëve i kam ngjyrosë me të kuqe.
Vetëm kur është pyetja tek fjalët e babës së Kadri Zekës, mendoj së në asnjë mënyrë nuk duhet të shkruhet ashtu si e ke mendua. Fjalët e tij me atë rast, nuk janë si ka thënë Ibrahimi edhe pse Saimja lufton me e vërtetue çdo fjalë të Ibrahimit.

Për Nuhi Sylejmanin nuk kisha me shkrua më keq se sa e meriton. Ndaj njerëzve që nuk merren me shkrime dhe ndoshta nuk kanë aftësi për t'u mbrojtur duhet treguar kujdes më të madh.

Kur jemi tek Bujari, nëse ke ndonjë kontakt të mirë në Shqipëri, ta kisha ditë për nder nëse mundesh me e sigurua këtë fakt: Në cilën kohë, prej kur ia ka fillua dhe kur e ka mbarua Bujar Hoxha shërbimin diplomatik në Turqi.

Shumë të fala Xhaferi

8.”Besnik Prishtina”, alias Abdullah Prapashtica, 5 nëntor 2009

Ramadan Pllana, mik i Besnik Prishtinës: ”*Në postën elektronike më kanë ardhur edhe dy letra nga « Nora Gashi », me gjasë një pseudonim yti, ku më « këshillon » e « sugjeron » që ti lexoj të vertetat historike nga* ***« Besnik Prishtina », alias Abdullah Prapashtica****, për këtë kam hulumtuar mirë e mirë dhe jam shumë i bindur se je ti d.v. pas këtij pseudonimi. Në të ardhmën do ta publikojë letrën, nëse ti e mohon këtë fakt!”* (14 shtator 2011)

Shënim: Shkrimi i mëposhtëm është reagim kundër punimit tim ”Organizatat politike shqiptare në Evropë 1979-1985”, punim i botuar në pashtriku.org, i cili vlerësohet shumë lartë nga Kadri Osmani, i cili e publikon në zemrashqiptare.net. Në identifikimin e Abdullah Prapashticës bazohem në citatin e mësipërm të RP - mikut të AP.

Från: Besnik Prishtina (besnik11@web.de)
Skickat: den 5 november 2009 13:49:42
Till: xhaferdurmishi@hotmail.com

XHAFER DURMISHI DËSHMITAR DHE VIKTIMË E INTRIGAVE TË VETA

Psikonaliza

Duke e analizuar këtë shkrim mbi një ngjarjet, vërtet, historike, njeriu ndeshet „me rrobat e pa lara“ të individëve e grupeve, që si mallkim, do të përcjellin çdo lëvizje çlirimtare e përparimtare. Edhe brenda Lëvizjes tonë kombëtare si edhe te Lëvizjet çlirimtare te kombet tjera, ndeshemi me dukuri të tilla të shëmtuara intrigante dhe njeriu ndien një bezdi dhe një mëri ndaj këtyre protagonistëve. Pas psikoanalizës së veprimeve të tyre, për mjerimin e tyre shpirtëror, njeriu ndien edhe keqardhje. Por për energjinë e tyre negative për të ç’vlerësuar përpjekjet titanike të njerëzve të popullit të vet drejtë lirisë, njeriu ndjen një urrejtje të ligjshme ndaj intrigave të tyre.

Lëvizjet e mëdha kombëtare janë si lumenjtë e rrëmbyeshëm të cilët mbeturinat që hedhen në lum, lumi vazhdimisht i fundos ose hedhe përjashta, duke i lan në brigjet të thahen si mbetje që ju merr era, derisa vet lumi e vazhdon rrjedhën e vet. Kështu u sjell edhe lumi i LPK! Autori me dëshminë e vet argumenton linjën e prapaskenave të errëta të një grupi minor ku banë pjesë edhe vet dhe ku përzihen njerëzit e dyshimtë me ata meskin e intrigant për të cilët lufta me armikun sllav është gjithmonë në rendin e dyte, dhe lufta ndaj shqiptarëve, për pushtetin e imagjinuar, gjithmon në rendin e par! Gjatë gjithë këtij teksti shquhet një vi e kuqe e cila zbulon diçka të veçanet për vet autorin e grupin me të cilin ai identifikohet dhe krejt diçka të veçanet për Lëvizjen heroike për të cilën ai flet!

Si studiues profesional kam analizua qe disa vite rrjedhat historike të LPK e të grupimeve tjera politike shqiptare në ish RSFJ. Nga dokumentet dhe dëshmitë me të cilat është ballafaquar historiografia e kësaj lëvizje prej themelimit të LPK me 17 shkurt 1982 e deri me krijimin e UÇK dhe nga ajo kohë e deri në ditët e sotme LPK ka dëshmuar një vitalitet të lartë dhe të respektueshëm. Në ato dokumente e dëshmi, jam ndeshur me vepra e individëve të caktuar që kanë luajtur role me rëndësi për zhvillimin e saj dhe që qëndruan pran saj prej themelimit e deri në ditët e sotme.

Ishte një kategori tjetër që në LPK u kyç për përfitime personale dhe me ambicie karrieriste. Ata i pamë që në rasti e par kur krijua mundësia për të ardhur në pushtet – çfarëdo qoftë ai, pa u arritur liria, pavarësia e sovraniteti i vërtet, u ndan nga LPK dhe u kyçën në Parti Politike të cilat i shndërruan në marioneta të sundimi të huaj.

Por, edhe me veprat e disa individëve që shënojnë përpjekje për pengimin e zhvillimit të saj dhe të cilët lumi i LPK i hodhi si mbetje jashtë saj. Është fakt se LPK me sukses i ka mbijetuar tëra lajthitjet personale individuale duke i tejkaluar me sukses tëra përpjekjet e tyre për shuarjen e saj.

E kam vërtetua:

1) ata që janë marr me rrënimin e saj gjithmon janë marr me intriga ndaj atyre që janë marr me ndërtimin e saj; Dhe
2)ata që janë marr me ndërtimin e saj kurrë nuk i gjejmë duke u marr me të tjerët.

Në këtë shkrim e këtij autori gjejmë fakte të mjaftueshme se si prodhohen intrigat për tu nëpërkëmbur luftëtarët e lirisë

Dokumentet flasin se LPK, pas Lidhjes së Prizrenit, është treguar lëvizja më e suksesshme kombëtare që ju ka qëndrua rrebesheve të sulmeve të armiqve sllav dhe të aleatëve të tyre si dhe rrebesheve të brendshme të lloj- lloj kundërthëniesh. Kjo dëshmon për kursin e drejtë të përcaktuar që në themelimin e saj, që atë e bëri një lëvizje të përgjithshme popullore, të qëndrueshme e cila më nuk varej shumë nga roli i individëve por më tepër nga veprimi kolektiv në drejtim të realizimit pavarësisë përmes të Republikës së Kosovës, si proces i cili është në vazhdim!

Autori vet zbulon prapaskenat e ti dhe të grupit me të cilin ka qen i lidhur dhe me të cilin në fund ai edhe vet bie në konflikt. Kjo dëshmon se ky grup individësh nuk meritojnë analizë politike por analiza psikiatrike, e disa tjerë edhe hetime. Përshkruhen takimet me OMLK në Stamboll, dhe me PKMLSHJ në Ankara, dhe si bëhet përshkrimi banal i takimeve me diplomatët e Republikës së Shqipërisë, me fjalorin e një rrobaqepësi, duke bërë përpjekje për njollosjen e tyre me intriga të kategorisë më të ulëta me motive të mbrapshta dhe pa as një arsye. Aty në të vërtetë del qartë se sa të vërteta dhe korrekte kanë qenë qëndrimet e OMLK, PKMLSHJ dhe të Diplomacisë Shqiptare e sa poshtë ka ra katundi i këtyre intrigantëve. Por, pavarësisht nga kësi lloj individësh del në shesh edhe qëndrimi heroik e patriotik i LNÇKVSHJ e cila i qëndroi besnik bashkimit në LPK deri në ditët e sotme, pavarësisht nga lajthitjet e këtyre personave joserioz, meskin dhe të dyshimtë!

Unë pretendoji se jam shkencëtar dhe për të mos u keqkuptuar për subjektivizmi dhe anim ndaj dikujt personalisht nuk do të përmendi as një emër por do të them atë që gjendet në dokumentet historike nga ku do të marr një shembull, ku flitet se është një njeri i cili si i ri ishte pjesëmarrës i demonstratave të 1968, pastaj themelues i Platformës Politike për Republikën e Kosovës në vitin 1975, ishte iniciatori i bashkimit i organizatave ilegale dhe njeri nga themeluesit dhe anëtar i Komiteti Drejtues të Lëvizjes për Republikën e Kosovës, me 17 shkurt 1982. Ndaj ti u organizuan komplote e atentate nga na e UDB-ës, por ai e vazhdoi me vendosmëri luftën kundër Serbisë e satelitëve tjerë. Me heshtje ju përgjigjej intrigave të këtij lloji ç'far i bënte autori i këtij shkrimi e njerëzit si ai. Ai ishte edhe anëtar i SHP të UÇK, pastaj pjesëtar i Qeverisë së përkohshme të Kosovës të dal nga lufta e 1999. Ishte ky njeriu që nuk u korruptua me postet vasale as të ish RSFJ dhe as të UNMIK-ut por që e vazhdoi rezistencën edhe pas 1999 kundër

sundimit të UNMIK-it, e tani edhe të EULEX, si një ndër aktivistet e Lëvizjes Vetëvendosje, përmes së cilës po vazhdohet rezistenca dhe lufta për realizimin e aspiratave kombëtare që u përcaktuan me 17 shkurt 1982 kur u themelua LPK. Kjo është në pika të shkurta biografia e të vetmit anëtari të KD të Lëvizjes për Republikën e Kosovës i cili ishte edhe anëtar i SHP të UÇK dhe i cili edhe sot vazhdon rezistencën dhe luftën për liri. Ky personi është njeri nga ata persona mbi të cilët thurën intriga edhe nga ky autor. Emrin e ti nuk e nxora këtu sepse qëllimi i shkrimit tim nuk ishte afirmimi i një personaliteti, por afirmimi real i LPK dhe demaskimi i atyre që e shkelën besën dhe që devijuan nga rruga e saj, si bëri edhe ky autor i cili në këtë rrugë u ndal dhe dështoi, e tani dështimin e vet donë disi ta kompozon me intrigat e veta serike ndaj atyre që kurrë nuk u ndalën.

Ramadan Pllana, mik i Besnik Prishtinës: ”*Në postën elektronike më kanë ardhur edhe dy letra nga « Nora Gashi », me gjasë një pseudonim yti, ku më « këshillon » e « sugjeron » që ti lexoj të vertetat historike nga* ***« Besnik Prishtina », alias Abdullah Prapashtica****, për këtë kam hulumtuar mirë e mirë dhe jam shumë i bindur se je ti d.v. pas këtij pseudonimi. Në të ardhmën do ta publikojë letrën, nëse ti e mohon këtë fakt!”* (14 shtator 2011)

9.Të vërtetën e mësova sot

Letër nga Begzad Baliu për Xhafer Durmishin, 7 dhjetor 2009

I nderuar z. Xhafer
Pothuajse çdo ditë në adresarin tim elektronik marr së paku një vepër shkencore apo letrare, por rrallë, tepër rrallë më bie të marrë dokumente të këtij formati dhe të kësaj rëndësie. Në prag të mbrojtjes së magjistraturës nga ime shoqe Myrvetja, "Jusuf Gërvalla - jeta dhe vepra", pata insistuar që të bisedoj me disa kolegë për ditët e fundit te Jusufit dhe i pata bërë, por të vërtetën ja e mësova sot.
Me respekt, Begzad Baliu

***

Shënim: Bëhet fjalë për një dokument autorial të Jusuf Gërvallës dhe jo timin. Parimin që t’ua ofroj veprën origjinale të Jusuf Gërvallës nuk e kam aplikuar vetëm ndaj Begzad Baliut, por ma merr mendja se iu kam përmbajt në kontakt me të gjithë shokët dhe lexuesit.

10.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 9 dhjetor 2009

Lidhur me librin - Me tre yjet e pavdekësisë

Shoku Faridin,
Librit qe sa i rash në fund gjatë leximit të parë, ku kam bërë nënvizime me ngjyrë të kuqe. Me pjesën e parë kam më shumë punë, me të dytën gati aspak (pasi tekstet janë të Jusufit dhe 'Lirisë') kështu që nuk kam as çka shtoj e as çka heq. Me të tretën kam pak punë kah fundi. Sonte do t'iu rikthehem plotësimeve e vërejtjeve që kam bërë duke u nisë nga fillimi dhe besoj se do të shkoj më shpejt se sa të kam thënë.
Unë do t'i bëjë vërejtje si me pas qenë teksti im. Por të mos harrojmë se ky është libri yt, dhe për jetë ka me mbetë i yti. Unë nuk kisha me e shkrua kësisoji në shumë pika, por kjo nuk dihet se cili libër kishte me pas suksesin më të madh afatgjat. Asnjë shkrimtarë serioz nuk mund të përgjigjet me siguri të 100% në këtë pyetje. Sikur të ma kishe dhënë një fjalim në një apo dy faqe A4 unë ndoshta po të ma kishte marrë mendja kisha me ta ndërrua 100%. Në një libër kaq voluminoz, kjo nuk është e mundur, nuk është e nevojshme dhe as e dëshirueshme. Sikur unë

të kem mundësinë me i thënë shumë gjëra të asaj kohe, pra 1979-1982 (apo në ditën kur do t'i them) do t'i thoja më ndryshe. Se si do t'i thoja në pika koncize do të jep idetë e mia.
Përshëndetje e gjithë të mirat deri në dërgesën e librit.
Xhafer Durmishi

11.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 10 dhjetor 2009

Mirë mëngjes Faridin,
Dje, e gjithashtu sot jam çue heret dhe kam punua në vërejtjet dhe plotësimet që kam. Ndaj fjalive që kam vëretje i kam nënvizuar me të kuqe. Se në cilën formë të bësh ndonjë ndryshim nuk të kam dhënë propozim konkret duke e lënë këtë punë ta bësh vet. Komentet e mia për mos me u përzie me tekstin dhe ta kesh më leht i kam futë në korniza. Gjithashtu e kam shkrua një tekst me ngjyrë të kuqe jashtë kornize, që ka të bëjë me shkurtin e marsin 1982.
Shpresoj se shpjegimet e mia do t'i gjesh jo të vështira për t'i zbërthye dhe si fjalë të një shoku që kurrë në jetë nuk ka taktizue jo vetëm me Ty por edhe me askend tjetër.

Shumë të fala
Xhafer Durmishi

12.Më ke detyruar - kuptohet për të mirën time

Letër nga Faridin Tafallari, 11 dhjetor 2009

I dashur shoku Xhafer!
Me ke detyruar (kuptohet ne te miren time) edhe shume me shume te jam i vemendshem per ti ri shikuar materialet e librit te ardhshem qe eshte ne dalje per publikun! Me shume seriozitet po e ri shikoj,dhe lexoje cdo shenim dhe vrejtje te sinqerta. Pra cdo gje e kam te kjart dhe pa dyshim se do ta kem parasysh per nderhyrje te permiresimit. Ndaj me sinqeritetin me te madh te them se as une nuk te zgjodha ty rastsisht...! Te data 29 do ta bej 20, mos ke merak! Ne edhe me tutje do te jemi ne kontaket, ne vecanti per librin ne fjale! Qe mbrem edhe komp e rregulloj nje mjeshter teknik, ne pengesat qe me bente. Te pershendes dhe Uroj te gezosh shendet te mire.
Me shume rrespekt Faridini

13.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 17 dhjetor 2009

Shoku Xhafer!
Shikoje me syrin e fundit dhe jepi mendimet e tua. Une e vecova faqen x mos duhet ndryshe? por nuk do te thot vetem ate, por ne terersi shikoje dhe jepi mendimet e tua, si te kam thene si per vete! Se nga ketu une do ta dergoj per ne botim shkaku i kohes qe po afron. Deshira ime eshte qe libri te dali me 17 janar 2010 qe per pak pune, mos ta vonoj shume!
Pershendetje Faridini

14.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 18 dhjetor 2009

Shoku Faridin,

Mua më vjen shumë mirë që pata mundësinë me dhënë kontributin tim në librin tënd. Në libër ka disa fakte themelore që më mirë se Ti nuk i ka thënë askush. Unë e respektoj qëndrimin tënd dhe zgjidhjet tua, sidomos kur të kihet parasysh aktiviteti yt i pandërprerë. Ta kam thënë që në fillim se disa gjëra unë kisha me i thënë më ndryshe, interpretuar më ndryshe, pasi ato kanë të bëjnë edhe me çështje të koklavitura teorike e organizative dhe marrja me këto ka qenë preokupimi im kryesor në atë kohë. Pra mua do të më duhej të ndalem në disa gjëra më detalisht, duke përdorur mjaft citate e burime që gjenden pikërisht tek libri yt dhe askund tjetër.

Pse po i them këto fjalë? Vetëm e vetëm për të evituar çdo keqkuptim të panevojshëm me Ty apo me të tjerët.

Shumë të fala

Xhafer Durmishi

15.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 19 prill 2010

Lidhur me disa fotografime

Shoku Faridin,

Kisha pasur dëshirë të kem fotografi të mira nga shtëpiat, ndërtesat nga këto adresa:

Höpfigheim
Melchior - Jägerstuben Inh. S.Lojda
Burgunderstraße 4
71711 Steinheim an der Murr, Germany
Tel: 07144 29462
(Në këtë sallë është bërë tubimi i 28 Nëntorit 1981)

Bardhosh Gërvalla
Solitudestr. 44
Ludvigsburg

Murat Kryeziu
Nord-West-Ring 30
70794 Filderstadt (Bernhausen)

Nami Ramadani
Karlsbaderstr. 12
7300 Esslingen

Faridin Tafallari
Haiderbacherstr. 75
7270 Nagold

Nëse mundesh me e bërë ndonjë fotografi të mirë edhe nga "Heimet" dhe qendra e Sindelfingenit do të ishte mirë.

Kjo punë nuk është për ngut. Planifikoje kur të qetë rruga e gjer në fund të këtij viti nëse mundesh me i kompletua.

Shumë të fala
Xhafer Durmishi

***

Më 8 korrik 2010, Faridini m'i dërgoi
-6 fotografi të ndërtesës ku ka punua Bardhoshi, në Solitudestrasse 44.
-6 fotografi të Sallës në Höpfigheim ku është festuar 28 nëntori 1981.
-5 fotografi të Jusufit e Bardhoshit me sharki e çifteli në Hopfigheim,
-6 fotografi të ndërtesës ku ka banuar në Nagold më 1980-1984
-6 fotografi të banesës së Murat Kryeziut në Bernhausen, Nord-West-Ring 30,
-5 fotografi të banesës së Nami Ramadanit në Karlsbaserstr. 12 në Esslingen

16.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 8 korrik 2010

I dashur Xhafer!

Pak me pare ti dergova fotografit e Jusufit me Bardhoshin, ku kane dalur ne bine duke bere muzike per festen e 28 nentorit te vitit 1981, ne sallen e madhe!fotot e baneses time, te Bardhoshit, te Namis, Muratit dhe fotot e salles. Nuk e di sa ia kam qelluar, ai kam bere te mira per perdorim. Pra uroj te jesh mire dhe pune te mbare e te mira ne jete!

Me shume rrespekt Faridin Tafallari

17.Letër për Faridin Tafallarin nga Xhafer Durmishi, 25 shtator 2010

Mirë mëngjes Faridin,

Sa i përket disa mendimeve për Sabri Novosellën po dua edhe njëherë me të ndihmua që të evitoj çdo keqkuptim dhe të mos biesh në gabime shumë parimore.

Ti je betua para Jusufit. Udhëheqësi yt ka qenë Jusufi. Udhëheqësi i Jusufit ka qenë Sabri Novosella. Qëndrimi i Sabri Novosellës më 17 shkurt 1982 në Ankara ka qenë i shkëlqyeshëm. Në këtë periudhë çdo kritikë e fjalë e keqe për Sabriun është gabim i madh.

Në këtë kuptim kam thënë se për Sabriun si udhëheqës të Jusufit por edhe tëndin nuk duhet me e barazua me Abdullah Prapashticën. Nëse ti në këtë pikë e në këtë kohë nuk e respekton Sabriun, atëherë nuk e respekton Organizatën në të cilën je betuar, dhe në këtë mënyrë 100% e bënë të njejtin gabim dhe bien në të njejtën kurthë ku Abdullah Prapashtica e ka futë Nuhi Sylejmanin.

Shumë të fala
Xhafer Durmishi

18.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 1 dhjetor 2010

I nderuar Xhafë,

Që ne fillim ju njoftoi se; është hera e dytë qe e lexoi shkrimin tëndë tejet përmbajtësor dhe shumë argumentues- nga këndëveshtrimi im.Thënë te drejtën,vështirësi në kuptimin e shumë gjërave kisha, dhe ate vetëm për një arsye: Nuk i kam lexue, fillimisht librin e N.Sylejmanit dhe disa shkrime të A.Prapashticës.

Tani, duke u bazuar në shkrimet tua,dhe në informatat e mia të kahershëme. Pastaj duke parë shkrimet e S.X., I.Kelmendit, dhe kur; ju i shtoni ato të N.Sylejmanit dhe nderlidhshëmerinë e tij me A.Prapashticën, ma thot mendja se: "Ju ia keni arritë qe me përpikëmeri ta demaskoni vërtetë Partin Komuniste-PKMLSHJ,e cila pas tridhjet vitesh, më se shumti e ka demaskue veprimtarin e vet diverzante". Tani e kam krejtësisht te qartë se vërtetë çfarë përjetimesh ke pasur pikrisht ti, gjatë gjithë kësajë kohe, dhe te them shumë sinqerisht se; Nga një aspekt jam i tronditur, por edhe i lehtësuar për faktin qe kam pasur nderin të të njoh, të ballafaqohem, të vuaj, por edhe te krenohem për gjithë atë periudhë te lavdishme, por siç po e tregon edhe koha-edhe rrënqethëse.

Pse jam tronditur dhe pse jam lehtësuar shpirtërisht?

Jam tronditur, sepse nuk ma ka marrë mendja që; këta bashibuzuk kan shkuar aq larg në veprimtarinë e tyre shumëftyrshe, dinake dhe aq të poshtër!? Kam menduar se donzhuani I.Kelmendi mund ta ket nga megalomania, e bajraktarizmi, por kur po i analizoi mirë gjërat për këtë njeri , jam i bindur se; bashkë me S. X., N.Sylejmanin dhe A.Prapashticën-janë "një" me bindje dhe "një" me veprime. Këta s'kanë dallim në asnjë pikë! Andaj, lehtësimi me vie nga fakti qe më ne fund doli një i tretë (e qe jeni ju) dhe ua çjerri maskën. Duhet ta dish se afishimet tua janë mirëpritë nga shumë njerëz, e ma se paku nga të lartëshenuarit, sepse ata vërtetë kishin menduar se ti nuk ekziston! Tani le ta gjejnë vrimën e miut, për gjithë ato devijime dhe poshtërsi qe i kanë servuar opinionit shqipëtar dhe më gjërë.

Për të mos u zgjatur më shumë, po i kthehem temës dhe artikullit tuaj.

Pa kurfar hezitimi e ke mbështetjën time, shkrimi juaj është fenomenal. Jam i bindur se këtë çka ju po prezantoni për opinion -vetëm historia do u shpërblej. Kuptohet se unë bazohem në korrektësinë, argumentimin tuaj bindës, (jo me fjalë, po me fakte te shkruara), te asaj kohe nga dorshkrimet e J.Gërvallës, nga dorshkrimet tuaja, Tafallarit etj. Unë shpresoi se të gjitha ato letërkëmbime, vendime e dorshkrime i ke në arkivin tënd, sepse historia u beson fakteve e jo fjalëve apo thashethemeve të ndokujtë. Urojë qe shkrimi juaj te mos jet i fundit, dhe këtë shkrim ta printosh sa ma parë.

Krejtë për fund!

Te falenderoi shumë, qe me dhe mundësinë, te jem një nga ata, qe e lexova këtë artikull para se ta botojsh. Te lumtë për përzgjedhjën e nofkave, për fjalorin shumë te butë n'krahasim se çka kanë merituar.

Të fala shumë -Shabani

19.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 2 dhjetor 2010

Tungjatjeta Xhafë!
E lexova shkrimin e publikuar në Pashtrik. Duhet ta them, qysh në fillim, se më pëlqu shumë. Më pëlequ mënyra e përballjes dhe shpartallimit të zvarranikëve të Partisë famoze dhe të Mjeran Kelmendit. Të lumtë penda!
Përshendetje
Asllani

20.Letër nga Xhafer Durmishi për Asllan e Shaban Muharremin, 21 dhjetor 2010

Mirë dita Asllan e Shaban,
Lidhur me shkrimin e fundit të Ramadanit (19 dhjetor 2010), në një bisedë me një shok kam folë diçka në këtë stil:
"Mendimi im është se unë deri më tash parasëgjithash jam marrë me veprën e Jusufit në Lëvizje dhe jo me vetë Lëvizjen. Eshtë tjetër çështje pse pesha e Jusufit në Lëvizje (LNÇKVSHJ) dhe në përgjithësi është ajo që është.
Kushtet objektive të miat janë asisoji që edhe në vazhdim nuk shoh ndonjë mundësi në perspektivën e tanishme (dy-vjeçare), të merrem me punët e Lëvizjes (për atë masë që ato nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me Jusufin).
Në ketë kuptim nuk është aspak kontestuese se a ka qenë Ramadan Pllana në Komitet Qendror të LNÇKVSHJ në Kosovë. Janë disa pika tjera në dëshmitë e tij që janë pak më delikate.
Ndaj shkrimeve të Ramadan Pllanës të marsit 2009 nuk kam reagua. Nuk jam ngutur, si edhe për shumë gjëra tjera. Ajo që më ka pengua të reagoj ka qenë fakti se shumë shokë kan mund me thënë: Pse po merrem me Ramadanin (shokun e Organizatës) në radhë të parë e nuk po u përgjigjem të tjerëve. Vetë Ramadani më ka kritikua se pse nuk po i përgjigem Abdullah Prapashticës (me atë vendosmëri e menquri që iu ka përgjegjur ai). Kjo vëretje ka mund të më bëhet më parë. Tani ma merr mendja se bash këtë vërejtje është më vështirë me ma bërë."
Në këtë janar i kam disa punime të planifikuara për www.pashtriku.org, të cilat kisha dashtë me ua dërgua paraprakisht për me ua hedh një vështrim para se t'ia dërgoj pashtrikut.
Shumë të fala
Xhaferi

21.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 21 dhjetor 2010

Mirëmbrëma Xhafë,
Pohimi juaj se; "Unë deri më tash parasëgjithash jam marrë me veprën e Jusufit në Lëvizje dhe jo me vet Lëvizjen"-qëndron, është i pakontestueshëm dhe për mendimin tim, ju keni prekë thelbin e veprës së Jusufit në Lëvizje- në te gjitha shkrimet tuaja, shumë argumentuese, bindëse dhe tejet të kjarta.

Nuk ma merr mendja se Dani i ka vrejtë ato pikat delikate qe te tjerët i vrejnë (posaqërisht ti)! Ndoshta, ai është i interesuar qe ndokush t'ia konfirmoj pikë për pikë, çka ai ka thënë!? Ata qe është dashur te flasin, pra te KQ në Kosovë; Metushi, Jusufi (s'mund te flasin), për S.Novosellën e Sh.Jasharin s'kam dëgjuar, dhe s'paku, s'kam lexuar qe ia kanë konfirmuar dëshmitë e tij! Tani disa qe i ka futur si aktivist dhe shokë me A.Kelmendin-i njoh përsonalisht.

Sa i përket faktit qe ti s'je marrë me shkrimet, dhe s'ke reaguar, e as se ke kritikuar R.Pllanën, mendoi, ashtu siç te kam thënë gjat një bisede telefonike se; mund te jet mendim i yti personal se si do te veprosh, me gjithë lutjen qe ta bëra te mos nxitosh. Kam parasysh se dashakeqet tuaj mund ta shfrytzojnë këtë si alibi, nëse Dani "revoltohet" dhe reagon i pamatur ndaj teje, sepse jam i bindur qe ti, Asllani dhe unë i kemi munguar shumë për dëshmitë e tija tek AlbaniaPress.com. Mendoi, se ky njeri, ka pasur nevojë të shkarkohet shpirtërisht, pa menduar se mund te rrëshqas për shumë gjëra.Ti vepro si ta thot mendja jote dhe ruaje pavarësinë tuaj absolute si gjer tani !

Çdo shkrim tuajin e pres me padurim, e pres si një dhuratë dhe privilegjë të jetës sime-privilegjë qe njoha nga fëmijëria familjen Durmishi dhe posaqërisht ty Xhafë.Tani me shkrimet tua, ju po e konfirmoni dhe po e vulosni përjetësisht lidhjen tonë te kahmotshme, tejet të frytshme dhe shumë besnike. Me padurim i pres shkrimet e ardhëshme.
Shmë të fala -Shabani

22.I Madhi Zot të ruajtë nga djalli i mallkuar, 20 janar 2011

Shefqet Jashari: “I dashur Xhafer,
E lexova me vëmendje dhe interesim të veçantë shkrimin tënd: "Flaka e pashuar e Lëvizjes në Intergruppenbach". Ishte një punim shumë i rëndësishëm për t'i rrëzuar për toke gënjeshtrat dhe shpifjet e vjedhësve (hajnave) të historisë. Të përgëzoj për këtë punë të vlefshme dhe të çmuar për Historinë tonë më të re.
I Madhi Zot të ruajtë nga djalli i mallkuar dhe nga djajt-njeri dhe të dhashtë vullnet, forcë dhe energji për t'i luftuar manipuluesit e shumtë, që po bëjnë përpjekje për shtrembnimin e ngjarjeve të rëndësishme të Historisë tonë kombëtare, si dhe mohimin e personaliteteve që ndikuan fuqishëm në ato ngjarje. Me nderime vëllazërore Shefqeti.” (Letër nga Shefqet Jashari, 20 janar 2011)

23. Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 22 janar 2011

Tungjatjeta Xhafë!
E lexova edhe korrigjimin e fundit! Nuk kam vërejtje. Unë kam bindjen se me këto korrigjime nuk ka humbur asgjë shkrimi, përkundrazi do të jetë edhe më i fuqishëm. Edhe këtu , ashtu si në shkrimet e mëparshme në këtë temë, faktet dhe e vërteta ballafaqohen me njëra-tjetrën. Duke i hequr komentet, për mendimin tim, ti i ke dhënë edhe më shumë forcë shkrimit, sepse e gjithë vëmendja përqendrohet në zbardhjen e së vërtetës. Tani ai dhe askush tjetër nuk mund të thotë se qysh më etiketoi jo kështu e jo ashtu, por duhet të përballen me ato që kanë shkruar dhe i kanë servuar lexuesit. Përndryshe unë e kisha dronë se gjithë vëmendja do të përqendrohej kahë mbrojtja nga "sulmet" dhe ballafaqimi me faktet do të ngelej në "safin" e dytë.
Të faleminderit që i ke marrë parasysh vërejtjet e mia!
Përshëndetje
Asllani

24.Letër nga Xhafer Durmishi për Shaban Muharremin, 26 janar 2011

Përshëndetje Shaban,

Versioni i parë edhe ai i dyti e kanë pasur njëfarë mllefi në R. pasi gjërat që i ka thënë ai më kanë befasuar tej mase pasi kemi qenë në një organizatë. Ndërsa kur jemi tek I. Kelmendi dhe Abdullah Prapashtica e të tjerë, asgjë nuk më ka befasuar, janë gjëra që i kam prit dhe përgjigja ime ka qenë shumë më e kthjellët e gjakftohtë se te rasti i R. Krasitjen dhe versionin e tretë e bëra pas ndërhyrjeve të Asllanit por edhe tuat.

Nuk ndihem i kënaqur me i gjet gabime dikujt e sidomos Ramadanit i cili ka vuajt në burg në emër të LNÇKVSHJ. Por R. vet e ka qitë veten në pozitë të keqe. Edhe në qoftë se ka qene i dezinformuar në fillim ai ka mund me i kontrollua disa fakte. Mos harro se punimi i tij është distiluar prej kokës së tij në vitin 2009 e disa gjera i ka përsërit në fund të 2010. Pra janë gjëra që i ka thënë në qetësinë më të madhe që ia ka ofrua Zvicra dhe jo në një gjendje gjaknxehtësie porsa ka dalë nga Kosova. Nga shkrimet e tij e kam kuptue se ai është shumë mendjemadh dhe që ka një përbuzje për rrethin e tij. Ai nuk e ka fijen e respektit për Shefqet Jasharin e Sabri Novosellën të cilët e kanë themelua Organizatën por mundohet me shpik lloj-lloj rrenash të titulluara si "DËSHMI" apo "TË VËRTETAT" se si qenka formuar Organizata kur për këtë punë janë njerëzit e gjallë dhe ai nuk qenë pjesëmarrës. Edhe pse deklaron se ka respekt për Jusufin e Metush Krasniqin, ai thotë rrena në emër të tyre pa e pasur asnjë fakt të shkruar në dorë. Ai ka rrejt për Jusufin duke thënë se bashkëpunimi i tij me Kadri Zekën ka qenë për mrekulli. Ti e ke pa se çfarë përbuzje ka për punën që është bërë në shtëpinë e tij nga gjithë ata njerëz. Ai nuk e ka njohtë as bashkimin e 17 shkurtit e as të 15 majit me arsyetimin se ai bashkim nuk është bërë nga njerëzit më konsekuent të LNÇKVSHJ. Kush është personi më konsekuent që ka mund me folë në emër të LNÇKVSHJ? Ramadan Pllana! Kush është ai i vetmi që nuk kishte me e lejua me shkym flaka e Lëvizjes në Shtëpi të Jusufit? Ramadan Pllana! Pse është shkymë flaka në shtëpi të Jusufit? Sepse ka mungua Ramadan Pllana! Të kishte qenë ky aq i zoti ka mund vetë me iu përgjigj rrenave të Ibrahim Kelmendit pasi, siç e ke pa unë nuk përdori fakte që i disponoj vetëm por që janë publike në librat e Faridin Tafallarit prej vitit 1997 e 1998.

Sa i përket çështjes se zgjerimi i "frontit" edhe me R. mos po u jep mundësi të tjerëve, nuk besoj kurrsesi nëse fjalët e mia janë të vërteta. Nëse unë ia kam arrit me e thënë të vërtetën atëherë këtu nuk ka fije droje. Nëse nuk e kam thënë të vërtetën atëherë të tjerët do ta zbulojnë këtë dhe mund ta shfrytëzojnë dhe ne këtë rast fjalët e mia bien poshtë edhe e vërteta pritet të thuhet prej tjetërkujt. Lufta e ideve dhe formimi i një ideje nuk bëhet me anë të votave në stilin kah është shumica e kah është pakica por në bazë të asaj se kush i ka argumentet më të fuqishme në dorë. Po e përsërisë, sikur ne të kishim pasur Organizatë aktive unë kisha me e ndjekë një taktikë krejt tjetër dhe nuk i kisha shkep shumë rremat. Por tani është kohë e fazë krejt tjetër. Veprimtaria ime aktive në një Organizatë është kapitull i mbyllur. Tani si person që merrem me shkrime është me rëndësi në bazë të aftësive t'i ofroj të gjitha faktet për të kaluarën që e njoh, dhe po që se ia arrij ka mundësi që pasqyrimi im i gjërave t'u shërbej të tjerëve. Po të tregoj se kurrë nuk kam pasur respekt për Abdullah Prapashticën dhe sekretarin e tij, por kurrë në jetë nuk e kam pasur në plan me ua thënë ato gjëra që ua kam thënë. Por jam shumë i kënaqun që ma kanë dhënë shkakun për t'ua treguar vendin e origjinën e tyre të vërtetë.

Shkrimin për Ramadanin pas letrës së fundit të Asllanit se nuk kishte asnjë vërejtje në te, para dy ditësh e kam dërguar tek pashtriku.org. Versionit të tretë në përmbajtje nuk i kam ndryshuar asgjë. Por e kam bërë një ndryshim në renditje. Letrën e Shefqetit e kam vendosur në fund. Po

ta dërgoj pra versionin e fundit që ia kam dërguar pashtrikut. Shkrimi i ka 2505 fjalë. Përveç hyrjes sqaruese teksti i ka 560 fjalë të miat. Çka do të thotë se 78% janë fakte të të tjerëve ndërsa 22% janë komente të mia.

Shumë të fala

Xhaferi

25.Një kallap burri

Nga Xhafer Durmishi

Një tufë fjalësh si urim për 60 vjetorin e lindjes së Faridin Tafallarit, luftëtarit të palodhshëm të çështjes kombëtare, bashkëpunëtorit dhe arkivistit kryesor të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës.

Ideja për përgatitjen e këtij shkrimi më ka ardhur papritmas gjatë kësaj jave kur isha duke e shfletuar librin "ME TTRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME" në kopertinën e mbrapme e vërejta se Faridini i mbush 60 vjet më 1 shkurt të këtij viti. Me këtë deshta të them se ka qenë mendimi im se po që se zotërat dëshirojnë dhe me shëndet të jem mirë, t'u kushtoj vëmendje më të madhe shokëve të Shtutgartit e më gjërë pasi ta kem bërë trajtimin themelor të veprës Jusufit e Bardhit. Në vend të asaj se çka do të sjell e ardhmja po ia filloj e të tashmen.

Faridin Tafallari ka lind në fshatin Struzhë të Prizrenit më 1 shkurt 1951. Jeton në Gjermani nga viti 1973. Deri më ka deri më tani ka botuar 5 libra dhe shumë artikuj të ndryshëm.

Librat e botuara deri më tani janë:

1) Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997
2) Dhimbje Krenare, Tiranë 1998
3) Zot të kësaj toke jemi ne, Prizren 2003
4) Fat Lumbardhi dhe Struzha e tij, Tiranë 2008
5) Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010

Këtu nuk do të hyj në analizimin e veprës së tij të shkruar dhe as veprimtarisë së përgjithshme në shërbim të popullit tonë. Pse?
Sa i përket librave të tij sidomos dy librave të parë Terror Dhimbje Qëndresë Tiranë 1997 dhe Dhembje Krenare Tiranë 1998, unë veç jamë shërbyer shumë dhe jamë referuar e i kam cituar në atë masë që nuk e ka berë deri sot askush më shumë. Personaliteti i kulutrës angleze, dhe njëri ndër kontribuesit më të mëdhenj të gjuhës angleze Samuel Johnson thotë:

"Komplimenti më mirë që mund të ipet një shkrimtari është duke e cituar atë."

Sa i përket aktivitetit politik unë nuk mundem me përfshi sepse ai shtrihet për një periudhë 30 vjeçare, periudhë të cilën nuk kam mund me e përcjell drejtpërdrjet, me përjashtim të leximit të librave, e gjithashtu në një shkrim të shkurtër si ky nuk mund të përfshihet. Por mua ma merr mendja se mund të them diçka më mirë se të tjerët për atë kohë që e kam njohur dhe që kemi vepruar bashkarisht nga gushti 1981 e janari 1982 - mars 1984.



Zade dhe Faridin Tafallari

Për herë të parë Faridinin e kam tekuar në verën e vitit 1981 në studion i punës së Jusuf Gërvallës. Në atë kohë Jusufi takohej çdo vikend me shokët e tij, aktivistët kryesor të Shtutgartit. Kjo ishte njëra anë e çështjes. Ana tjetër ishte se Jusufi, me idetë e tij të pashterrshme që i sillte aktiviteti në çdo hap megjithate gjendjen time në këtë rreth si të ardhur nga Kosova e konsideronte njëfarë freskie për te edhe në atë mënyrë, duke ma dhënë fjalën me dëshirë që të tregoj për gjendjen në Kosovë prej të cllës ai ishte largua para 20 muajsh, periudhë në të cilin kishin ndodhë aq gjëra të mrekullueshme edhe për meritën e Jusufit të cilën jamë aq krenarë që ia kam përcjellë. Në një nga këto ndeja jam njohur me Remzi Ademin, Mejdi Rexhën, Nami Ramadanin, Nuhi Sylejmanin etj. Në një prej këtyre takimeve në shtëpi të Jusufit jam njohur me Faridin Tafallarin me të cilin do të njihesha shumë më tepër pas 17 janarit 1982. Ata që i kanë lexuar shkrimet e Jusufit e dinë mirë se si ka shkruar Jusufi për femrën shqiptare. Por Jusufi kishte edhe disa referime për burrërinë që edhe pse rrallë, me shijen e përsosur të humorit e mirësisë i përdorte. Në tetor 1981 më ka pas rënë të shkoj me te tek një shok gati 200 km nga Shtutgarti. Na ai shok na u dha një ndihmë të cilën nuk isha fare i përgatitur ta prisja. Të nesërmen i thash Jusufit se ndihem shumë i befasuar, për të mirë nga ai aktivist. Jusufi m'u përgjegj: -Ndihesh i befasuar sepse po duket se ty nuk të ka ra ende rasti me ndejtë me burra.

Gjatë punës që bënim në përgatitjen e Zërit të Kosovës, në kohën pauzave e kafeve e pyesja për shokët e Organizatës.

- A ka diçka me rëndësi për mua që kishe me ma thënë për Faridinin? - i thash një ditë.

- Faridini është kallap burri! - mu përgjegj Jusufi.

Këtë shprehjen kallap burri nuk e harroj kurrë pasi Jusufi e ka përdorë rrallë. Të njejtën shprehje e ka përdor kur më ka folë një herë për Peter Platzamanin, që në atë kohë ka qenë Kryetar i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri.

Pas 17 janarit 1982 Faridini dhe Remzi Ademi ka qenë shtyllat kryesore të rrethit të Shtutgartit. Si në rrethin e Shtutgartit, si në Gjermani e jashtë Gjermanisë rrugët më të shumta, gjatë vitit 1982 i kam bërë së bashku me Faridinin.

Me Faridinin kam qenë shok i ngushtë dhe e di si është kur është i tillë kur kemi vepruar së bashku sidomos në vitet 1982-1983. Në vitin 1984 unë u largova nga rrethi i Shtutgartit e Gjermania dhe pas një qëndrimi disa muajësh në Paris u vendosa në Suedi. Divergjencat natyrale dhe artificiale të asaj kohe ndikuan në shkëputjen e kontakteve dhe Faridini u gjet në një mjedis që ishte kundër asaj veprimtarie në qendër të së cilës situata më kishte sjell të jem unë. Si shok e kam parë nga afër. Si person me të cilin rrymimet politike të sjellin në kundërshtime nuk kam pasur rastin ta shoh nga afër për shkak të shpërnguljes time prej Gjermanisë. Zvillimet e peripetitë e jetës ndikojnë që shumë kontakte të shkëputen edhe me persona që nuk ke pasur asnjë divergjencë. Në vitin 1997, i udhëhequr nga dashuria e qëllimi i mirë, ai botoi librin e tij më të mirë Terror-Dhimbje-Qëndresë së bashku me dokumente të rëndësishme të asaj kohe duke ruajtur një shkallë të lartë të objektivitetit për të gjithë shokët. Në këtë libër shkëlqen respekti për heronjtë e vrarë. Nga ky libër megjithate, në këtë rast dua ta analizoj një citat që më duket më i rëndësishmi.

Faridin Tafallari:“Jusufi kur fliste për shokët e vet, i ngrinte ata shumë dhe për veten e vetë fliste shumë i përmbajtur. Shumë herë në të tilla momente, e kam kundërshtuar duke i thënë: “Ne derisa të kemi ty, nuk po na lypen të tjerë.” Por ai ngulte këmbë në mendimin e vet, duke lartësuar shokët e vet në Kosovë." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 28)

Në lexim të parë të duken aq të thjeshta e aq të rëndomta sa mendon se janë fjalët më të përditshme që i dëgjon. Po t'i analizosh më thell dalin një se janë ndër fjalët më të jashtëzakonshme dhe më origjinale, dhe ky dialog prej tri fjalive ka aq shumë përmbajtje, sa të futë në mendime e të shtron aq shumë çështje në të cilat mundesh me hy por nuk e din se ku të qesin. Fjalë e mendime të tilla nuk mund të mësohen e kopjohen nga librat. Fjalë e mendime të tilla t'i jep jeta. Ndoshta edhe mund të thuhet se fjalë e mendime të tilla i flet Natyra kur ajo don të shprehet me gojën e dikujt që ajo e zgjedhë vet.

Marrë guximin të them se krejt historia e jetës njerëzore dhe sidomos ajo e shkruara në këto gjatëmijë vjetët e fundit, në njëfarë mënyre mundet me u mbështjellë apo munden me u bërë shumë e shumë reflektime vetëm nga citati e mëspirëm.

Jusufi Gërvalla (ç'rregullimi e kaosi): Unë nuk jam rendi ideal, unë nuk jamë më i miri, rendin e rregullin më të mirë mund t'ua ofrojnë të tjerët!

Faridin Tafallari: Ti nuk je çrregullimi e kaosi! Ti je rendi, rregulli, stabiliteti e qetësia të cilën e kam pritë dhe kërkuar. Ne derisa të kemi Ty nuk po na lypen të tjerë!

Ne derisa e kemi rendin dhe stabilitetin tënd nuk po na lypen të tjerë.

Edhe pse në dukje e me fjalë nuk e pranon, në të vërtetë Jusufi është ashtu siç e kupton Faridini, përfaqësues i rregullit e rendit duke e lënë derën gjithmonë të hapur për ata që janë më të mirë se ai.

Një shtet, një sistem, apo një perandori e cila me mjetet e saj, me agjentët e saj, me Sadik Blakajt me kompani, i vërsulet një personi siç ka qenë Jusuf Gërvalla, kjo nuk tregon asgjë tjetër përveç faktit se ai sistem, sado i përhapur e kancerogjen që të jetë, e ka të vizatuar shenjën e vdekjes së ballë.

Në emër të luftës për rend e rregull, prishet çdo rend e rregull, bëhen atentate dhe Faridinit me shokë u mbetet tjetër veçse ta vazhdojnë luftën pa qen të sigurt se në cilën kohë, dhe kur do ta takojnë herën tjetër, apo a do ta takojnë fare një person, a do ta arrijnë prap atë ekuilibër, sa të mund t'a përsërisin fjalën, t'a përsërisin besën e kundërshtimin e tyre: Ne deri sa të kemi Ty nuk po na lypen të tjerë!

Është lehtë me e gjetë dikend që din me i rendit fjalët më mirë se sa Faridin Tafallari, - por është shumë vështirë me u gjetë ai të cilit i vlon më shumë zjarri në gji për luftëtarët e lirisë në përgjithësi e sidomos për të vrarët në sulmin serbomadh kundër shtëpisë së Jusuf Gërvallës.

Me Faridinin më ka njoftua Jusuf Gërvalla. Valët e jetës na kan provua në mënyra të ndryshme. Veprimtarët e ndryshëm politik, sidomos ata që veprojnë në emigracion ka shumë mundësi që në situata të ndryshme t'i japin "komplimente" të ndryshme njëri-tjetrit. Pas 25 vitesh (nga viti 1984-2009) nëpërmes Nami Ramadanit ramë në kontakt, i cili më duket se qe shumë i frytshëm në ndriqimin e veprës dhe hisorisë së Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, e cila na lidh aq shumë.

Një meritë e jashtëzakonshme e Faridin Tafalllarit është ruajtja me vëmendje e arkivit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jusgosllavi (LNÇKVSHJ) dhe lëvizjes patriotike në përgjithësi, sidomos të periudhës 1980-1989.
(Kah fundi i janarit 2011)

26.Letër nga Avdi Ibrahimi për Faidin Tafallarin, 27 janar 2011

I shtrenjti shok,Faridin Tafallari

Uroj që të keni shëndet të shkëlqyeshëm Ju dhe familja juaj.Kaloi një kohë që nuk u dëgjuam apo më mirë të them se nga ajo ditë kur u takuam në Tiranë,ditën kur u themelua Shqipëria Natyrale e ideuar nga Koço Danaj me bashkëmendimtar dhe bashkëatdhetar që e duan një shqipëri të përbashkët për mbarë shqiptarët.
Shkrimet tuaja në "Albaniapress",i kam lexuar dhe i lexoj vazhdimisht me knaqësin më të madhe këtë mbase e dini?!Por më ka humbur telefoni mobil dhe bashkë më të më kanë humbur edhe numrat e telefonit dhe kjo qe arsyeja e vtme që unë nuk kam patur mundësi tu telefonoj,mundësisht ma dërgoni numrin tuaj të telefonit me anë të ndonjë mesazhi nga ana e juaj.Nuk është e tëra kjo që po ju shkruaj pse ka kohë që s'jemi parë e dëgjuar.Por sa lexova një shkrim në "Albaniapress", nga xhafer Durmishi të cilin e falenderoj mbi të gjitha që na dha të kuptojmë se ju me 1 shkurt të këtij viti i mbushni 60 vite jete.Që pjesën më të madhe ju e kaluat në mërgim dhe në veprimtari të pandalshme patriotike e atdhetare,ku mes të tjerash heroi ynë kombëtar Jusuf Gërvalla është shprehur se Faridini është"Kallap burri",me këtë shprehje të këtij burri të madh të kombit shqiptar pajtohem plotësisht edhe unë...
Uroj që ju të jetoni sa malet tona,duke e ditur se Ju i nderuari Faridin deri në frymën e fundit të jetës tuaj nuk do të ndaheni dhe nuk do të ndaleni së vepruari për ç'është jen e madhe kombëtare shqiptare...Por edhe ne shokët tuaj te idealeve kemi nevoj pë sugjerimet.për fjalët,për këshillat tuaja të çmuara.
Uroj që të realizohet ëndrra juaj dhe e e jona për SHQIPËRI NATYRALE...Mbeteni shoqërisht të përshëndetur ju dhe familja e juaj nga shoku i juaj i idealeve atdhetare Avdiu me familje.

27.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 29 janar 2011

Përshëndetje Xhafer,

Të kërkoi falje për mbrëmë, qe s'pata mundësi ta vazhdojmë bisedën, por te tregova se e kisha ditëlindjen dhe ishim kah dalim familjarisht, andaj sot po e ndjejë te nevojshme që te paraqitem me pak fjalë.

Një fakt qe nuk po mund ta hjek nga mendja dhe për te cilin jam bindë është se; ka shumë njerëz qe kanë bërë punë vazhdimisht në dobi te atdheut dhe për asnjë çast nuk janë mburrë dhe krekosë, as para atyre qe është dashur ta bëjnë ketë, por qe ka shumë e ma shumë te tillë qe për

një çështje sado te vogël te ketë qenë, e kanë frye dhe e kanë bërë bjeshkë, pa i paraparë konsekuencat qe i kanë bartë më vonë. Pse po ta them ketë? Vetëm po t'i jap disa te dhëna qe je njeriu i dytë (pas Asllanit) qe po t'i zbuloi. Ne kemi hyrë në një fazë qe dashtë e pa dashtë duhet t'i zbulojmë disa gjëra. Pas arratisjes se Asllanit, problemet shëndetësore qe i ka pasë (besoi qe i di), njerëzit qe janë angazhue dhe kanë kotribue qe Asllani t'i shpëtoi burgosjes etj, ai me ka lënë një porosi , sikur ta dinte se më vonë do te ndodhë vërtetë. Pra , duke parë entuziazmin tim , ai me ka thënë qe te kem kujdes se me kë do mund te veproja, e më kë jo. Me që për Sh. Saraçin me ka porositë posaçërisht te kem kujdes, që mos ta rëndojmë shumë sepse ka dhënë shumë dhe gjithmonë ka pasur frikë qe te mos zbulohet puna; se ka qëndrua ilegal te ai gjat ,pothuaj gjithë kohës, por kontaktet i kemi mbajtë gjithmonë (bile shpesh)-kuptohet gjithmonë ilegalisht dhe natën, ashtu siç i kemi pasë me familjen tënde. Kurrë për asnjë çast Sheremetit si kam treguar se merresha me diçka, as Isës. Unë kam vepruar vetëm me disa shokë, por ne ilegalitet shumë te thellë! Kam vepruar me Ferki Morinën, Xhemajl Pllanën dhe Shyqyri Ymeri te gjithë shokë te Asllanit. Lidhje dhe kontakte kemi pasë: Mitrovicë Rexhep Ahmeti dhe Bedri Selmani, Prishtinë nëpërmjet Ferkiut me Behxhet Ahmetin dhe Burim Zagraxhën. Kjo është e tëra dhe se me kë kanë veprue ata te Mitrovicës dhe Prishtinës ata e dinë. Unë vetëm me Mitrovicën kam pasur lidhje, dhe një rast te vetëm; kur Ferkiu ka qenë ushtar e kam pasur një takim te jashtëzakonshëm me Burim Zagraxhën (me kërkesë te Xh. Pllanës), takim qe ka qenë i domosdoshëm. I vetmi njeri me të cilin kam qenë legalisht i ditur ka qenë Ferkiu me te cilin s'ka pasë javë qe s'kemi bërë vizita familjare, apo qe s'jemi takuar në Prishtinë , gjatë studimeve. Është shumë e vërtetë qe unë pasi Asllani lëshoi Kosovën dhe tanimë s'kishte rrezik se mund t'i bënin gjë -jam angazhuar në veprimtari ilegale dhe pas një viti, me 28 nëntor 1984 në familjen e Ferkiut (pas mesnate) e kam bërë betimin dhe jam betuar mbi flamurin kombëtar se do të veproi, do sakrifikohem dhe nëse tradhtoi ,d ënimi të jet sipas shkresës se betimit. Pra si anëtar Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi. Pra, ne e kemi ditë se është bërë bashkimi i LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ , rezultat i së cilës është LRSHJ. Mbi këtë platformë dhe pa u marrë shumë me to ne kemi vepruar deri ne thyerjet e reja dhe më pastaj. Për te gjitha këto ngjarje dhe thyerje kemi qenë te njohur nga shokët Rexhep Ahmeti dhe Shyqyri Ymeri qe kanë qenë në vizitë te Asllani në Suedi. Por veprimtaria jonë nuk ka pushuar deri në suprimimin e autonomisë së Kosovës, kur ngjarjet morën dimensione tjera.

Ta kam shprehur edhe gojarisht (telefon) se meritë qe s'ka kush e konteston se ; pse ne kemi vazhduar punën, janë vetëm dy njerëz: Xhafer Durmishi dhe Asllan Muharremi-çdo lëshim i juaji ka qenë fatal për ne. Koha po e tregon se çfarë niveli përgatitor keni pasë ju dy. Koha po e tregon se; Te gjithë ata qe nuk kanë qenë te kujdesshëm ku kanë përfundue, por, prap koha, argumentet dhe faktet e pamohueshme po tregojnë se shumë njerëz nuk janë mbushur mend se; me burgosjen e tyre s'ka përfunduar çdo gjë, përkundrazi përpjekjet dhe lufta kanë vazhduar, e pse ata s'kanë qenë pjesë pasive e këtyre proceseve , ne s'jemi fajtor!

Asllani me pat lënë edhe një tjetër porosi; Me kë s'duhet , që në kurrfarë mënyre te veproi-s'ka kurrfarë rëndësie , për momentin se cilët janë ata!?

Për këto rreshta qe t'i shkrova nuk mburrem aspak, por krenohem qe këto janë të vërteta, e një krenari e veçant është për shokët e lartcekur, për te cilët e di se ndajnë mendime të njejta.

Po ta zbërthej në pika te shkurta takimin e vetëm qe kam pasë me ata të Prishtinës!

Dy javë para se të lirohet Ramadani, një trakt katër faqesh, të cilin e kam marrë nga Xh. P., është dashur qe ta shkruaj me dorën time dhe ate te Xhemajlit ta zhdukë. Kështu edhe kam vepruar, por trakti me dorëshkrimin tim është përcjellë në Prishtinë te Behxhet Ahmeti nëpërmjet motrës se Ferkiut (i cili ishte ushtar). Nuk e di saktësisht kur, por burgosjet e shumta

qe u banë atë kohë, gjatë bastisjeve në shtëpinë e Behxhet Ahmetit, kur policia ka kërkuar vëllaun e Behxhetit -Nuhiun,është gjetur ai trakt (pamflet) dhe Behxheti është arsyetue se nuk është i tij. Nuhiu ka dalë në arrati dhe pas një kohe ata kanë ardhë ne përfundim qe; më mirë është te dorëzohet ,te dënohet disa vite se sa te ikë jashtë shtetit. Kështu edhe kanë veprue! Në ndërkohë ne u informuam dhe Xhema ka qenë shumë i mllefosur sepse rrezikohesha drejtpërdrejt unë dhe s'munde ta merrte me mend qe pas Asllanit te me ndodhë edhe mua e njejta gjë. Më se keqi i kishim punët se Ferkiu ishte në duarët e tyre (ushtar) dhe Ramadani priste lirimin nga burgu. Unë i pata thënë kategorikisht se; kurrën e kurrës nuk do ikë ! Takimet i kemi pasë pothuaj se çdo natë. Në njërën nga netët Xhema ma shprehi një vendim të cilin unë patjetër duhej t'ua komunikojsha atyre të Prishtinës. Është aranzhuar takimi dhe unë një natë nëntori , natë me shi, jam takuar me Burim Zagraxhën te Fakulteti Ekonomik.

Derisa e kam shqiptuar këtë para Burimit, vetëm shpirti im e di, sepse ishte akuzë e rendë. Burimi një djalë trim dhe i rryer-duke buzëqeshur ma ktheu; "Eu qu paska hy lepuri ne bark heu"! Po me vien keq -ia ktheva, por porosinë e kam të tillë. Mos u brengosni se do ja bëjmë disi etj...etj.

Pas disa kohe Nuhiu është dorzuar, është dënuar 5.5 vjet dhe ne vazhduam pa pasoja. Ferkiu me ka njoftuar se ; punën e traktit e kanë lidhë aq mirë sa qe UDB-eja s'ka mundur t'i bie në fije. Arsyetimi i Nuhiut ka qenë se ia ka dhënë Bajram Bahtiri-ka qenë vrarë në Prishtinë. Ky arsyetim u bë pasi qe unë i pata thënë Burimit se traktin e kam shkruar me dorëza, pra s'kam lënë shenjat e gishtërinjve etj.

Këtë fakt dhe disa te tjera, Ramadani i ka ditë dhe për ate është shprehur në dëshmitë e veta se Xhemajli ka vepruar në ilegalitet të thellë me Ferkiun dhe Shabanin.
- Besoi, se nuk te bezdisë , nëse kohë pas kohe, te njoftoi për ndonjë punë tonën qe kemi bërë ne, si vazhdues te asaj qe keni lënë ju në Kosovë.

- Për kushtet dhe rrethanat në te cilat kemi vepruar ne, është shumë me interes ta dini ju ,por edhe shumë te burgosur, e në këtë rast -ndoshta më se shumti Ramadani !

Shumë te fala nga :
Shabani i Beh Mihaliqit

28.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 19 mars 2011

I dashur Xhafer! Po ta dergoj pergjigjen nga Tirana, lidhur me kerkesen tende. Mua mu duke e arsysme kjo ide e Hanit! Eshte me e arsyshme qe te provosh vet! Pse jo!
Pershendetje F.Tafallari

***

Faredin!
uroj te jesh mire ne çdo drejtim te jetes....persa me shkruan per kerkesat e shokut tend xh.dyrm. po te dergoj adresen e telefaksit dhe te e-malit te znj. NEVILA NIKA, e cila eshte vajza e B. Hoxhes dhe aktualisht eshte drejtore e arkivave shqiptare,(nje grua teper e thjeshte dhe e komunikueshme), me qellimin e mire qe, vete shoku yt te prezantohet me e-mail, per

qellimin e kerkesave te tij dhe gjithashtu, mund te kete perseri ne te ardhmen, per shkrimet e tij qellimmira, kerkesa te tjera, gje qe jam i bindur qe znj.Nevila do t'ja mireprese!!!

Faleminderit per mirekuptimin

SHQIPTARISHT – H.
TELEFAX: 00355 42 22 79 59
znj.NEVILA NIKA ; E- MAIL : dpa@albarchive.gov.al

Lartë: 1. Sali Gjuka, 2. Bardh Isufi, 3. Lal Perolli, 4. Isuf Veseli, 5. Sadik Deçani, 6. Nexho Haxhisadiku, 7. Adush Kastrati, 8. Halim Gostivari, 9?, 10. Bajram Daklani, 11. Tahir Zajmi.
Mesi: 1. Ragip Kajabegolli, 2.?, 3. Qazim Begolli, 4. Hoxhë Kadriu, 5. Hysni Curri, 6. ?, 7. ?
Ulur: 1. Hamdi Zajmi, 2. Jahja Prishtina, 3. Kahreman Begolli, 4. Ibrahim Gjakova, 5. Bedri Pejani, 6. Sadik Gostivari, 7. Nimon Ferizi, 8. Rrok Perolli. Shkodër 1918.

WWW.ZEMRASHQIPTARE.NET

29.Letër nga Xhafer Durmishi për mbesën e Hoxhë Kadri Prishtinës, 24 mars 2011

24 mars 2011

E nderuara Znj. Nevila,

Unë quhem Xhafer Durmishi. Adresën Tuaj e kam marrë përmes Faridin Tafallarit, një shok i imi në Gjermani. Nga viti 1984 jetoj në Suedi, por fillimisht vijë nga një fshat i vogël në periferinë e Prishtinës. Jashtë Kosovës kam dal pas demonstratave Pranverës 1981 dhe kam qëndruar një kohë në Gjermani. Për punët e aktiviteteve tona, në shkurt 1982 kam udhëtuar me aeroplan nga Munihu në Stamboll. Me një shok, më 16 shkurt 1982 në marrëveshje me Babain Tuaj, Bujarin, jemi nis nga Ada Pazari dhe në mëngjesin e 17 shkurtit kemi shkuar në Ambasadën Shqiptare në Ankara. Nga 17 - 22 shkurt 1982 jam takuar vazhdimisht me Bujarin. Nuk po dua me të lodhë më shumë me detaje në këtë rast, pasi qëllimi im ishte vetëm me të treguar se si jam takuar me Babain Tënd.

Kam kujtime shumë të mira prej atyre ditëve. Megjithatë unë jam i vetëdijshëm për faktin se Bujari gjatë jetës së tij është takuar me shumë personalitete të Kosovës dhe institucionet e

Kosovës e kanë shpreh respektin për Te, dhe në këtë drejtim, në krahasim me të tjerët, ndoshta unë e kam vështirë të them diçka të re.

Në këtë rast do të isha mirënjohës nëse mundeni me më ndihmuar me dy gjëra:

1. A ka qenë Bujari në tetor të vitit 1979 në Turqi apo jo?
2. A kishi mund me e skanuar një fotografi-portret të fillimit të viteve 1980-të dhe me ma dërgua.

Nëse ia arrij të them ndonjë fjalë me vlerë do të ishte mirë, nëse jo, gabimi apo e meta do të më binte vetëm mua dhe askujt tjetër.

Shumë të fala
Xhafer Durmishi
Suedi

Bujar Hoxha

30.Letër nga Nevila Nika për Xhafer Durmishin, 28 mars 2011

I nderuar zoti Xhafer,

Shumë faleminderit për emailin tuaj. Është gjithmonë kënaqësi e madhe për mua të lexoj ngjarje apo detaje që kanë lidhje me jetën e babit dhe shokëve të tij.

Përsa i përket pyetjeve tuaja, z. Bujar nuk ka qenë në Turqi në tetor të 1979. Ka vajtur atje në qershor të 1981 dhe është kthyer në tetor të 1982.

Bashkëngjitur po ju dërgoj një fotografi.

Gjithë të mirat!
Nevila Nika

31.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 1 maj 2011

Tungjatjeta, edhe njëherë, Xhafë!

I lexova shkrimet. Jam emocionuar. Më duhet të them se historia Lëvizjes sonë, e veprimtarisë së organizatave dhe e grupeve të luftës sonë nacionalçlirimtare dhe asaj të çlirimit klasor do të ishte e gjymtë pa shkrimet tua. Dorëzimi në dorë të lexuesit të shkrimeve që e thonë të vërtetën, lakuriq e pa dorëza, nuk është vetëm një detyrë qytetare, por edhe një guxim qytetar e akt patriotik. Të lumtë!

Pas këtyre shkrimeve edhe disa "heronj" gjertanishëm e kanë humbur gjumin, sepse lexuesi do t'i kuptoj ata si gënjeshtar, si mashtrues dhe falsifikues të historisë. Paraqitja e së vërtetës për bisedimit në Stamboll dhe sidomos biseda e Jusufit me Kadriun pas kthimit të Kadriut në Gjermani, ku gjithçka del në dritë, ishte një prezantim i shkëlqyeshëm.

Të përshëndes përzemërsisht
Asllani

32.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 10 maj 2011

Tungjatjeta Xhafë!

Mbrëmë e lexova librin e Nuhi Sylejmanit. Më duhet të them menjëherë se ka kohë që s'kam lexuar libër më të dobët dhe më të ulët. Ai është i ngjashëm me librin e Ibrahim Kelmendit, një libër të Sinan Hasanit si dhe librave të tjerë të shkruara në gjuhën serbe kundër shqiptarëve, Kosovës dhe Shqipërisë.

Gjithë libri është një intrigë kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare, por edhe kundër rrethit të OMLK-së, ndonëse Nuhi Sylejmani derdh lot krokodili për Bulen dhe i del asaj në "mbrojtje" kundër "padrejtësive" që i paska bërë Suzana dhe ata që ishin pranë saj e sidomos Skënderi. Përshkrimi që i bënë ngjarjeve dhe shokëve të Jusuf Gërvallës është pak të quhet i ultë, sepse ai është tmerrësisht armiqësor dhe tipik për Shkollën. Asnjë nga shokët e Jusufit nuk është i "hajrit", të gjithë, sipas Sylejmanit, janë të dyshimtë dhe çka jo, por kurrsesi në shërbim të lirisë së popullit të tyre. Po të kishte vetëm një gram patriotizëm dhe atdhedashuri, kjo shkollë, nuk do t 'ju bënte një luftë të këtij niveli rrethit të shokëve të Jusufit. Kështu përbaltet edhe Jusufi. Si mund të jetë i mirë Jusufi që kishte shokë të tillë?!

Përshëndetje
Asllani

33.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 24 shtator 2011

Shumë i nderuar Xhafer,

" Çdo shkrim tuajin e pres me padurim, e pres me kënaqësi, si një dhuratë prej një shoku që familjarisht te njoha nga fëmijëria. Këtë lidhje, Xhafer, e ke konfirmuar dhe vulosë përjetësisht në formë shumë besnike.

Jam i bindur se këtë vepër qe po e prezanton për opinion-vetëm historia do u shpërblej. Kuptohet se unë bazohem ne korrektësinë, seriozitetin, përkushtimin dhe argumentimin tuaj bindës (jo me fjalë , po me fakte të shkruara) te asaj kohe nga dorëshkrimet e Jusuf Gërvallës, nga dorëshkrimet tuaja, Tafallarit etj. Unë shpresoi se te gjitha ato letërkëmbime, vendime e dorëshkrime i ke ne arkivin tënd, apo gjenden tek Faridin Tafallari, sepse historia u beson fakteve, e jo fjalëve apo thashethemeve.

E kam te vështirë te gjejë krahasime, sepse ma merr mendja se ke nivel te lartë kundrejt atyre qe janë përpjekë ta manipulojnë opinionin me të pavërteta".

Krejt në fund; Nga thellësia e shpirtit ju dëshiroi shëndet, lumturi dhe suksese në jetën tuaj plot begati.

Shumë te fala nga
Shabani

34.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 12 tetor 2011

SHOK I RRETHIT TONË

Xhafer Durmishi ka lindur në vitin 1958 në fshatin Stanoc i Poshtëm, i Komunës së Vushtrisë. Nen ndikimin e arsimtareve te tij, të shkollës fillore, angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe e Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi".

Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku i vitit 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart te Gjermanise, duke u bere shoku dhe bashkeluftetari besnik i tyre.

Me Xhafer Durmishin kemi qenë shokë e bashkëveprimtarë të pandarë gjatë kohës që JUSUFI ishte gjallë. Por, edhe pas vrasjes së tij kemi vazhduar veprimtarinë e Lëvizjes bashkarisht, pa u ndarë, deri në vitin 1985, për të cuar në vend amanetin e JUSUFIT. Edhe sot, pothuajse 30 vite pas verës së vitit 1981, na mban afër, si edhe atehere, fryma dhe atmosfera e Vëllezërve GËRVALLA, por dhe e të gjithë atyre shokëve, veprimtarë të paharruar, të asaj kohe.

Deri më sot është shkruar edhe nga të tjerë për JUSUFIN e MADH, por veçanërisht dua të theksoj që, me shumë vërtetësi ka shkruar dhe e ka analizuar me përpikmëri e korrektësi veprimtarinë e tij patriotike e atdhetare, dhe këtë e them fuqishëm, shoku dhe bashkëveprimtari më i ngushtë i Jusuf e Bardhosh Gërvallës, Xhafer Durmishi, i cili, këto shkrime i ka publikuar në faqet mëse atdhetare e tepër serioze të internetit, si -Pashtriku.org- dhe në -Albaniapress.com-, faqe korrekte, të cilat i konsideroj copëza të atdheut tone te shenjte.

Pas vitit 1985 unë isha në qendrën e aktiviteteve në Gjermani e Zvicër, ndërsa kur është fjala për Xhaferin, dukej sikur jeta kishte plane tjera për te, në Suedi....

Vitet kalonin.... Qysh sa ishte në Gjermani, të gjitha dokumentet e aktivitetit të tij i kishte lënë tek unë, ku ishin më të sigurta se sa në dhomën e tij të refugjatit. Në fillim të vitit 1992 të gjitha materialet ia dërgova në Suedi...

Duke e njohur nga afër, së pari si njeri, me cilësi e virtyte të larta edhe si shoku im i mirë, bashkëveprimtar e bashkëluftëtar besnik e i palodhur... por edhe duke i ditur më së miri aftësite e tij...heshtja e gjatë e tij më ka befasuar!?

Por befasia ime ka qenë më e madhe nga niveli, mënyra dhe logjika e trajtimit, të veprës së Vëllezërve Gërvalla dhe aktivitetit të shokëve të atyre viteve, të shkruar e të faktuar me aq realizëm prej tij!

Ndaj unë, si dëshmitar i gjallë e atyre viteve, jam shumë i kënaqur që ky trajtim e shtjellim, i parashtruar në këtë vepër:"Lëvizja e Jusuf Gërvallës", është bërë e shkruar me shumë dinjitet e vërtetësi, me fakte të patjetërsueshme nga një shok korrekt e aktivist serioz i rrethit tonë.

Faridin Tafallari

35.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 14 tetor 2011

Tungjatjeta Xhafë!
Urdhëro e merre atë që të pëlqen nëse ka diç që të. Më lehtë i kisha shkruar dhjetë faqe për librin sesa dy rreshta për ty, djalo!
Nëse pret deri në fund të javës do të kisha ofruar edhe ndonjë rresht tjetër.
Përshëndetje
Asllani

Pasi morëm lajmin për vrasjen e Jusuf Gërvallës, Xhafer Durmishin e përcolla gjer në Stacionin e Trenit në Fushë Kosovë. E takova sërish pas dy vjetësh në mesin e mërgimtarëve të rrethit të Shtutgardit, aty ku ai e kishte takuar për herë të parë Jusuf Gërvallën. Lufta Nacionalçlirimtare dhe veprimtaria pranë Jusuf Gërvallës e kishte rritur dhe ngritur në nivelin e vizionarit dhe të ideologut të Lëvizjes.

***

Libri "Lëvizja e Jusuf Gërvallës" është një kontribut i jashtëzakonshëm për prezantimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare dhe veprimtarisë së saj. Aty do të gjesh përplasjen e pamëshirshme në mes gënjeshtrës dhe së vërtetës, dashurinë për shokun dhe urrejtjen për renegatin dhe tradhtarin, aty do të gjesh shikimin kah e ardhmja e lirë dhe pa shtypje e shfrytëzim.

***

Të pakët janë ata luftëtar lirie që kanë aq dashuri për shokun e aq kundërshtim për gënjeshtarët sesa Xhafer Durmishi. Xhafer Durmishi është vigan i mendimit politik shqiptar.

36.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 18 tetor 2011

I dashur shok Xhafer!

Te jem shume mirenjohes per njoftimet qe me bene per ato ndryshime, sa do qe ato jane te vogela por me peshe te madhe ne librin e titulluar te te madhit Jusuf, "LEVIZJA E JUSUF GERVALLES" jam duke e lexuar me shume interesim dhe me vemendje te perqendruar. Jam shume i gezuar qe e bere kete pune te lodhshme e me shume saktesi e fakte, me shume argumente te pa ndryshuara e as qe diskutohet per dyshime. U a ke mbyllur gojen gojkqijeve dhe te gjithe atyre qe mundoheshin me e shtremberuar e me plot genjeshtra duke e tjetersuar e me te pa verteta, si dhe qellimin e idalin e te te MADH JUSUF! I jam futur me vendosmeri qe ta lexoj ngadal e ngadal ne çdo germ e fjali. Nuk do ta leshoj deri ne perfundim. Ndaj te uroj se pari shume shendet dhe shume te mira ne jete. Te vazhdosh me kesi vepra se per Jusufin kurr nuk behet mjaft per te shkruar e nxjerr ne drite te verteten dhe punen e vepren e tij te madhe e te pavdekshme ne historin e mbare kombit SHQIPETARE!

Shendet e suksse F.Tafallari

37.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 19 tetor 2011

I nderuar Xhafer,

Sonte kam një mal plotë me gëzime! Ashtu siç u gëzova unë, (për te vetmen arsye sepse ju mbaruat librin) gëzimi dhe lumturia te përcjellët për jetë e mot- TY Xhafer! Ti si shok i vërtetë i Jusufit tonë te MADH, arrite t'i vesh pikë një çështje te një periudhe të caktuar. Unë sonte i jap te drejt vetës qe te përgëzoi dhe këtë gëzim ta ndajë me JU. Vepra dhe aktiviteti juaj si shok i Jusufit tregon më se miri se; kush në te vërtetë din qe te ketë respekt për shokët, dhe në të vërtetë ka ditur te merret me veprimtari ilegale, pa zhurmë, pa megalomani dhe pa manipulime. Andaj nga gjithë këto virtyte, nga gjithë ky mund , padyshim se dalin edhe libra kapitale -ashtu siç është edhe libri juaj "Lëvizja e Jusuf Gërvallës". Nuk ma thotë mendja se një fat te tillë mund ta ketë çdo kush! Vet letrat e Jusufit tregojnë respektin ndaj jush, dhe ky respekt nuk ka qenë i rastësishëm, po i merituar. Prandaj edhe libri juaj është aq i fuqishëm, është aq kuptimplotë dhe aq i begatshëm, sa vetëm një shok i vërtetë, të cilit i flet zemra dhe ia thotë mendja , ka ditur të përgatis dhe t'ia jap vendin e merituar një njeriu aq te MADH, e aq bujar siç ishte Jusufi YNË-HEROI YNË.

Sonte, jam i stërbindur se; "Nuk ka forcë qe do te mund t'i luaj faktet dhe argumentet tuaja, nga ata qe tentuan t'i shtrembërojnë dhe ta favorizojnë vetën e tyre, me dashje , apo pa te, nga ata qe në dëm te tjerëve tentuan qe edhe pas kaq vitesh ta mjegullojnë edhe më shumë historinë e Jusufit dhe shokëve te tij". Sonte ,nesër, ndër vite e shekuj do te krenohet populli dhe vet Jusufi me zbardhjen e gjithë atyre rrethanave te mundimshme , te dhimbshme, por krenare dhe padyshim se meritë të veçant kanë shokët e vërtetë te Jusufit ashtu siç ishit dhe jeni ju.
Shumë te fala Shabani
PS-Jam në punë

38.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 23 tetor 2011

Tungjatjeta!
E lexova dhe më pëlqeu. Pyetjet e Ibrahim Kelmendit pasqyrojnë mjerimin e tij, por ato nuk meritojnë përgjigje tjetër nga ajo që ai ka marrë në librin "Lëvizja e Jusuf Gërvallës". Kam përshtypjet se pyetjet e tij janë një përpjekje për ta mbrojtur vetën nga "vdekja" nga plumbat e së vërtetës. Çdo përpjekje për të ta vënë në pikëpyetje origjinalitetin e letrave të Jusuf Gërvallës është përpjekje për ta fshehur dorën kriminale kundër veprimtarisë së Jusuf Gërvallës. Këtë përpjekje ka edhe tendenca për ta përqendruar vëmendjen tek persona dhe ngjarje që s'kanë të bëjnë fare me kohën dhe hapësirën që trajton dhe dokumenton libri "Lëvizja e Jusuf Gërvallës". Ç 'rëndësi ka bie fjala se ç'ka bërë Haxhi Berisha dhe të tjerët pas asaj kohe? Duket se Ibrahim Kelmendi është futur në një rrugë pa krye.
Përshëndetje të përzemërta
Asllani

39.FAZLI GREIÇEVCI DHE SHABAN MUHARREMI

Motra e Fazli Greiçevcit - Hamidja
(nëna e bashkëshortes së Shaban Muharremit) dhe Adem Demaçi

Myrvetja dhe Fazli Greiçevci

Fazli Greiçevci e ka pasur një vëlla-Hamdiun dhe gjashtë motra:

-Nailen-(nëna e poetit Ymer Elshani), e cila së bashku me Ymerin e me familje dhe afro gjashtëdhjetë bashkëfshatarë u masakruan më 17 prill 1999 nga forcat serbe në fshatin Poklek të vjetër të Drenasit;

-Rrahimen, Halimen, Mehremen, Hatixhen dhe Hamiden.

-Hamidja është nëna e Luljetës - bashkëshortes së Shaban Muharremit.

Shaban Muharremi nën hijen e Luljetës-mbesës së Fazli Greiçevcit

***

40.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 8 nëntor 2011

Shoku Faridin,

Falemnderit për njoftimin e fundit që të kishte ardhur nga Shqipëria rreth atyre fjalëve të marruna nga libri.

Kësaj radhe i kam këto kërkesa rreth disa artikujve nga Zëri i Popullit, pasi më intereson përmbatja apo ndonjë citat i rëndësishëm që mund të gjendet aty.

Artikujt nga Zëri i Popullit janë:

1. Një kryeartikull nga Zëri i Popullit: Nuk më kujtohet data e sakt se kur është botuar e as muaji, por e di se është nga periudha janar-shkurt 1980. Thelbi i këtij Kryeartikulli është se Partia e Punës deklarohet lidhur me invadimin e Bashkimit Sovjetik në Afganistan i cili është bërë më 24 dhjetor 1979 (tri pas arritjes së Jusufit në Ludwigsburg). Në këtë Kryeartikull Partia e Punës deklaron se në rast se Bashkimi Sovjetik e sulmon Jugosllavinë, populli shqiptar do të luftoj bashkë me popujt jugosllav kundër okupatorëve rus. Në mbështjetje të këtij Kryeartikulli Jusufi e shkruan artikullin e tij ZËRI I POPULLIT - ZË I TË GJITHË SHQIPTARËVE. Ky është, në këtë rast një shkak i madh pse kisha dashtë ta kem të plotë këtë kryeartikull. (Këtë Kryeartikull ndoshta nuk e ke por kontaktet e Tua në Bibliotekën Kombëtare kishin mund me e gjetë lehtë dhe me e skanua atë.)

2. Kryartikulli i 8 prillit 1981 që ka të bëjë me ngjarjet në Kosovë,

3.Kryeartikulli i 23 prillit që ka të bëjë me ngjarjet në Kosovë. (E kam përdorë fjalën kryeartikull se nuk po më kujtohen titujt. (Këtu po të tregoj se kryeartikullin e 17 majit 1981 e kam, se mos ta kisha pasur edhe atë ta kisha kërkua.)

4. Një artikull apo ndoshta edhe kryeartikull i Zërit të Popullit, i datës 12 shtator 1981, që ka të bëjë me ngjarjet në Kosovë dhe që është shkruar apo nënshkruar me emrin ARBËR KORABI. (Për këtë artikull flet Jusufi në fjalimin e tij në festën e 28 nëntorit 1981 në Höpfigheim.)

Qëllimi im është që kishim mund me e përgatitë një punim të mirë për raportin e Jusufit, penës së tij me Zërin e Popullit.

Shumë të fala
Xhaferi

41.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 20 tetor 2011

I dashur shok Xhafer,
po po sa e hapa kompjuterin e pash dhe e lexova letren tende, dhe po sa e lexova letren e hapa faqen te pashtriku.org, qe nga fillimi e deri ne mbarim ia leshova syte, mu duke shume i bukur, mu duk sikur iu gjeta me Jusufin e Bardhin bashk, bash ashtu sikur se u takuam heren e pare ne veren e vitit 1981, u gezova shume....shume bukur e ka botuar sheradini i lumt edhe atij.

42.Fantazmat e kokave të Partisë Komuniste-PKMLSHJ, 2011

Është zhdukur nga skena publike para 30 viteve

Abdullah Prapashtica: ”Fillova të shkruaj posa u njoftova nga miqtë e mi se një, ta quajmë “Durmish” paska botuar një shkrim, ku me një konstruksion të rrejshëm flitet se unë jam marrë me “çështjet e brendshme të ish LNÇKVSHJ” dhe ku pos që përmendet emri im, kjo përcillet edhe me ofendime debilitante. E morra dhe lexova atë shkrim të bezdisshëm dhe e pash se ky individ që **është zhdukur bukur moti nga skena publike**, sërish paska dal në skenë edhe ma destruktiv se **para 30 viteve!**” (ATA QË MERREN ME INTRIGA KUNDËR LUFTËTARVE TË LIRISË OSE JANË TË ÇMENDUR OSE JANË TRADHTARË, albaniapress.com, 2 maj 2011)

Për tridhet vjet rresht ç'vlerëson, përgojon, njollos, shpif, e keqinterpreton për njerëz të tjerë

Osman Osmani: "Libri i Xhafer Durmishit për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës, me sa pash kalimthi, lenë përshtypjen se nuk qenka libër për "Lëvizjen e Jusuf Gërvallës", por për të shfryer edhe më tej komplekset e veta të pashëruara në vazhdimësi Xhafer Durmishi. Xhafer Durmishi si duket e konsideron edhe më tej për patriotizëm dhe veprimtari atdhetare, nëse ndër të tjera sipas tekave dhe dëshirës së tij për **rreth tridhet vjet rresht (ç)vlerëson, përgojon, njollos, shpif, e (keq)interpreton për njerëz të tjerë,** me të cilët ka pasur fatin apo fatkeqësinë të ketë punë shumë shkurt, e me disa nga ta ndoshta i ka rastisur të takohet vetëm njëherë të vetme në tërë jetën e tij. Ai për të mbuluar të vërtetën rreth vetes dhe veprimtarisë së tij të ditur e të paditur, apo ndoshta edhe për të intriguar me porosi ku me dit se të kujt, shërbehet me emrat e patriotëve dhe atdhetarë të dëshmuar, siç është rasti p.sh. me emrin dhe veprimtarinë e të mirënjohurit Jusuf Gërvalla.

Vesi dhe kompleksi i pashëruar i Xhafer Durmishit ngjan të ketë kaluar në sëmundje kronike. Me keqardhje dhe me indinjatë them, të shpresojmë se do të bëjë më mirë!" (Facebook, 20 tetor 2011, ora 21:19)

43.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 10 nëntor 2011

(Përcjellje letre e shokut nga Tirana)

Faredin,
Gezohem shume qe u degjuam se, kishim kohe qe nuk kishim komunikuar, por edhe qe jeni mire me shendet, edhe ne ketej nga Tirana,ne kete vjeshte - pranvere, jemi mire, mezi presim qe te freskohet pak moti!? Persa me shkruan per kerkesen e atyre artikujve, do te perpiqem te ta plotesoj por duhet te dish qe me duhet pak kohe sepse jane disa procese per kerkimin e artikujve ne fjale, fotokopjimin etj... E them kete se, ti shoku yne e di fare mire se, nuk "pertojme" kurre per Ty, sepse ke lene gjurme te forta burrerie tek ne,si njeri me karakter fisnik e nje shqiptar i vertete i Kosoves, pra i beses, dhe jo si shume te tjere,madje emra te njohur, qe e kane "dredh" pa pike turpi,dhe na kane "harru"...dhe i kane kthy shpinen jo vetem "xhaxhit" (a e di or mik,qe sot po e kerkojne"xhaxhin" dita dites e me shume ketu tek ne), por edhe Shqiperise e Kosoves! T e kujtojme shpesh edhe ne bisedat me H., sepse,mesa duket, ne kete bote te trazuar kudo antivlerat po zevendesojne vlerat, prandaj nevoja per miqte dhe shoket e vertete po kerkohet shume dhe Ti je njeri prej tyre!
Gjithe te Mirat! Mireudegjofshim!
A. – Tirane

44.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 14 nëntor 2011 (Përcjellje e letrës së shokut nga Tirana)

Z.Faredin!...Sot e mbarova porosine tende per artikujt e gazetes Z.P.! U vonuan ca... dhe u mundova pak sepse, per fat, B.K. eshte ne konstruksion, keshtu qe fale respektin per ty, por dhe vendit qe kam atje, u perpoqen qe ne mes te atij pluhuri e remujes se madhe te rinovimit te fondeve, te me nxirrnin koleksionet,qe ju kerkova...Sic te kisha vene ne dijeni,artikujt ishin

shume voluminoz,keshtu qe edhe fotokopjimi i tyre qe mjaft i veshtire...ato nuk mund te dergohen me asnje rruge tjeter, perveçse postimit te fotokopjeve te tyre!...Prandaj te lutem te me shkruash adresen e sakte, se per ku duhet t'i dergoj (postoj)!

Gjithe te mirat!

A. - Tirane

45.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 16 nëntor 2011

Shok Xhafer! Kete leter e cila i perkushtohet librit tend "Levizja e Jusuf Gervalles", po ta dergoj edhe ty. I thash edhe Mires, se dot ia dergoj edhe autorit Xh.D. A. me shkruan edhe per kopjet e Z.P. se dje i ka postuar ne adresen tende...I lexova edhe ato 8 shkrimet qe i ke botuar ne albaniapress, dhe ne librin "Lvizja e J.G." ishin te forta...por sipas mendimit tim ka nevoj akoma per te shkruar rrethe drames...

Pershendetje F.Tafallari

***

Miredita Faredin,

Shkak per te te shkruar sot, u be libri i shokut tend "Levizja e J..." i botuar ne faqen -Pashtriku- ...Si perhere, qe i ndjek me vemendje te gjitha shkrimet e - Albaniapressit- dhe te -Pashtrikut-, ne veçanti te shokeve te idealit, pra ato per Jusufin tone, e lexova me kureshtje edhe librin e Xh.D. te -Pashtriku -! Ndoshta, dhe ashtu eshte, qe une nuk jam aq e afte sa Ju, te "gjykoj" mbi ate veper te shkruar nga shoku dhe miku yt Xh, sepse Ju i keni kaluar,i keni jetuar realisht ato per cfare shkruan autori, per te cilin, gjate bashkepunimit tone, si mua, A. dhe H., pra grupit tone, Ti na e ke prezantuar, ate burre,si nje njeri te mire, te afte dhe si shoku yt i vertete! Dhe nuk ka se si te ishte ndryshe, per Ty or mik, qe je nje njeri fisnik, aspak xheloz, burre i vertete, shqiptar i beses!

Faredin, nuk mohohet se, Ju, se bashku me shoket i keni kaluar mbi supe ato vite te veshtira, por qe t'i ruash me aq fanatizem ne kujtese dhe me aq perkujdesje ne arkivin tend personal, sic ke bere Ti, aq me teper t'i pasqyrosh me vertetesi ne nje liber dhe ne shkrime te sakta ato ngjarje, sidomos ne ditet e sotme, ku po ndodhin lloj lloj "percudnime" e shtremberime historike, nga disa pseudoshkruesa te historise... eshte nje detyre patriotike, nje sherbim i cmuar per kombin dhe vendin tend,madje do te thosha nje merite e pakontestueshme per nje atdhedashes te vertete, qe i dhemb me tamam Jusufi, atdheu, kombi!

Megjithese pata pak veshtiresi si fillim per te kuptuar stilin e te shkruarit te autorit,(per mua ai ka nje stil te veçante te te shkruarit) me tutje u mesova... u kuptova shume qarte me faktimin konkret e te sakte te ndodhive, te ngjarjeve te personazheve, te referencave, te shume emrave, ku shume prej tyre sikur ishin te njohur per mua (kjo me siguri per shkak te librave te tu) me vertetesine e pershkrimit, nje pune vertet voluminoze e Xh.D, por ama qe ja vlen shume! Pra nje liber historik me vlere reale e konkrete, i shkruar me "kembe ne toke", me nje perkujdesje dhe vemendje te veçante, per nje veprimtar te mencur e te matur, per nje personazh historik, hero te kombit, per te cilin nuk me hiqet nga mendja ai vleresimi lapidar i yti, teper teper i goditur per Jusufin : "Askush nuk mund ta zevendesonte....". Mendoj se perballe VERTETESISE se VERTETE, te asaj se per cfare "flet" ky liber, pra per cfare e pergjithcka qe "flet" Xh.D. per Jusufin, per Levizjen e J.Gerv. zor se do te "guxoje" te reagoje ndonje "trimosh", sidomos nga ata "gjelat maj plehut" qe Xh.D i permend ne liber!!!

.. Nje gje qe me la nje pershtypje shume te mire dhe me thene te drejten ndjeva kenaqesi, eshte se Ai, shoku yt, qe ne fillim te librit te tij te referohet Ty,librave te tu,...dhe kjo vazhdon

pothuajse ne te tere kapitujt e librit... A e sheh se cfare thesari, floriri i vogel je Ti or malsor i Struzhes? (keshtu te ka thirr H. a e kujton ndonjehere?) , Edhe pasthenia, e shkruar prej teje, me shume modesti, ashtu sic je Ti, njeri modest, eshte domethenese ne ato qe ke shprehur per Xh.D.

Pershendetje – N.

46.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 19 nëntor 2011

Shoku Faridin,

Më erdhi mirë që edhe shokëve në Tiranë u paska pëlqye libri. Se ata i kanë pasur të njohura librat e tu në hollësi është një ndihmë e madhe. Se puna jote do të duket edhe më qartë, në drejtësinë e saj, jam gjithmonë i sigurt.

Edhe njëherë i falenderoj shokët për ndihmën që po na e bëjnë. Posa të më vijnë artikujt, do ta kompletojë punën time, rreth jë punimi, i cili besoj do të jetë e gatshëm para Vitit të Ri.

Shumë të fala

Xhaferi

47.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 21 nëntor 2011

Shoku Faridin,

Sot më erdhën, me letër rekomandë, artikujt e "Zërit të Popullit". I falenderoj shumë shokët në Tiranë, dhe Ty për ndihmën.

Një nënvizim të vogël: sa për njoftimin tënd deshta të them se, kur është fjala tek artikulli "KUSH E NXIT ARMIQËSINË MIDIS POPUJVE TË JUGOSLLAVISË" i datës 23 prill 1981, mungon ajo pjesë që është botuar në faqe 4 (mungon faqja 4 e artikullit). Tek unë ka ardhë vetëm pjesa që gjendet në faqe 3. Ndoshta teksti nuk është aq i gjatë që gjendet në faqe 4.

Me këtë nuk po kërkoj me i lodhë shokët në Tiranë, por nëse publikohet puna ime do të kuptohet se më ka munguar një pjesë.

Pavarësisht nga kjo, unë jam shumë i kënaqur dhe shumë mirënjohës për artikujt e dërguar të cilët besoj se një kapitull të punës, të cilën e kam filluar më heret, do ta bëjnë të plotë.

Pasi më erdhën në kohë shumë të mirë, planifikimi im është që Sheradinit t'ia dërgoj një punë gjatë kësaj jave, pra para 28 Nëntorit.

Shumë të fala

Xhaferi

48. Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 22 nëntor 2011

Shok Xhafer, ne se eshte keshtu si po shkruan A., me thuaj e mos ti dergoj te tjerat. Perndryshe une tash pas dite do ta dergoj ne se ti nuk i ke.Pershendetje

Zoteri Durmishi!
....Ne dergesen tone tek Ju, pra per artikujt e kerkuar nga z.Tafallari, pjesa e pare, pjesa e faqes 3 e artikullit ne fjale:' "Kush e nxit...." eshte fotokopjuar dy here, per shkak se njera kopje nuk na doli edhe aq mire, pra tek ju jane derguar dy kopje te faqes 3 dhe nje kopje e faqes 4, pra e vazhdimit te ketij artikulli ne faqen 4!!!! Keshtu qe nje kopje E KETIJ ARTIKULLI eshte pa faqen 4! "gabimi yne" eshte qe ne nuk e hoqem kete kopje "gjysmake",menduam se mund tu hynte ne pune edhe kjo pjese!? Madje ju shkruan nje sqarim te vockel,qe Ju ta shihnit me shume kujdes ate bashkimin tone "primitiv" te artikujve te kerkuar nga Ju...dhe te derguar nga ne, ne ato kushte te veshtira per shkak te rinovimit te B.K!!!! Megjithate nese nuk e "gjeni" ne dergesen tone do te perpiqemi perseri tu a dergojme,meqenese jeni mik e shok i Tafallarit!!! gjithe te mirat A. - Tirane

49.Letër nga Xhafer Durmishi për A., shokun e F.Tafallarit në Tiranë, 23 nëntor 2011

I nderuari A.,
Ju falenderoj shumë për artikujt e siguruar shumë të shpejt, megjithë rinovimevet në Bibliotekën Kombëtare dhe për dërgimin e tyre me letër rekomandë. Renditja e artikujve e lidhja ishte shumë e qartë dhe lehtë me u kuptuar se cila faqe përputhet me tjetrën. I kam shkruar Faridinit se edhe sikur të më mugonte një pjesë e artikullit "KUSH E NXIT..." puna do të dilte pothuajse e plotë. Për fat të mirë, Faridini në Gjermani e ka gjetë artikullin "Kush e nxit..." dhe dje ma ka nisur pjesën që më mungonte.
Gjithë të mirat
Xhafer Durmishi, Suedi

50.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 25 nëntor 2011

Shoku Faridin,
Tani më erdhi pjesa e artikullit prej teje. Shpresoj se e ke ndreq internetin. Posa ta kryej dhe ta rregulloj një hyrje ta dërgoj shkrimin të kompletuar. Sa i përket hyrjes kisha dashtë me e pas aprovimin e A. Pra unë prej anës time ta dërgoj ty.
Shumë falemnderit.
Xhaferi

***

Parafjalë

Për përgatitjen e këtij libri dua ta falenderoj Faridin Tafallarin në dy drejtime:

-Së pari, ai qysh më heret m'i ka siguruar të gjitha kopjet që ia kam kërkuar nga revista Lajmëtari i lirisë, Bashkimi dhe Zëri i Kosovës.

-Së dyti për ofrimin e ndihmës përmes shokut të tij A. S. nga Tirana, rreth sigurimit e artikujve të "Zërit të popullit", i cili kërkesën e Faridinit e ka pritur në këtë formë:

Faridin,

Gëzohem shumë që u dëgjuam se, kishim kohë që nuk kishim komunikuar, por edhe që jeni mirë me shëndet. Edhe ne këtej nga Tirana, në këtë vjeshtë - pranvere, jemi mirë, mezi presim që të freskohet pak moti!? Përsa më shkruan për kërkesën e atyre artikujve, do të përpiqem të ta plotesoj por duhet të dish që më duhet pak kohë sepse janë disa procese për

kërkimin e artikujve në fjalë, fotokopjimin etj... E them këtë se, ti shoku ynë e di fare mirë se, nuk "pertojme" kurrë për Ty, sepse ke lënë gjurmë të forta burrërie tek ne, si njeri me karakter fisnik e një shqiptar i vërtetë i Kosovës, pra i besës, dhe jo si shumë të tjerë, madje emra te njohur, që e kanë "dredh" pa pikë turpi, dhe na kanë "harru"... Të kujtojmë shpesh edhe në bisedat me H., sepse ... nevoja për miqtë dhe shokët e vërtetë po kërkohet shumë dhe Ti je njëri prej tyre! ....

Faridin!...Sot e mbarova porosinë tënde për artikujt e gazetës Z.P.! U vonuan ca... dhe u mundova pak sepse, për fat, Biblioteka Kombëtare është në konstruksion, kështu që falë respektit për ty, por dhe vendit që kam atje, u përpoqën që në mes të atij pluhuri e rrëmujës së madhe të rinovimit të fondeve, të më nxirrnin koleksionet, që ju kërkova... Siç të kisha vënë në dijeni, artikujt ishin shumë voluminoz, kështu që edhe fotokopjimi i tyre qe mjaft i veshtire... ata nuk mund të dërgohen me asnjë rrugë tjetër, perveçse postimit të fotokopjeve të tyre!...
Gjithë të mirat!
A. S.

51.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 26 nëntor 2011

Shok Xhafer! Kjo eshte pergjigjja nga A., e di se tash me eshte von por edhe ashtu si e ke bere hyrjen ne librin "Zeri i Popullit dhe Zeri i Jusuf Gervalles" eshte shume e mire nuk i mungon as gje! une pas bisdes telefonike me ty dola nga shtepia se ekisha nje pune te atill dhe u ktheva von. por megjithate po ta dergoj pergjigjen e shokeve nga tirana...pershendetje F.Tafallari

***

Përgjigja e A. nga Tirana për Faridin Tafallarin, 25 nëntor 2011

Faredin,

O miku yne i mire, ne gezohemi dhe ndjejme nje lloj krenarie te veçante, per ndihmen modeste, qe te japim Ty po se po, o shoku yne i idealit, por edhe shokeve te tu, sidomos atyre te cilet Ti i ke veçuar, sikurse na ke "prezantuar" ne distance me Xh.Durmishin! Pra gezohemi sinqerisht, persa na shkruan, qe dergesa me artikujt e kerkuar i ka vlejt shume ne punen e tij krijuese edhe Xh.D...por edhe per deshiren e Tij., qe kjo ndihme e jone te cilesohet konkretisht ne hyrjen e mt, qe Xh.D. do ta botoje! Ti e di fare mire qe ne e kemi vleresuar dhe e vleresojme shume mendimin dhe fjalen tende te matur, pra nese Ti je dakort per kete, pa dyshim, qe edhe ne jemi dakort!

Shendet e Mireundegjofshim – A.

52.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 26 nëntor 2011

Idashur Xhafer! sot qe ne fillim e hapa faqen te pashtriku.org, duke menduar se e ka botuar librin tend, kushtuar te Madhit Jusuf! po shprsoj se ndoshta sot e bot? te them sinqerisht se shume me ka pelqyar e kishe bere shume bukur, edhe fotografit ah sa bukur Jusufi dukej tamam YLL YLL Shqiptarie. te lumt mendja dhe pena, shendet e suksese edhe me tej.
Pesrshendetje
F.T.

***

Faredin,
...me pelqeu shume paraqitja e asaj pjese qe na takonte ne, ne librin "ZERI I PO...(kjo nuk do te thote se libri jo,te cilin do ta lexoj me vemendjen me te madhe).Me shume mjeshteri pene Xh...e kishte konkretizuar ndihmen tone te perbashket.....edhe nje here FALENDERIM PER SHOKUN TEND teper MIRENJOHES karshi nesh DHE SUKSESE NE PUNEN E TIJ KRIJUESE..".
Gjithe te mirat - A.
kushtuar te Madhit Jusuf

53.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 12 dhjetor 2011

Tungjatjeta Xhafer!
E lexova librin e fundit "Të fala s'po na çojnë". Më pëlqeu shumë dhe të përgëzoj për punën e shkëlqyeshme që ke bërë!
Duke e lexuar një libër të Ismail Kadaresë "Mosmarrëveshja" kam lexuar një citat të një drame të Gjergj Fishtës "Nën hajat të Parrizit" me dy personazhe kryesore, Skënderbeun dhe Djallin , ku Skënderbeu e pyet Djallin se si janë shqiptarët dhe Shqipëria dhe Djalli përgjigjet: "Si i don armiku!". Kjo përgjigje e Djallit m'u kujtua duke lexuar librin Tënd.
Edhe njëherë të uroj e falenderoj për punën e madhe që ke bërë në mbrojtje dhe zbardhje të së vërtetës.
Natën e mirë dhe shëndet!
Asllani

54.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 24 dhjetor 2011

Shumë i dashur Xhafer !
Librin tuaj “Të fala s'po na çojnë asnjëherë” e lexova sot, (për te dytën herë) dhe po te lajmërohem me pak fjalë.
Për një arsye jam i lumtur dhe krenohem shumë, bile kam emocione te veçanta se;” Afërsinë tuaj me Jusufin, dhe aftësinë tuaj për ta zbardhë "LEVIZJËN e Jusufit" s'do te mund ta demantoi askush ! Historia shkruhet me fakte, e jo me thashetheme siç kan tentuar dhe pretenduar, e pretendojnë ende shumë injorant, kameleon, apo shumë hisedar te fajit për fatin e heronjve.

Përveç autorit te romanit "ATENTATET”, shkarravinave te Partisë Komuniste-PKMLSHJ, ”DËSHMIVE QYQARE" do t'i mbuloi pluhuri i harresës. Tre librat tuaj (mbështetur në librat; them ARKIVORE te F. Tafallarit) janë alpha dhe omega e "Dosjes Gërvalla dhe K.Zeka". Heroinë e vërtetë e librit te tretë është Tushja ! Me letrën e sajë, ajo pasqyron gruan e vërtetë, virtytin e sajë te lartë dhe ndjenjën e pastër kombëtare, çiltërsinë dhe dashurinë për shokët e heronjve, por edhe brengën për vazhdimin e aktivitetit, kujdesin ndaj kunatës...për fëmijët e Jusufit etj. Kjo letër është me peshë dhe kuptim te madh !Është mirënjohje shumëdimensionale qe buron dhe renditët ne VLERË-Historia do ta arkivoi ne gjirin e sajë !

Te fala shumë, urime festat, shëndet dhe suksese.
Shabani

55.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 26 shkurt 2012

Tungjatjeta Xhafë!
Letrën Tënde e lexova dhe më pëlqeu shumë.
Sabri Novosella, dikur një i ri kryengritës dhe liridashës për çka u shpërblye nga pushtuesi serb me vite të tëra në burg dhe me arratisje nga atdheu, për hir të faktit se ka arritur ta fitoj simpatinë e Jusuf Gërvallës dhe të gjithë atyre që shihnin ëndrra lirie, kur prangat e robërisë na i shtrëngonin duart, e ka merituar një letër të tillë.
Letra jote është shumë e mirë, shumë miqësore dhe shumë e drejtë. Ti i shkruan Sabriut, ashtu siç i shkruan një shok një shoku: hapur dhe pa dorëza. Mendimet që ia përcjellë në të janë shumë të drejta dhe shumë domethënëse. Si fjalët dashamirëse, ashtu edhe kritikat janë me vend dhe që e thonë të vërtetën.
Përshëndetje të përzemërta
Asllani

56.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 4 mars 2012

I nderuar Xhafer,
Letrën e lexova dhe po ta jap mendimin tim.
Mendoi se librat tuaja ua kanë prishë llogaritë e gabuara shumëkujt, kurse kjo letër për Sabriun ka me qenë delikate. Unë librat e Sabriut nuk i kam lexuar të gjitha , por tuajat po. Tek librat tuaja nuk ka kundërthënie në mendime dhe ide ! Objektiviteti dhe prova me shkrim ka mbulesë te fuqishme sa që; s'len vend për komentime ndryshe !? Edhe te kjo letër drejtuar Sabriut, unë nuk gjejë ndonjë element që del jashtë objektives dhe asaj çka ti ke mundur t'i thuash edhe pas tridhjet vitesh. Ti ia ke thënë shumë miqësisht disa gjëra.
Nëse vërtetë është bindë se ti ke te drejt, ai ka mundësi ta dëshmoi. Krejt sakrificën dhe aktivitetin kombëtar, si individ dhe si familje mund ta sublimoi, vetëm nëse ka vendosur dhe ka gatishmëri.
Një dukuri që e admiroi dhe që me bënë te krenohem shumë me ty, është fakti se; Ti je shumë serioz, i sakt dhe real në ato që thua. E hedh shkrimin në letër dhe ec e luaje fjalën tënde ! Guxo ta ndryshosh, apo ta zëvendësosh me një tjetër- pa ia ndryshuar përmbajtjen, aq më tepër që; gjërat i thjeshtëson për t'i kuptuar te gjitha shtresat. Të tillë e shoh edhe këtë letër drejtuar Sabriut.
Të fala shumë
Shabani

57.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 26 prill 2012

FARIDIN TAFALLARI
KUR LEXON NJË LIBËR TË NJË SHOKU TË VËRTETË
…ME TË VËRTETA…DHE MBI TË VËRTETËN…!!!

Nuk mund të të ndodhë ndryshe,veçse të ndihesh mirë, madje në vetëvete të ndjesh një lloj krenarie që, ka shokë të vërtetë, që shkruajnë të VËRTETËN dhe mbi të VËRTETËN, e cila është tepër e domosdoshme në ditët e sotme, të trazuara, ku e vërteta, shpesh po tjetërsohet, ndonjëhere edhe me një qëllim të mbrapshtë!?

Sapo e lexova edhe librin e pestë të shokut dhe bashkëveprimtarit të ngushte të JUSUF GËRVALLËS, dhe njëherit edhe shokut e bashkëveprimtarit tim, të atyre viteve të stuhishme, Xhafer Durmishit, ku në atë kohë, pak kishte të tillë, që nuk i merrte gjumi po nuk bënin diçka, sado pak për LIRINË dhe ÇËSHTJEN E MADHE TË ATDHEUT!!!

…Dhe i tillë, nga ata shokët e rrallë e të veçantë, atdhetar e patriot besnik, intelektual i zgjuar dhe i matur ishte Xhafer Durmishi…U njoha me Xhaferin, kur shkoja tek i Madhi Jusuf Gërvalla, në Untergruppenbach…atje e takova këtë shok, shok të vërtetë, që për një kohë të shkurtë e tregoj veten se, ai i mbeti besnik dhe shok mëse i vërtetë i të MADHIT JUSUF!!!

Ja, LEXUES I NDERUAR…edhe koha si dëshmitarja më e drejtë, pa hile, e tregoi për JUSUFIN, YLLIN E PAVDEKËSISË, SHOKU I VËRTETË, se kush ishte, Xhafer Durmishi për TRIMIN e PAHARRUAR, por edhe për mua!... Ndihem mirë, ndihem krenar…i gëzuar, që ky bir shqiptarie po shkruan, po analizon veprimtaritë tona patriotike, aktivitetin tonë atdhetar, të atyre viteve të veshtira, të asaj rruge plot sakrifica, ASHTU SIÇ KA QENË NË REALITET, me fakte dhe te dokumentuara, por ndihem akoma më mirë, sidomos, kur shoku im Xhaferi shkruan me aq vërtetësi për figurën, personalitetin, idealin, veprimtarinë patriotike dhe atdhetare të JUSUF GËRVALLËS, të veprës së TIJ të pavdekëshme, madje edhe duke u bazuar në vete veprën e lënë nga JUSUFI I MADH!!!.

… Pra, ju bëj thirrje, të NDERUAR LEXUES, t'i lexoni librat e shkruar nga Xhafer Durmishi se… ata janë libra të së VËRTETËS, të realitetit, libra që kanë një vlerë historike kombëtare të patjetërsueshme, të cilët do t'i shërbejnë brezave, për të ditur historinë e vërtetë të kombit, të shkruar me gjakun e pastër të bijve të ndershëm, të shqiptarise, për të njohur JUSUFIN E VËRTETË, të MADHIN JUSUF GËRVALLA!!!

Lexoni mbi të vërtetën e shkruar në librat e së vërtetës së Xhafer Durmishit!.. Mos humbni kohë te gënjeshtrat e dikujt, që si qëllim e ka për t'i dalë emeri… qofte edhe me rrena e gënjeshtra!?

Xhaferit, shokut e mikut tim i uroj shëndet e gjithë të mirat, që të vazhdoje dhe më tutje vepra të tjera, ashtu si e kam thënë edhe nëper shkrimet e mia, qofte në librat e mi apo dhe në shkrimet e publikuara nëpër faqet e internetit, se kurrë nuk është mjaft të shkruash për Jusuf Gërvallën. Këtu dua ta përgezoj e te uroj faqes së ndritur, mëse atdhetare- ALBANIAPRESS-suksese, vetem suksese!.

FARIDIN TAFALLARI

58.Letër e Xhafer Durmishit për Sabri Novosellën, shkurt 2012

I nderuari Sabri,

Faleminderit për dy librat e dërguara e të nënshkruara për mua. Edhe zarfat e shkruar prej teje ma kujtuan kohën e viteve 1981 - 1983 kur na vinin në Shtutgart letra prej teje nga Stambolli. Më vjen mirë që pas 30 vitesh i quan të rëndësishme mendimet e mia për atë kohë në të cilën kemi vepruar bashkarisht, edhe pse nganjëherë kemi pasur qëndrime më të përafërta e nganjëherë më pak të përafërta.

Librin "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh", botimin e parë e kam lexuar më heret, dhe e rilexova tani botimin e dytë. Prej botimit të parë kam marrë disa citate për punimet e mia, ndërsa librin "Kuvendi i Taksimit" e lexova këto ditë.

Në pozitën time, para se të jap mendimet e mia, më duket se ndodhem para një detyre delikate; të vështirë dhe të lehtë në të njejtën kohë.

Po ndalem së pari tek "Kuvendi i Taksimit." Ky libër kap një periudhë të gjatë kohore, 1912-1999. Kujtimet e Hasan Prishtinës janë shumë interesante, por për analizimin dhe interpretimin e tekstit të tij nuk e ndiej veten të përgatitur se mund ta bëjë tani. Kjo do të thotë se nuk e ndiej veten kompetent, as edhe si amator t'i komentoj interpretimet tuaja që i ke bërë në librin "Kuvendi i Taksimit". Kontributi im në fushën e shkrimeve kufizohet në **L**ëvizjen tonë Nacionalçlirimtare dhe peshën e Jusufit në te, dhe punën time në këtë pikë nuk e konsideroj

krejtësisht të përfunduar. Temat që i prek ti në librin tënd në "Kuvendin e Taksimit" por që përsëriten në mënyrë identike edhe në "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh" janë të ngjashme, janë shumë të koklavituna dhe nuk mund të përgjigjesh në to me gjeneralizime e shabllonizime tepër të gjëra. Nuk kam marrë ndonjë fjali apo ndonjë rast konkret për t'i ilustruar thëniet e tuaja, por dua t'a potencoj një të metë kryesore, që sipas mendimit tim, shfaqet në librat që më ke dërguar.

Ti e lufton një ide, idenë marksiste apo komuniste duke i sulmuar bartësit, personat që kanë ushtruar pushtet në emër të asaj ideje, pra e vendos shenjën e barazimit në mes bartësve të idesë dhe vetë idesë. Këtë barazim (futjen e të gjithëve në një thes) nuk ma merr mendja se e ke përdorë kur është fjala tek feja, pra barazimin e veprimet tejet të dënueshme të bartësve të ndryshëm të saj ndër shekuj me vetë fenë. Duke u nisur nga fakti se këta bartës kanë vdekur, kanë varre, janë të varrosur, t'i nxjerrë konkluzionin se me ta është varrosur edhe ideja me të cilën e kanë ngjyrosur apo bojatisur veten. Ti, por dhe shumica absolute e autorëve të sotëm veprojnë në këtë mënyrë. Tërmeti i vitit 1989, nga mendimi dominues i gjeneratës sonë konsiderohet si tërmeti i fundit dhe se pas kësaj ngjarje korja e tokës e ka stabilizuar dhe harmonizuar përfundimisht edhe koren e bukës.

Ti shkruan si nacionalist, dhe përpiqesh që baza kryesore e mendimit tënd të ndërtohet në këtë ide, duke u munduar ta pastrosh nga kundërthëniet apo kontradiktat. Nacionalizmi ynë më duket prapë se prapë është një nacionalizëm i një populli të vogël dhe të shtypur e të copëtuar, e në këtë kuptim ndoshta edhe më i justifikueshëm, por nuk duhet harruar se pushtuesit e kombeve më të mëdha e shtypëse, me të gjitha mjetet e dhunës në dispozicion, e etiketojnë veten me nacionalizëm dhe përpiqen që shtresat e klasat e tyre t'i mobilizojnë e ndërsejnë kundër të tjerëve pikërisht duke e luajtur rolin e viktimës, duke u thënë se sa të pabesë e sa mosmirënjohës janë treguar popujt e vegjël ndaj tyre, e sa shumë e kanë keqpërdorë ata bujarinë, mirësinë e urtësinë e tyre.

Ka mendime se me shkruar historinë është punë shumë e vështirë. Jam përpjekur të jem i vetëdijshëm për këtë dhe kam shkruar për një periudhë të shkurt kohore dhe për një rreth të caktuar, rreth në të cilin mund të them se jam inkuadruar përmes çelësit tënd. Çelësi yt, ma ka hapur një derë të madhe, më ka futur në një botë e cila e popullon mendjen time. Aspekte të këtyre ngjarjeve i ke përshkruar në librin "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh".

Në librin tënd "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh", qendrën e tyre e përbëjnë kujtimet e tua, prejardhja, familja, fëmijëria e deri në ditët e sotme. Në një segment të caktuar gjendem edhe unë. Për periudhën kur kemi pasur aktivitet të përbashkët, kam shkruar më gjerësisht se ti, por sasia e numri më i madh i fjalëve nuk është garantues i cilësisë. Jeta jote është interesante. Për hir të realitetit po i përsëris edhe dy mendime që më ka rënë t'i lexoj e të cilat po i përmbledhi në një: "Edhe jeta e njeriut më të thjeshtë është me e koklavitur e më e pasur me ngjarje se sa personazhi më i komplikuar i Shekspirit. Problemi qëndron në atë se prej botës mendore të përjetimeve, gjatë rrugës deri në letër humbin pjesa më e madhe e tyre... por në shumicën absolute të rasteve tragjika është edhe më e madhe sepse ngjarje aq magjike e vështirë të imagjinueshme rrugën prej trurit e deri në letër nuk e marrin fare." Duke u nisur nga kjo, jam i sigurt se jeta jote ka qenë shumë më interesante dhe më e pasur në ngjarje se sa ke arritur me i hedhë në letër.

Një aspekt tjetër është se disa ngjarje që i kam përshkruar unë përmes shumë dokumenteve, nuk përputhen me disa nga ato çka i ke thënë ti në këtë libër. Natyra e komunikimit shoqëror ndikon që ky shkrim i shkurt nuk ndien nevojën të jetë sheshim e krahasim i këtyre dallimeve. Ti i ke thënë mendimet tuaja në kujtimet tuaja, e unë i kam parashtruar ngjarjet (të cilat nuk mund të quhen kujtime) në librat e botuar sidomos në mes 20 tetorit 2011 e 14 janarit 2012. Megjithatë, ia vlen të thuhen disa gjëra për vijën kryesore të librit, që ka të bëjë me pjesën ideore. Me sa kam vërejtur shumë njerëz që janë të zhdërvjelltë, praktik e të shpejt, që ndikojnë shumë në rrethinën e vet, nganjëherë nuk iu kushtojnë rëndësinë e duhur

detaleve. Pse ndodh kështu, ekzakt nuk mund ta di, por është fakt i pamohueshëm. Ka mundësi që disa përkufizime nga fjalia e mësipërme vlejnë edhe për ty. Në librin tënd parakalon një plejadë e tërë veprimtarësh të njohur për popullin tonë. Në rastin tim po ndalem vetëm tek Jusuf Gërvalla, pasi disa rrethana e kam më të lehtë t'i komentojë. Në vitin 1981 e 1982 nuk ke pasur kundërthënie me Jusufin. Është vështirë, në mos e pamundur, për mua me e kalua në heshtje faktin se shumë fjalë të shkruara prej teje, më 2010 e 2012 i qesin në sipërfaqe disa kundërthënie problematike në mes teje dhe fjalëve që i ka shkruar dora e Jusufit, e të cilat i ke të njohura. Ka mundësi qe me kalimin e kohës ato kundërthënie e mospërputhje të zhduken por mund të ndodhë edhe e kundërta, dhe fati i shkrimeve politike të Jusufit të jetë i ndryshëm me atë të kujtimeve tua. Si do të zhvillohen ngjarjet në këto dekadat e ardhshme, në mënyrë shkencore është vështirë me i parapa. Është interesant se shkencëtaret janë shumë të sigurt se çka ka me ndodhë me tokën pas 4 miliardë vjetësh, por asnjë nuk ka idenë dhe as guximin të prognozoj se çka mund të ndodhë pas 100 vjetësh.

Unë të jam shumë mirënjohës që përmes teje jam njohur me Jusufin dhe rrethin e tij në Shtutgart. Ti e ke dëshmua në praktikë me zgjuarsinë dhe aftësinë tënde me i gjykua disa gjëra drejt për momentin, gjykime të cilat reflektohen në bazën tënde ekonomike. Libri yt "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh" dhe ideja themelore e tij përputhet me idetë politike që mbretërojnë ditëve të sotit. Shkrimet e Jusufit në gazetat ku ka vepruar nga vitet 1980-1982, si brenda Organizatës sonë ashtu edhe jashtë saj, kanë disa dallime në këtë pikë. Se ku është vendi im në këtë mes, besoj se është bërë e qart përmes shkrimeve të mija, për të cilat (qoftë edhe pjesërisht) më the fjalë të mira.

I nderuari Sabri, shpresoj t'i marrësh këto frymë me po atë frymë me të cilën më je drejtuar.

Gjithë të mirat; Xhafer Durmishi

Nga e majta: Asllan Muharremi, Njazi Straja, Sabri Novosella dhe Ymer Berisha

Sami Lushtaku tregon për herë të parë: Rugova dhe Adem Jashari u takuan në Zvicër
Sami Lushtaku, ka treguar për herë të parë se në vitin 1991, presidenti ***Ibrahim Rugova*** *e ka pritur në Zvicër komandantin* ***Adem Jashari.***

Lushtaku thotë se më herët nuk është përmendur ky rast, por në fillim të '90-tave Rugova e Jashari janë takuar në Zvicër.

*"****Kemi shku në Zvicër me Adem Jasharin.*** *Atje e kemi taku qeverinë edhe* ***Ibrahim Rugovën. Unë jo, por Ademi (Jashari) e ka taku Rugovën në vitin '91",*** *ka thënë Lushtaku në Pressing. Ai tregon se ishte arratisur përmes aeroportit të Shkupit dhe po shoqërohej nga* ***Adem Jashari****. Kur kanë arritur në Zvicër, sipas Lushtakut, janë pritur nga qeveria në ekzil e Kosovës dhe vetë presidenti Rugova.*

"Nuk e kemi ditë që atje e pret Rugova. Kur kemi shku në aeroport na ka pritur Imer Berisha. Atje na ka pritur edhe Ibrahim Rugova"*, ka treguar Lushtaku.*

(Drenicapress.info, 23 shtator 2019)

59.Fjalë nga Sabri Maxhuni-Novosella për Xhafer Durmishin, shkurt 2012

Sabri Novosella: "Xhafer Durmishi është bashkëveprimtari dhe bashkëpunëtori më i afërt i Heroit Jusuf Gërvalla në Gjermani." (Shkurt 2012)

Sabri Maxhuni-Novosella: "*Xhafer Durmishit, bashkëveprimtarit dhe bashkëpunëtorit më të afërt të Heroit Jusuf Gërvalla në Gjermani. Me respekt. Autori. Shkurt 2012;* fjalë të shkruara me dorë si dedikim të dhuratës-librit "Rezistenca Kosovare mes dy zjarresh", Prishtinë 2012)

60.Shpifjet e shpifarakëve

Shefqet Jashari: "*I dashur Xhafer, çdo letër e jotja më gëzon, në veçanti kur më njofton se ke shkruar një libër. Të përgëzoj nga zemra për punën e madhe që keni bërë në këto vitet e fundit për ta ndriçuar punën dhe veprën kolosale të Kolosit tonë Jusuf Gërvalla. Me fakte dhe argumente po i hudhë për toke shpifjet e shpifarakëve të shumtë që sot po mundohen për të falsifikuar ngjarje historike, duke falsifikuar fakte dhe argumente.*

Ju përshëndes sinqerisht, Shefqeti (Letër nga Shefqet Jashari, 10 shkurt 2012)

61.Letër nga Shefqet Jashari për Xhafer Durmishin, 13 shkurt 2012

I dashur Xhafer, më vjen mirë që Sabriu t'u ka paraqitur dhe njëkohësisht e ka thëne një të vërtetë, që hiqkurkushat mundohen ta mohojnë. Është fakt i pa kontestueshëm se ju keni qenë bashkëpunëtori më i ngushtë i Jusufit në Gjermani, për sa kohë që ju keni punuar me te. Po ashtu është fakt se ju pas vrasjes së tij, nga UDB-jugosllave dhe të ndihmuar nga shqipfolës, bashkëpunëtor të Sigurimit Jugosllav, ju ishit ai që e muarët Lëvizjen për ta drejtuar në kushte dhe rrethana tejet të vështira dhe të komplikuara.

Edhe vazhdimi i daljes së Zërit të Kosovës nën mbikëqyrjen dhe redaktimin tënd ishte një sukses i jashtëzakonshëm. Por puna e juaj publicistike duke i publikuar disa libra me fakte të pa kontestueshme për veprën dhe punën e madhe të Jusuf Gërvallës dhe bashkëpunëtorëve të tij mendoj unë është e barabartë me gjithë punën që e keni kryer me Jusuf e Bardhosh Gërvallen dhe shokët e tij të ngushtë, zotëri Tafallarin etj.... Më në fund ju falenderoj për të dhënat që mi ke dërguar dhe njëkohësisht ju përshëndes vëllazërisht. Zoti të ndihmoftë!

62.Kadri Osmani-E di se është më i miri nga ne të gjithë, 21 shkurt 2012

Kadri Mani: "Zotni Abdullah Prapashtica, shpjegohu se çka ke dashtë të thuash: "Kështu Sabri Novosella i shoqëruar edhe nga një far Xhafer Durmishi"- përse "njëfarë"!?- unë ende nuk e kam takuar Zotni Xhafer Durmishin, por e di se është më i miri nga ne të gjithë. Xhafer Durmishi është analist e publicist i mirëfilltë."

(www.zemrashqiptare.net, 21 shkurt 2012)

63.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 22 qershor 2012

Tungjatjeta Xhafë!

Tani po t'i përcjellë disa mendime lidhur me shkrimin "Në rrethin e Shtutgartit".

Siç të kam thënë edhe gjatë bisedës telefonike, shkrimi më ka pëlqyer, por ai nuk është i plotë. Unë besoj se ka shumë gjëra që vetëm ti mund t'i riprodhosh dhe t'i shkruash në letër. Prandaj, nuk duhet hezituar, por duhet nxjerrë në dritë edhe detajet më të imta të asaj kohe. Të gjitha janë të rëndësishme, për ata që vijnë pas nesh.

Lidhur me njohjen tënde me Jusufin, unë mendoj se nuk është e drejtë që ajo të quhet e rastësishme, ashtu siç e nis rrëfimin e kujtimeve tua. Vetë fakti që ti ishe anëtar i LNÇKVShJ-së qysh para udhëtimit tënd në Turqi dhe Zvicër vërteton se rastësi nuk ka pasur në këtë çështje. Kontakti dhe njohja jote me Jusufin është meritë e Sabriut. Sabriu e ka bërë të mundshëm atë. E rëndësishme është të thuhet e vërteta e rrjedhjes së njohjes dhe kontaktit me të.

Më vonë gjatë shkrimit, ti e vërteton se në Kosovë është biseduar për Jusufin, për "Lajmëtarin e lirisë", bile se Jusufi ka qenë një nga ata që kanë mundur të jenë autor të "Lajmëtarit". Pastaj, anëtarët e LNÇKVShJ-së, të mbetur të shkëputur nga Lëvizja apo udhëheqja e saj, siç keni ngelur edhe ju krahu i Shefqetit apo unë i Ramadanit, kemi menduar dhe bërë përpjekje për të krijuar lidhje me Jusufin. Mua më kujtohet një bisedë që kam pasur me Ty para se të largoheshe nga Kosova, verën e vitit 1981, kur unë të pata thënë se kisha një ide për të udhëtuar në Gjermani, si student gjoja për të punuar gjatë verës dhe për ta shfrytëzuar këtë udhëtim edhe si mundësi për të marrë lidhje me Jusufin. E mbaj mend që më pate thënë që të mos mendoja për këtë çështje sepse kjo nuk është e nevojshme. Unë këtë qëndrim tëndin e kam pas kuptuar se gjatë udhëtimit tënd në Evropën Perëndimore t'i do ta krijosh lidhjen. Këtë e kemi pas pritur unë Xhema dhe Ferkiu.

Unë mendoj se qëllimi i udhëtimit tënd në Turqi duhet të shpjegohet më me detaje dhe më gjerësisht. Gjithashtu edhe shkuarja jote në Zvicër nuk ishte vetëm për çështje pune sezonale. Me sa mbaj mend, ti, pas demonstratave të Mitrovicës, ke qenë i rrezikuar të arrestoheshe. Më kujtohet se si profesoresha jote, Luljeta Pula Beçiri, në mos gabofsha, të kishte paralajmëruar se udbashët e kishin pyetur për ty dhe se ajo të kishte këshilluar të largoheshe nga fakulteti.

Takimet me Jusuf Gërvallën dhe bashkëpunëtorët e tij në rrethin e Shtutgartit, por edhe më larg, mendoj se janë shumë të rëndësishme. Kontaktet e Jusufit me Kadriun, bisedat që t'i ke pasur me Jusufin rreth atyre kontakteve, rreth "Lirisë" dhe shokut të "Lirisë", pastaj rreth të

tjerëve, kanë rëndësi të madhe. Unë mendoj se duhet shkruar gjithçka në frymën e kohës dhe pa ndikime nga ngjarjet e pastajme.

Kaq kësaj radhe.

Përshëndetje

Asllani

64.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 5 korrik 2012

I nderuar Xhafer,

Duke të përshëndetur po te njoftoi se Pashtriku e paska botuar edhe librin "Pa taktizime ".U gëzova shumë ! Librin "Fakte për L.J.G" po e lexoi ngadalë-gjithë kohën qe e kam te lirë po e shfrytëzoi në te. Duhet ta dishë se tërë këto vite kam jetue e frymue me besimin e fortë-i bindur në drejtësinë tonë, e posaçërisht i sterbindur në të drejtën e Heroit tim Xhafer Durmishit. Unë nuk e hiperbolizoi këtë thënje, por po e them ate çka e ndjejë në shpirtë,e te cilën tani po ta them botërisht.

Shëndet dhe suksese se ika në punë.

Shumë te fala Shabani

65.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 8 korrik 2012

Tungjatjeta Xhafë!

Të faleminderit për dërgimin e intervistës së Donikës!

Sonte e mbarova së lexuari librin tënd "Fakte nga Lëvizja e JG". Jam shumë i lumtur që lexuesit shqiptar po i dhurohet një dhuratë kaq e madhe. Në ato letra është përfshirë një pjesë e madhe e historisë së Lëvizjes sonë. Aty, del pa maska e vërteta. Të përgëzoj për punën e madhe që këtë bërë!

Përshëndetje

Asllani

66.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 18 korrik 2012

Shumë i nderuar Xhafer,

Të përshëndes dhe uroj shëndet e lumturi. Krejt çka dua të te them sot është se jemi mirë dhe mirë po kalojmë Edhe pak minuta shkoi në punë andaj po i përdori disa thënje te Aleksandrit të Madh;" Koha është thesari më i madh që kemi-sepse është e kufizuar". "Mundemi te krijojmë dhe fitojmë kapital e thesare te pa fund, por jo edhe kohë". Kur i kushtojmë kohë një personi, i afrojmë ati një pjesë te jetës sonë, të cilën kurrë nuk do të mundemi ta plotësojmë", andaj sot kaq kisha kohë te ta kushtoj Ty, por në mendje dhe shpirt, frymoj, jetoi dhe gjallëroi me Ty.

Shumë të fala

Shabani

67.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 13 nëntor 2012

I dashur shoku Faridin,

Të uroj qëndrim sa më të mirë në Kosovë gjatë këtij Nëntori.

Deshta të them disa fjalë rreth shkrimeve e fjalëve për Metush Krasniqin, rreth të cilit ndoshta do të sillen fjalë të ndryshme në dokumentarin e Ismet Rashitit për Hasan Malën. Ty nuk të ka ra me e lexua librin e Selatin Novosellës për Metush Krasniqin.

Thelbi i atij libri në raport me Jusufin është që Jusufi të paraqitet bisht i Metush Krasniqit, i cili (pra Jusufi) të gjitha kontaktet me majtista e me komunista i ka bërë në bazë të porosive të Metush Krasniqit (i cili vetë si i djathtë e antikomunist) nuk ka dashtë me i fëlliq duart e veta me komunista, por për këto punë të ndyta e ka pasur Jusufin. Në anën tjetër Hydajet Hyseni, në librin e Selatinit, Metush Krasniqin e paraqet si akraba të vetin dhe në këtë mënyrë thotë se Metush Krasniqi është pajtuar me Tezat e OMLK-së komuniste, dhe se mosmarrveshjet e Jusufit e Kadri Zekës e kanë burimin tek komunikimi i dobët brenda LNÇKVSHJ. Pra sikur Jusufit t'i kishte shkuar lajmi me kohë se Metush Krasniqi ka pranuar me u bërë bisht i Hydajet Hysenit edhe Jusufi automatikisht kishte pranuar me u bërë bisht i Kadri Zekës, dhe të gjitha keqkuptimet do të ishin zgjedhur me kohë. Sa i përket librit të Selatin Novosellës nuk ka asnjë fije dyshimi se puna qëndron kështu. Për ta trajtuar këtë temë, qysh tani i kam të gjitha faktet në dorë, të cilat janë krejtësisht të mjaftueshme.
Ndoshta e kam gabim, por kam disa arsye të besoj se këtë ide e këtë qëndrim të komunistave të paepur e hegjemon do ta mundohet ta vazhdoj Ismet Rashiti prej asaj pike ku e ka lënë Selatin Novosella e Hydajet Hyseni.

Para botimit të librit tënd "Me tre yjet..." e letrave të J. dhe librit tim "Lëvizja e JG" udhëhqësitë e komunistave Lëvizjen e JG janë munduar ta paraqesin bisht të OMLK, respektivisht JG bisht të KZ. Kjo taktikë më 2010 e 2011 ka falimentur në mënyrë katastrofale. Tani është në veprim plani tjetër, sipas të cilit plan:

-Lëvizja, jo e JG, por e Metush Krasniqit ka qenë bisht i OMLK, sepse Metush Krasniqi nuk ka pas ide e as horizont me u matë me Hydajet Hysenin dhe iu ka nënshtrua atij. Pasi Metushi me "horizontin" e tij iu ka nënshtrua Hydajetit këtë nënshtrim e ka pasur për detyrë ta pranoj edhe Jusufi.

E vërteta është se Jusufi nuk iu ka nënshtrua as KZ, as Hydajetit, as Sabri Novosellës e më së pakti Metush Krasniqit të cilin nuk e ka takur asnjëherë, por kuptohet se ia ka dëgjuar zërin, dhe prej të cilit nuk e ka marrë asnjë udhëzim me shkrim në jetën e tij, përveç asaj porosisë gojore që ke shkruar, përmes Isah Demit. Kjo do të thotë se edhe këtë planin e dytë, apo taktikën pas vitit 2011 e pret i njejti falimentim e katastrofë sikurse taktikën që është përdorë para vitit 2010 e 2011.

Në bazë të kësaj çka kam shkruar më lartë, do të kisha pasur dëshirë që nëse të bien në dorë ndonjë kopje e filmit në CD-DVD, të ma dërgosh. Por edhe nëse nuk sigurohet kjo nuk ka asgjë të keqe, pasi të gjitha faktet e mjaftueshme për t'u marrë me këtë temë i kam. Besoj se këtë temë (vjedhjen e meritave të Jusufit dhe përpjekjet për t'ia falur ato Metush Krasniqit) do ta shqyrtoj rrënjësisht gjatë vitit të ardhshëm, pasi shqyrtimin e kësaj teme e kam në rend të ditës.

Shumë të fala

Xhafer Durmishi

68.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 1 dhjetor 2012

Përshëndetje Xhafer !

Për mua nuk ka ngjarje dhe privilegj më te madh se fakti që jam në kontakt të përhershëm me ty ! Është kënaqësi e dyzuar, e shkrirë dhe kalitur me vite. Gjithmonë, në vazhdimësi e kam pasur bindjen, nuk jam ligështue , e as dorzue, e kam ditur se heroi dhe personazhi im ka për të folë ! E kam ditur se kur do flas, ai di te flas dhe godas ! Andaj jo rastësisht Ti je për mua Gjergj Elez Alia dhe Marin Barleti i kohës moderne.Ti , së paku, e di se unë nuk po flas vetëm për ta bërë radhën, por kam arsye të shumta pse shprehëm kështu. E marr me mend, e kuptoi në thellësi se nëpër çfarë vështirësi dhe me çfarë brumi (njerëz) ke pasur punë ! Ata ende nuk e kuptojnë, apo s'duan ta kuptojnë se çfarë dëmi i kanë bërë kombit, e çfarë mëkati kanë bërë ndaj teje dhe Jusufit, por bota sillet vetëm në binarët e vet, e jo në binarët qe ja servojnë të tjerët.

Duhet ta dishë se unë merrem shumë me shkrimet tuaja-i analizoi, i krahasoj dhe peshoi, e kur te thërras në telefon përpiqem te ta jap ndonjë mendim të kapshëm, te logjikshëm edhe në retrospektivë të ngjarjes-shpresoi që nuk jam lajthitë dhe nuk të kam futur në ndonjë udhë pa krye !? Gjer tani nuk kam shenja të tilla, andaj mbetëm tërësisht i bindur se për atë që jam përpjekë ia ka vle dhe nuk pendohem kurrë.

E kam ditë dhe kam qenë i sigurt se ka me të dalë punë në vazhdimësi ! E mira e së mirës është që; Ti po u tregon, po ua përsëritë, por ata s'kuptojnë ! Ty s'te ka faj kush qe të kanë qëlluar nxënës te dobët dhe lazdrana, të pa edukatë dhe megaloman, tinzar e të pa cipë ! Këta janë të gjithë kafshatë e vogël për ty ! Unë të uroj shëndet dhe suksese si gjer tani !Uroj që edhe pala tjetër të këndellët-pra ata që ne mendojmë qe janë viktimë apo karrieristë, por si për injorancë timen po ta them se; Këto e kanë burimin diku tjetër ! Në prapaskenë të gjithë kësaj mërije ndaj teje-jam i sigurt se është komplet sigurimi sekret serb !? Janë të gjithë ata qe; Serbia i ka ende pengë në forma të ndryshme, por ka edhe shotana politik, e që mjerisht populli i ka pasur sytë në ta ! Këtu ka edhe të tillë që kanë vendnumëruar gjithë jetën, e që mendojnë se më këtë i kanë shërbyer kombit ! Materia e studimit tuaj është e thellë, kurse e atyre është e cekët dhe sipërfaqësore. Sa ma tepër që do të tentojnë ta zbërthejnë (me manipulime), vetëm ndjellin kob në pocërrkën e tyre të thatë. Dështimin e kanë të garantuar që në start sepse ti e ke bazamentin e fortë.

Punimin e fundit mbaje, ashtu siç je shprehur edhe vet-i vjen koha t'ua hedhësh prap fytyrës!

Të fala shumë-Shabani

P.S. Tani ika në punë-nuk kam më kohë-ndëgjohemi .

69.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 15 maj 2013

Xhemajl Dauti-Demë Mustafaj-Asllan Muharremi-Elmaz Ademi

Tungjatjeta!

Si të thash gjatë bisedës që patëm në telefon, shkrimi më pëlqeu shumë. Dua t'i shtoj disa emra që mendoj se e pasurojnë. Emrat kanë qenë pjesë e Lëvizjes. P.sh. Ramadan Pllana, Sheremet Saraçi, Elmaz Ademi, Demë Mustafaj, Januz Mustafa, Xhemajl Dauti, Xhemil Beçiri dhe shumë të tjerë që kanë qëndruar pranë nesh apo kanë qenë të dënuar si anëtar të LNÇKVSHJ-së.

Lidhur me atë që ke shkuar për mua unë do të kisha pasur dëshirë të shkruante: A. M ka vepruar pranë LNÇKVSHJ-së që nga viti 1978. Në vitin 1983 , Shërbimi i Sigurimit të Shtetit të Jugosllavisë, ka tentuar ta arrestoj dhe është larguar nga Kosova. Në vitin 1984 ka qëndruar në Zvicër. Që nga qershori i vitit 1985 jeton në Suedi.

Përshëndetje

Asllani

70.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 5 korrik 2013

I dashur shok Xhafer, po e sheh edhe vet se ora ka vajtur pas mes nates, ndaj nuk te telefonova se mu duk pak si von ndaj vendosa te te shkruaj per te te bere me dije se librin e mora. Dhe se pari dua nga zemera te te Uroj shendet te mire dhe pune te mbare e shkrime te mira e te vlefshme siq i ke shkruar tash me me radhe librin e 19 mbëdhjet. Te them se sa e hapa me pa durim i leshova nje shikim, duke i lexuar disa faqe... Po librat tu jane me vlere te madhe sepse i ke shkruar per njeriun e MADH JUSUF GERVALLEN, ndaj te Uroj shume shendet suksese dhe te vazhdosh edhe me libra te tjere si ke punuar deri me sot. Mos e ndalo doren e pa lodhur, duart e arta se me keto jo vetem i ke dhene popullit shume libra te mira qe deri me sot as kush nuk e beri kete qe e bere ti. Keto jane shume te vlefshme dhe historike se e ke nxjerr Jusufin ashtu si ishte i mencur e i pa lodhure i aft e i zgjuar i cili i kishte te gjitha te mirat. Me keto e ke kryar edhe amanetin e ketij Kolosi siq ishte Jusufi yne i pa zevendësuar! Ndaj do ta lexoj me perkushtim te veçant librin ashtu siq i kam lexuar edhe ato te tjerat.

Me shume rrespekt F.Tafallari

71.Pjesë nga një reagim i Faridin Tafallarit kundër Skënder Blakajt, 16 shtator 2014

Faridin Tafallari: “Zotnia e tij Skënder Blakaj, paska harruar se, JUSUF GËRVALLA ka pasur pranë, këtu në mërgim, shokë besnikë e të devotshëm, mbi të gjitha ka pas me vete popullin e tij liridashës e bashkimkombëdashës!!! Dhe nga ai gjiri i këtij lloj shqiptarësh kombëdashës e atdhedashës i ka edhe dy shokët e tij më të afërt, XHAFER DURMISHIN e FARIDIN TAFALLARIN, bashkëluftëtarët më besnikë, që e ngritën dhe po e ngrejnë zërin e tyre me të madhe, për figurën patriotike të luftëtarit të paepur, TË MADHIT JUSUF GËRVALLA, duke shkruar e publikuar në shkrimet e tyre, jetën dhe veprën e pavdekëshme të heroit!” (FT. KËSHTU NDODH,“KUR TË HUMB GOMARI NË OBORR”- 16.09.2014; Pjesë nga reagimi ndaj fjalës së Skënder Blakajt me rastin e promovimit të librit “Shtëpia në rrugë” të Avdyl Gërvallës)

72.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 11 nëntor 2013

Tungjatjeta Xhafë!
I lëshova një sy përmbajtjes së librit që ma kishe dërguar dhe u gëzova shumë kur pashë edhe disa materiale të panjohura për mua, si intervista e Jusuf Gërvallës në "Tagische Zeitung"). Unë të përgëzoj për këtë punë shumë të madhe që ke bërë!

Ke të drejtë se tendenca për ta cunguar, plaçkitur, shtrembëruar dhe zhdukur nga faqja e dheut, sidomos veprën e tij politike, ka pasur dhe fatkeqësisht ato vazhdojnë edhe në ditët tona, por të gjithë atyre maskarenjve u ka hasur sharra në gozhdë falë angazhimit tënd dhe gjetjes, grumbullimit dhe publikimit të tyre, ashtu si i ka krijuar i zoti i tyre.

Të uroj të jeni shëndoshë e mirë!
Përshëndetje e të fala, Asllani

73.Letër nga Xhafer Durmishi për Asllan Muharremin, 11 nëntor 2013

Tungjatjeta Asllan,
Faleminderit për përshëndetjen dhe fjalët në te.
Unë jam më së shumti i interesuar që ta botoj pashtriku dhe kjo vepër në këtë formë që ia kam dhënë të bëhet e njohur për krejt popullin shqiptar, pasi populli ynë ka dëgjuar aq shumë por veprën e Jusufit nuk e ka pasur në dorë.
Sot po planifikoj me dalë në Malmo, në Svogetorp tek SIBA dhe Elgiganten. Nëse ke kohë kishim mund me u takua diku afër stacionit të trenit pasi të kem kryer punë.
Shumë të fala Xhaferi

74.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 11 nëntor 2013

Përshëndetje shumë i nderuar shok Xhafer,

Puna jote dhe librat tuaja , doemos se i kanë shkund të gjithë ata që; ose janë penduar për "të bëmat e kohës" , ose s'kanë qenë në vijë me viganin Jusuf Gërvalla. Natyrisht se politikës nënshtruese , kjo i dhembë më se shumti. Vet atentati i 17 janarit 1982 tregon qartë se ; a ka mundur kush ta shtyjë Jusufin të shkruaj ashtu siç ka shkruar , pra pa e ndjerë në shpirt dhe pa qenë thellësisht i bindur për faktin se ato mbesin letër e shkruar , e aq më tepër pa qenë i përgatitur në atë frymë dhe pa kërkuar mbështetje parimore - fillimisht në shtetin ëmë Shqipërinë , sido që të jet ajo; komuniste apo ndryshe.

... Tani , janë të strehuar mirë nën alibinë dhe provën de facto dhe de jure të Shtetit të Kosovës. Andaj, ata Jusufin e duan vetëm si muzikant e letrar. Mos harro ! E kanë të kotë , sepse Jusufi e ka vulosë frymën dhe idealin e tij me letrat e tij. Këtu është pezmi , këtu është marrëzia dhe dështimi i tyre , ndërsa i gjithë ai arkiv letrash , ata, herdo kur do, por më se shumti tani, i ka dezorientuar , dëshpëruar dhe i ka futë në rrugë pa dalje.

I dashur Xhafë ! Ti ua ke "hëngër kokrrat" , ti i ke në dorë sikur në lojën cicmic. Beso se ata

janë të pafuqishëm , janë kapitullues para teje dhe letrave autentike të Jusufit. Ata mendojnë se me para , manipulime, hile dhe pushtet mundet e vërteta , andaj ju ngutet me tubime , nominime shokësh dhe anashkalim të librave tuaja. Ata e dinë mirë se ti nuk je gjysmë analfabet dhe nuk blihesh as shitesh andaj e shfrytëzojnë masën , apo turmën e painformuar. Këtë shfrytëzim e kanë të përkohshëm , më shumë nëpër koluare dhe tubime at-hoc. Vezuvi, apo vullkani shkatërrues për ata, je ti , andaj edhe ndodhë anashkalimi ytë. Ata s'guxojnë as të sillën kah ti - sepse e dinë se i ke përvëluar dhe i përvëlon edhe më keq. Kjo luftë e pabarabart, ata i shtynë të zvarritën të shtirën dhe përpiqen të përfitojnë.

P.S. Të falenderoj për dërgimin edhe të këtij libri. Jam duke e lexuar. Ndëgjohemi.
Shumë të fala
Shabani

75.Letër nga Xhafer Durmishi për Asllan Muharremin, 19 qershor 2014

Tungjatjeta Asllan,

Kërkoj falje që nuk kam mundur të lajmërohem menjëherë me shkrim pas botimit të librit "Ëndrra lirie", pasi m'u grumbulluan disa punë. Por ti megjithatë i ke edhe mendimet e mia të mëhershme (gjatë vitit të kaluar) për librin tënd. Duke e pasur të njohur materien e librit, kësaj radhe ende nuk pata mundësi të ndalem në çdo fjali, e kam kaluar pak më shpejt.

Edhe njëherë të përgëzoj për punën e bërë me origjinalitet dhe të uroj suksese. Botimi dhe përhapja në formë elektronike më duket e fuqishme. Kjo nuk e përjashton mundësinë që në rrethana të përshtatshme ta botosh edhe në letër.

Shumë të fala Xhaferi

76. Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 3 dhjetor 2014

Faridin Tafallari
I dashur shok Xhafer! Se pari te falenderoj per vlersimin qe i ben librit "Per kohen e arte", dhe se dyti edhe per sygjerimet tua sepse **kur ti e sheh per mua eshte nje lehtsim i madh...**

Përshëndetje, Faridini

77.Faridin Tafallari - Analizë e thellë dhe reale, 2015

Faridin Tafallari: “Por për shkrime të sakta dhe mjaft të vërteta, do të veçoj Kadri Rexhën dhe sidomos Xhafer Durmishin. Unë me Xhaferin kemi qenë shumë pranë Jusuf Gërvallës dhe kemi shkruar e do të shkruajmë, për tu lënë një pasuri të patundëshme brezave dhe historisë kombëtare për figurën e të MADHIT JUSUF GËRVALLA. Xhafer Durmishi ka shkruar njëzet libra me fakte dhe argumente të sakta dhe me shumë vërtetësi, ku i ka bërë një analizë të thellë reale dhe mëse të vërtetë, JUSUFIT DHE VEPRIMTARISË SË TIJ ATDHETARE, ashtu siç ka qenë në realitet, si askush tjetër deri më sot, që do të provonte ta bënte dhe kurrë nuk do ta arrinte ta bënte!?! Madje duhet thënë dhe është tepër e rëndësishme kjo, që të dihet botërisht dhe të mos mohohet nga askush që, Xhafer Durmishi ka qenë krahu i djathtë i Jusuf Gërvallës!!! Ai di shumë dhe ka qenë në dijeni për shumë gjëra, të cilat me shumë përgjegjësi morale e burrërore, i ka treguar dhe evidentuar me dokumentime reale në librat e tij!” (Për kohën e artë, Prizren 2015, faqe 95-96)

78.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 5 maj 2015

I dashur shok Xhafer!

Kaloi kohe e gjate shume e gjate qe as me imel me nuk po shkruajm!? por ajo qe eshte me rendesi dhe per ate po te shkruaj qe te di aje mire me shendet. telefoni nuk na linte te harrohemi, edhe pse kurre nuk harrohemi por mos komunikimi po duket se po largohemi....! me shendet si je ti dhe familjen si e ke dhe si po e kalon kohen sepse e di qe ti ke te drejte qe qoft edhe nje germe mos me e shkruar ti ke shkruar shume dhe shkrime te vlefshme dhe shume te rendesishme qe as kush nuk e beri dhe as kurre nuk ka per ta bere, edhe pse nuk ka as nevoje se ti i ke kryer ashtu si duhej kryer dhe si e meriton...prandaj edhe te pershendes dhe UROJ te jesh mire. po ti tash po merresh me mesimin e gjuhes ? dhe ti nuk pushon dhe as nuk rri kote! Ne mire jemi e edhe une por ai varianti lidhur me celularin (viber) per mua ishte shume i rrezikshem gje qe me ndikoj shume me zemren e pata ngusht situaten. jo se e perdora shume pos pak me ty dhe nje vello disa here por ndikoj negativisht....dhe tash nuk po e perdor se ska qe me ben pos ma ndalon levizjen e zemres.

Pershendetje dhe duke te uruar shume-faridini

79.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 5 maj 2015

I dashur shok Faridin,
Uroj të jesh sa më mirë vetë dhe me krejt familjen.
Gjatë punës tënde dhe timen sidomos në këto vitet e fundit (nga 2009 e më tutje) kemi komunikua shumë pasi është bërë një punë e cila dihet. Tani në këtë pauzën e publikimit të shkrimeve edhe niveli i komunikimeve e shënon një rënie por kjo nuk do të thotë se mendojë më pak për kohën e bashkëpunimit me Ty prej njohjes e deri më sot. Mund të thuhet se ndodhë e kundërta.
Disa ngjarje harrohen, ndërsa meditimi e kujtimi për shokët e vërtetë bëhet më i fortë, më i kthjellët, edhe pse kjo nuk shprehet në letra më të shpeshta apo biseda telefonike.

Në shërbimin tim të internetit unë e kam të paguar edhe një telefon fiks (të shtëpisë) por firma kërkon që unë duhet me e ndërrua një ROUTER (i cili) e lidhë kompjuterin me internet dhe telefon, e kjo do të thotë nje punë për ndryshimin e disa kodeve me të cilat më punojn mirë tani për tani kompjuterat dhe telefonat mobil. Ky është shkaku pse e kam shty një punë të tillë, pra ngurrimi që duke e ndreq një lidhje të re mos po shkaktoj pengesa e punë të tjera në këto aparatet që më punojnë.

Unë me familje jam mirë apo shumë mirë. Edhe pas punës me librat, orari im ditor, ritmi i ditës nuk ka ndryshua. Malli për komunikimin e shpesht me të cilin jemi marrë ekziston, është në vendin e vetë. Mundohem me e futë në përdorim kohën që e kam.

Sa për ndonjë shkrim nuk kam diçka konkrete. Kohë pas kohe jam duke i bërë disa lexime e analiza të VEPRËS LETRARE të Jusufit të bërë në Kosovë, pra të para dhjetorit 1979. Të shohim se a do ta kompletoj ndonjë punë në këtë drejtim qoftë edhe si dorëshkrim. Si do të më shkojnë punët në këtë pikë do të njoftoj më vonë, si shok i palarguar dhe i paharruar.

Tema dhe epoka që na lidhë, ashtu siç e ke quajtur KOHE E ARTE, më duket e pastër, e pa njolla, fisnike e cila në një mënyrë apo tjetër do të jep reflektimet e veta, të cilat, pos tjerash do të jenë tema e degëzime të komunikimit tonë edhe në të ardhmen.

Telefonin mobil mos e përdorë, të paktën jo nga afër. Sonte provova me të thirrë në shtëpi por nuk qëllove brenda.

Shumë të fala Xhaferi

80.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 23 korrik 2015

I dashur shok Xhafer!

U gezova shume per shendetin tend dhe te te dashurve tu ne familje. Vertet ka kaluar bukur nje kohe qe nuk kemi komunikuar se paku sa per te qene ne dijeni per gjendjen shendetsore. Prandaj uroi qe shendeti te mos na mungoje e sa per te tjerat ato kur njeriu don ti beje edhe i ben! Pra fjalen e kam te ato qe me se shumeti neve na takoi, ne vecanti neve Ty dhe mua na e kishin nevojen dhe ato ishin shkrimet tona e te gjitha atyre viteve me te stuhishme te kohes! Ato libra te cilat ne i nxorrem ne drite. Pune e madhe u be me librat tone (te tuat dhe te miat) qe nuk mund te quhen vetem libra, por ato jane me fjalen e plot libra te arte vertet libra te arte per kohen e ARTE! Sa per gjendjen aktuale siq po e sheh une nuk po mundem te rri pa reaguar se sipas syrit tim dhe si pas mendimit tim po shoh shume gjera qe une per vete nuk i kam pritur ne kete menyre se si po ndodhe ne Kosoven tone...prandaj kam vendosur qe se paku mos te rri ne heshtje per keto dobesi APO qofshin edhe tradhti qe nuk i deshiroi te jene, por ja qe per fat te keq po ndodhin dhe te kqijat po vazhdojn duke i perseritur te cilat si po duket edhe per nje kohe te gjate nuk do te kann fund....!? I dashur shok, ty nga zemera te uroi se pari shendet dhe pune te mbara dhe suksese te pa fund. Une me shoqen time te shtunen me 25 do te udhtoje per ne Kosove-Shqiperi per pushime dhe do te qendroje deri me 26 gusht 2015. Prandaj ne se ke ndonje porosi, kerkes APO diç te lutem ma thuaj pa ngurrim qe ta kryaj (ne se e gjeje !?) Pershendetje F.Tafallari

81.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 17 nëntor 2015

I dashur shok Xhafer!

Koha po ece dhe per ne ka nje periudhe te gjate qe nuk jemi degjuar, telefoni na la pa folur me gojen hapur...! Sonte vendosa te te shkruaj sa per te ditur se si je me shendet ti dhe mbare familja juaj. Uroj te jesh mire ti dhe te gjithe te tjeret, te familje, si dhe ata te cilet i ke te afermit e tu. I dashur Xhafer e di se ti punone dhe nuk ndalesh por edhe di se qe punone, ti ben pune me vlere te madhe. prandaj edhe te Uroj shendet, suksese dhe shume te mira.! Shok Xhafer jam i detyruar te ta percjell nje porosi nga nje shok i cili do ta beje (shkruaj) nje liber per Zeqir Gervallen, i cili ka kohe qe Jeton ne Amerike. Besoj se e njeh ate neper mes shkrimeve (poezi) qe shkruan ne albaniapress. Pra Kadri Gervalla, ne baze te shkrimeve te librave tu ku ke shkruar edhe per Zeqirin. Ai ka kerkuar qe ti te shkruash edhe per Zeqirin, sepse ai ka mbledhur disa shkrimtar qe ta botoi librin. kadriu ka kerkuar qe shkrimet ti dergojm para vitit ri, pra dy deri tri faqe. Une e kam takuar nje here dhe edhe une do ti shkruaj disa faqe (dy)...ai ma kerkoi adresen e imelit tend por une i thash se kete amanet do ta kryaj, dhe i mora imelin e tij...ky eshte imeli i -kadri-gervalla@hotmail.de-pra shok Xhafer mundeni me komunikuar vet. pershendetje dhe gjitha te mirat. F.Tafallari

82.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 18 nëntor 2015

I dashur shok Faridin,
Mire jam e jemi në gjithë rrethin familjar e ashtu uroj edhe për Ty e gjithë familjen tënde.
Mirë që u lajmërove. Unë e kisha ndërmend me t'u lajmërua (më së voni disa ditë para vitit të ri). Lidhur rastin e Zeqir Gërvallës dhe librit të Kadri Gërvallës dhe mundësisë e kontributit tim në atë libër; thelbi i çështjes qëndron kështu:

Unë Zeqirin nuk e njoh personalisht, do me thënë nuk mund të them diçka që ka të bëjë me ndonjë kontribut në çështje biografike.

Sa i përket veprës se tij letrare, e di se vepra e tij letrare, poetike e krijuar në Kosovë çmohet nga rrethe të caktuara, dhe është çmuar nga persona që i kam njohur, por vetë nuk kam pasur mundësi ta lexoj ndonjë përmbledhje poetike të tij të krijuar në Kosovë.

Vepra e tij letrare poetike, pasi ka dalë në Amerikë, që kohë pas kohe botohet në faqet e albaniapressit më duket e vështirë me e përcjellë për shkak të kllapave të shumta dhe ndërrimit të formës së shkronjave herë të vogla e herë të mëdha, dhe aspekteve të ngarkuara me sugjerime religjioze.

Pra nuk e ndiej veten kompetent me shkrua për veprën e tij letrare.

Për veprën e tij politike, praktike, si shok i Adem Demaçit, nuk mund të shkruaj e të them diçka me vlerë pasi ajo ka të bëjë me një gjeneratë më të hershme.

Për veprën e tij politike, teorike, pra të shkruar nga dora e tij, në formë të artikujve të ndryshëm të botuar në albaniapress (parimisht kisha mund të them diçka sepse njohja personale kur është çështja tek fjala e shkruar, nuk është e domosdoshme), e kam vështirë me shkrua dhe për hir të respektit, më mirë është për mua me e lënë në heshtje.

E them këtë për arsye se në shkrimet e tij politike është vështirë me e gjetë mbrojtjen e një ideje nga fillimi në mbarim dhe të liruar prej kundërthënieve të mëdha. Ndoshta me shkrua artikuj teorik e programatik për çështje politike është vështirë, dhe unë nuk e kam ndërmend me e kritikua pse nuk ka shkruar artikuj të fuqishëm politik.

Zeqir Gërvalla e ka përmendur Jusufin në disa raste dhe kuptime, dhe në ato pika që më është dukur e domosdoshme kam shkruar dhe deklarimet e tij i kam krahasuar me të tjerëve. E kam përmend edhe letrën e Bardhoshit që ia dërgon Sabri Novosellës, ku Bardhoshi e quan Zeqirin – kushëri.

Si përfundim:
-Në ato pika e çështje për të cilat nuk kam shkruar deri më sot, e kam shumë të vështirë që shkruaj edhe në të ardhmen.
-Në ato pika që kanë të bëjnë me Jusufin e Bardhoshin, për ato tema që janë shtjelluar deri më sot, kam shkruar, dhe prej anës time më duken në mënyrë të plotë dhe të cilave nuk kam çka t'ju shtoj.

Besoj se kam mund me u përgjigj në mënyrë të drejtë lidhur me kërkesën e Kadriut. Ti ma ke dërguar adresën e tij elektronike, por unë po ta dërgoj ty këtë letër, dhe t'i ia përcjellë atij mendimet e mia në atë mënyrë që ta shohësh të arsyeshme.

Shumë të fala Xhaferi

83.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 30 dhjetor 2015

I dashur shok Faridin,

Uroi të jeni mirë Ti dhe gjithë familja juaj. Shkrimet tuaja edhe të këtij viti i kam përcjellë deri në intervistën e sotme. Ti po i përcjellë rrjedhat politike më aktivisht dhe po merrë pjesë në debate.

Unë po merrem med disa punë por ato gjatë këtij viti nuk kanë qenë të karakterit politik, por do të thoja kanë të bëjnë me veprimtari historike dhe gjuhësore –linguistike-.

Në anën tjetër këto punime dhe veprime studimore nuk kam pasë as rast e as kërkesë me i zbatue në ndonjë projekt praktik privat apo shoqëror. Të pata shkruar më heret se jam duke punuar me frengjishten, gjermanishten, italishten e spanjishten. Planin që e kam pasë për këtë vit me këto gjuhë e kam kryer, por kuptohet se mendoj me e vazhdua edhe në vitet e ardhshme. Paralel me këto gjuhë mendoj me u marrë edhe me disa gjuhë afro-aziatike. Sa do të mbërrij me këtë punë ende nuk e di.

Të pata thënë me një rast se po mendoj me ia shtua ndonjë faqe librit ”TE FALA S’PO NA COJNË ASNJËHERË” por prapë vendosa me pritë edhe pak me atë punë.

Ndonjë punim për këtë përvjetor nuk kam përgatitë.

I dashur shok Faridin, UROJ QË VITI I RI 2016 të jetë vit i sukseseve për Ty dhe gjithë familjen Tënde!

Shumë të fala Xhaferi

84.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 30 dhjetor 2015

I dashur shok Xhafer!

Keto kohet e fundit kam qene shume me mendime per ty, duke menduar per kohet qe iken dhe sikur po ikin shpejt pa u qmallur... bere mire qe ma Urove vitin qe po vjen, i cili tash me eshte ne prag. Prandaj dua edhe une bashk me familjen ta Uroi 2016 ty me mbare familjen tende te nderuar qe te gezoni shendet dhe suksese e shume te mira ne jete! Uroi per vitin tjeter te kesh shendet te mire dhe te punosh duke pasur edhe me shume suksese se vetem me pune dhe angazhime arrihet e mira dhe per kete nuk kam dyshim se ti ke aftesi dhe je i palodhur, prandaj ska se si mos te kesh sukses. Une vertet po shkruaj dhe falemenderit qe po i percjell... Nuk e di si te them po me shtyn edhe vitet e te se kalueres qe ne as gje nuk kursyam dhe arritem deri ketu ku jemi! Mua me duket se keta sot qe i kemi ne krye po Duan ta rrenojne kete qe u arrit me shume pune sakrifica dhe gjaku i me te mireve u derdh gjithandej,ne trojet shqiptare, kurse keta hajdut sikur po e shkelin po shkelur mbi gjakun e Jusufit te Madh dhe shume e shume deshmoreve te rene....Pra Urime Urime dhe GEZUAR shendet dhe suksese te shumeta. Pershendetjet me te perzemerta Faridini

85.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 21 korrik 2016

I dashur shok Xhafer!

Edhe pse nuk kemikomunikuar me shkrime as me telefona, une per here mendoj dhe komunikoj me mendje per shume gjera bashk me ty si kur ishim bashk ne aktivitete te

perhersheme. Ndaj te gjitha i para mendoj me radhe dhe i kujtoj me shume mall ato vite te stuhishme me ty dhe me Jusufin dhe shok te tjere te aktiviteteve te atyre viteve...Prandaj po te njoftoje se te premten 22.7 do te udhtoje per ne vendlindje per pushime. Ty te UROJ shendet dhe shume te mira e suksese ku do qe te jesh, ashtu edhe te gjithe te afermit qe i ke. Me pershendetjet me te perzemerta per ty dhe gjitha te mirat

Faridini

86.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 17 korrik 2017

I dashur shok Faridin,

Uroi të kesh pushim sa më të mirë.

Librit, duke e lexuar ngadalë, i rash në fund. Pjesën më të madhe të punimeve më ka ra t'i lexoj menjëherë kur janë botuar në internet.

Ti m'i ke dërgua 4 pjesë në e-mail. Atë ditë kur m'i dërgove i pash se erdhën të katërtat por nuk i kam çelë menjëherë. Më vonë kur i hapa e pash se pjesa e 4-të që ka ardhë tek unë është e zbrazët. Pra fili në word kur e hapi nuk e ka asnjë germë të vetme. Në ndërkohë e vazhdova punën me leximin e faqeve të tri pjesëve të para.

Librin, përmbledhjen e shkrimeve, për aspektin tim, po i ndaj në këto grupe kryesore:

1. Në shkrime që kanë të bëjnë me Vëllezërit Gërvalla, Lëvizjen e JG dhe me kohën e veprimtarisë sonë në vitet 1980-1985 (në rastin tim për kohën korrik 1981-korrik 1985) dhe

2. Në shkrime që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me Lëvizjen e JG, ku bëjnë pjesë shkrimet, pikëpamjet e komentet për politikën aktuale.

Para se me e marrë në shqyrtim grupimin e parë, pra pikën nën -1-, po dua ta shqyrtoj qëndrimin tim rreth pikës -2- edhe pse materialet e kësaj periudhe janë më të vona.

Prej vjeshtës së vitit 1985 jam larguar nga veprimtaria e organizuar politike dhe në këtë veprimtari të organizuar nuk jam kthyer më dhe nuk besoj se do të kthehem në të ardhmen. Ka ndodhë që kam shkruar ndonjë letër, më të shkurtë apo më të gjatë për ndonjë shok, kam dhënë ndonjë mendim për çështje të ndryshme, por jo më shumë. Kjo nuk do të thotë se nuk kam bërë asgjë. Përveç ushtrimit të profesionit tim, sipas mundësive dhe kohës, jam marrë me literaturë shkencore, dhe me atë, për aq sa më lejojnë rrethanat, merrem edhe tani.

Me këtë po dua të them se shkrimet që i ke publikuar në internet, për periudhën pas vitit 1985, dhe të cilat nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me Lëvizjen e JG, për disa arsye që do t'i numroj më poshtë, nuk mundem me i komentua, me të dhënë vërejtje, me të dhënë vërejtje konkrete për fjalë e fjali të caktuara dhe me të dhënë sugjerime se si do të ishte më mirë.

Disa nga arsyet pse nuk mundem me i komentue e me ndërhy në mënyrë konkrete në grupin e dytë të shkrimeve të librit të përgatitur:

Faktori kohor dhe gjeografik

Si aktivist i mëhershëm (i viteve 1981-1985) nuk kam qenë aktiv pas vitit 1985. Është traditë e kulturës politike në Skandinavi që aktivistët politik kur largohen nga politika, i shkruajnë kujtimet apo i paraqesin faktet e tyre për kohën sa kanë qenë aktiv, por nuk përzihen në politikat e mëvonshme, me qëllim që gjeneratat e reja të kenë mundësi vetë, pa ndërhyrje të personave të së kaluarës, t'i zgjedhin problemet e kohës së vetë, në mënyrën që ata e gjykojnë më së miri në bazë të programeve për të cilat i kanë marrë votat. Përveç faktorit kohor për mosndërhyrje

unë këtu po e përmendi edhe faktorin gjeografik. Politikanët e Kosovës, si shtet i pavarur, janë zgjedhë na votat e popullit në Kosovë. Unë jetoj në Suedi qe shumë vite, dhe me këtë më duket sikur kam më pak të drejtë me dhënë deklarata (të paktën deklarata negative) për zhvillimet në Kosovë.

Mungesa e deklarimeve direkte ndikon që të mos bëjë as deklarime indirekte

Pasi vetë me emër e me mbiemër e me nënshkrim timin, nuk jam deklaruar në mënyrë direkte për rrjedhat politike në Kosovë, pas vitit 1985, besoj se mund të përmendet si rrethanë lehtësuese dhe të ndikoj në mirëkuptim fakti se pse nuk dua ta bëjë një punë të tillë, pra të deklarohem në mënyrë indirekte.

Me këtë qëndrim timin nuk po dua me të nxitë me bërë qoftë edhe një gabim më të voglin, por as nuk po dua me ta frenua e dobësua shpirtin tënd të iniciativës, dhe as me ta marrë asnjë meritë për ato çështje ku mund ta kesh drejtë, apo nëse koha të jep të drejtë.

Pikëpamje dhe fakte

Lidhur me atë që ta shikoj tekstin me atë vëmendje sikur me pasë qenë libri im. Këtu mendimi lehtë shkon tek metodologjia nga librat e mi për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës.

Në librat e mi ka minimum komentesh e më shumë janë të renditur, krahasuar e ballafaquer citate nga personat e implikuar në ngjarjet e asaj kohe. Edhe librat tuaj: TDHQ, Dhimbje Krenare, Me tre yjet...., etj. kanë më shumë fakte (letra e dokumente) e pastaj komente. Për këtë arsye për mua ka qenë më lehtë me u bazua në fakte dhe analizat që kanë rrjedhë prej tyre.

Ky libër që e ke gati në dorëshkrim, përmban më shumë apo kryesisht komente, d.m.th. pikëpamje personale, të shkruara shpejtë, në bazë të lajmeve të përditshme. Komentet për ngjarje, pikëpamjet e kanë vlerën e vetë por duhet me u bërë dallimi i qartë dhe prerë: Faktet që publikohen vlejnë për të gjithë njësoj, si për armik si për shok. Në paraqitjen e fakteve askujt nuk i falet me gabua. Ndërsa pikëpamjet janë personale, edhe pse mund t'u referohen deri diku fakteve, interpretimi është personal. Pikëpamjet personale munden me qenë të drejta apo të pranueshme për dikend e më pak të pranueshme për dikend tjetër. Edhe me gabua në pikëpamje, dmth mos me ia qëllua 100%, është e lejueshme, dhe shumë individ që kanë ndikua në miliona njerëz të tjerë, për shkaqe të ndryshme i kanë ndryshua apo korrigjua pikëpamjet e tyre në kohë të ndryshme mvarësishht prej asaj se çfarë faktesh kanë pas në dispozicion.

Për këtë arsye metoda që e kam përdorë në librat e mi nuk mundet me u përdorë në këtë libër.

A është heshtja pajtim me ato gjëra që na duken të këqija?

Heshtja ime (në dukje) nuk do të thotë se pajtohem me të gjitha ato që ngjajnë në Kosovë apo në viset shqiptare. Mundohem me i përcjellë disa procese, por kjo nuk më obligon që në çdo kohë e në çdo situatë të marrë qëndrim dhe të deklarohem publikisht për të gjitha ato që ndodhin. Në radhë të parë më duhet, me i kushtua kohë dhe me e plotësue edhe me disa fakte serinë e 20 librave për Lëvizjen e JG.

Unë nuk kam aspirata tjera me kontribua më tepër me shkrime se sa ato që kam bërë për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës. Lajmrimi im në debate do të jetë vetëm i karakterit historik për periudhën që e njoh me themel e në imtësi. Eshtë aspiratë e imja po ashtu që, ajo që them t'i plotësoj kërkesat rigoroze të shkencës. Ajo çka e kamë bërë, edhe sikur të mos e shkruaj asnjë germë të vetme në të ardhmen, më mjafton dhe më frymëzon për tërë jetën.

Politikën dhe veprimtarinë politike më shumë i konsideroj si ART.

Në kohra të ndryshme, prej vitit 1981 e deri më sot, ka raste kur disa njerëz më kanë ofendua për motive nga më të ndryshmet, e diametralisht të kundërta:

1- Në disa raste më kanë ofendua se pse po i hyjë një pune kur nuk jam në gjendje me i dalë zot; e

2- Në disa raste pse nuk po i hyjë një pune kur jam personi më i qëlluar e më komptent për me i dalë zot.

Lëvizja e Jusufit ka qenë organizatë ilegale, dhe për mua ka qenë e pamundur me i trokitë asaj në derë, në ndonjë adresë e me ju bërë kërkesë e me ju thënë a po më pranoni. Janë anëtarët e saj që më kanë njoft me vite (në vitet 1970-të), dhe ma kanë ofruar mundësinë me kontribua duke më pyetur mua se a dua të jem anëtar i Lëvizjes.

Në vitin 1985 Hyseni e Abdyli vijnë në Zvicër. Ata, në korrik 1985, e shkruajtën atë letrën për bashkim, dhe unë asaj letre iu kam përgjegj si e ka merituar. Shumica e shokëve që kam qenë në kontakt me ta iu kanë mbështetur Hysenit e Abdylit, dhe unë në këtë drejtim, pa kurrfarë inati e dëshprimi, iu kam uruar sukses dhe gjitha të mirat.

Nga ajo kohë e deri më sot e kam vazhdua punën time në atë mënyrë që më është dukur më e dobishmja, si për natyrën e temperamentin tim personal, ashtu edhe për interesin shoqëror.

Fakti pse nuk mundem me të dhënë vërejtje konkrte për fjalë e fjali të caktuara për pjesën e shkrimeve që nuk kanë të bëjnë me Lëvizjen e JG, nuk më pengon me t'i dhënë disa vërejtje të përgjithshme.

Disa vërejtje të përgjithshme për pjesën që nuk ka të bëjë me Lëvizjen e JG

Ti je kritik pa përjashtim, në të shumtën e rasteve ndaj të gjitha partive dhe udhëheqësve të tyre me përjashtim të Vetëvendosjes. Fitohet përshtypja sikur çdo gjë që e bëjnë njerëzit në pushtet është e keqe dhe çdo gjë që e bënë opozita është e mirë.

Më duket sikur beson tepër në lojën e dinakërinë, zanatin e papastër të politikës së shumë politikanëve. Nga kjo nuk do të befasohesha, nëse do të zhgënjehesh prapë, në të njëjtën mënyrë nga opozitarët e sotshëm nëse ata vijnë në pushtet nesër. Në politikë ka shumë gjëra që mvaren nga faktori shqiptar, por ka edhe shumë gjëra që mvaren prej faktorit ndërkombëtar e rrethanave ndërkombëtare. Kjo nuk vlen vetëm për Kosovën, por për të gjitha shtetet, prej më të voglave deri tek supefuqitë. Kur politikanët, luftojnë për vota, me djallëzinë dhe kopilinë më të madhe, çdo gjë në botë, edhe ekzistencën e ajrit dhe lindjen e diellit mundohen me ua paraqitë votuesve sikur ato janë të mvaruna vetëm e vetëm prej tyre. Kur të vijnë pushtet me mashtrime të tilla, dhe kur i renditin dështimet, për të gjitha falimentimet i akuzojnë rrethanat e jashtme, faktorin ndërkombëtar, rrethanat ndërkombëtare, rrethanat meteorologjike, astronomike e kosmike.

Këtë lojë të politikanëve në moshën tonë duhet me e pasë të qartë dhe nuk duhet me ra në kurtha të tilla. Gabime të tilla rinisë munden me iu falë.
Kritikat ndaj përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare i shoh të gabueshme. Nuk po them se ata nuk kanë gabime. Por ta kesh të qart, këto janë vetëm sugjerime të përgjithshme.

Për me hy në raste konkrete e fjali konkrete, unë kisha dashtë me i pas mundësisht sa më komplet të gjitha deklaratat, të gjitha fjalimet e programet e të gjitha partive e politikanëve. Këto nuk i kam të mbledhura, as nuk jam i interesuar me i mbledhë tani, as nuk jam i interesuar me i mbledh në të ardhmen, pasi kjo punë do të kërkonte tepër kohë të madhe prej meje.

Kohën e jetën që e kam në dispozicion përpara (sa të jetë shkruar) kam dëshirë me e përdorë për punë tjera.

Është mendim i pranuar prej botës së personave të kulturës e të librit, se askush nuk e dinë me saktësi (100%) se cili libër në të ardhmen do të del më i miri e cili më pak i mirë. Shijet e lexuesve dhe autorëve nganjëherë janë të ngjashme nganjëherë dallojnë shumë.

Në librin e tij "Gjurmë e fërkem", Ibrahim Kelemendi e ka cituar letrën time që ta kam dërguar më 3 qershor 2009, prej të cilës po e marrë këtë pjesë:

”Për Nuhi Sylejmanin nuk kisha me shkrua më keq se sa e meriton. Ndaj njerëzve që nuk merren me shkrime dhe ndoshta nuk kanë aftësi për t’u mbrojtur duhet treguar kujdes më të madh."[Letër dërguar Faridin Tafallarit, 3 qershor 2009]

Këtë pjesë I. Kelmendi e komenton me këto fjalë:
I.K: ”Këshilla për Nuhi Sylejmanin ngjason në farsë, meqë vetë është marrë shumë, me inat, si hakmarrës, sepse Nuhiu i hidhëruar që ka humbur betejën për “trashë¬gimtar” të Jusufit ia ka zbuluar shumë keqbërje udhëheqësit XhD.”

Me komentin e vetë I. Kelmendi ka dashtë me thënë se unë jam munduar me të penguar në veprimtarinë politike dhe në shkrime, nga motivi i xhelozisë, duke të thënë unë ty mos u merr me Nuhi Sylejmanin, se mos po të dalin librat e t’u të përsosur, e vetë jam marrë shumë me te. Librin e I. K. “Gjurmë e fërkem” e kam demontuar dhe deshifruar ashtu si librin Atentatet dhe do ta jap përgjigjen në momentin e duhur. Por për ty po e sqaroj djallëzinë e tij të mësipërme.
Kur ta kam shkruar letrën më 3 qershor 2009, as unë e as ti nuk e kemi pasur në dorë librin “Vrasja e trefishtë”. Për librin “Vrasja e trefishtë” jam informuar pothuajse një vit më vonë. Edhe sikur ta kisha pas në dorë librin e Abdullah Prapashticës, të nënshkruar nga Nuhi Sylejmani, prapë se prapë nuk kisha me të nxitë kundër Nuhiut, për një libër që ai nuk e ka shkruar vetë, dhe për shkakun se sulmet më të ndyta në atë libër drejtohen kundër meje dhe jo tjetërkujt.
Shumë të fala Xhaferi

87. Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 18 korrik 2017

I dashur shok Faridin,
Të uroj pushime sa më të mira. Po ta dërgoj edhe njëherë letrën time, e cila në word del se i ka 4243 fjalë.
Më parë ke shkruar shumë për punën e për kohën/ vitet 1981-1984, dhe për atë periudhë e kam pas lehtë me ndërhyrje konkrete e me propozime konkrete.
Në këtë libër pesha kryesore ka të bëjë me me një periudhë kur unë kam qenë krejtësisht jashtë aktiviteteve politike. Kjo ka ndikuar tani, dhe ndikon edhe në atë ardhmen që unë asnjëherë nuk mundem me ndërhy në tekste të ngjashme (pasi as vetë në emër timin nuk kam shkruar publikisht asnjëherë) për ato periudha e kohë që nuk i njoh mirë.
Pra është e vërtetë se nuk kam ndërhy në tekst, por disa sugjerime t’i kam dhënë dhe, të takon ty a ke dëshirë e me i marrë parasysh apo jo.
Po ta dërgoj letrën prapë. Sugjerimet e vërejtjet i ke me ngjyrë të kuqe.
Shumë të fala Xhaferi

88.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 1 korrik 2019

Tungjatjeta Xhafë!
Librin "Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit" e lexova me përkushtim të madh. Ndonëse e kam lexuar pak shpejtë, më duhet të them se libri më pëlqeu shumë. Në libër, e vërteta historike, shpaloset dhe i përplaset në fytyrë së atij që shkruan sipas devizës "rrno për me rrejtë", por edhe që e zbardh errësirën si drita e diellit. Libri "Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit", Ibrahim

Kelmendi, del pa maskë dhe kjo është një arritje mjeshtërore... Pra, urime dhe suksese të tjera në të ardhmen!

Të fala e gjithë të mirat!

Asllani

89.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 24 korrik 2019

Diskutim në Facebook

Shaban Muharremi Koha është anije që nuk e hedh kurrë spirancën , ashtu siç po dëshmohet e provohet me fakte të padiskutueshme , se Xhafer Durmishi , jo që ka hedhur spirancën (pas botimit të 20-të librave) për ketë ngjarje , por po vazhdon të shpalosë edhe fakte e te vërtetat tjera , të cilat do t'i mbesin trashëgim , brezave , historisë e historiografisë kombëtare shqiptare dhe studiuesve të mirëfilltë . Njëkohësisht , ai po i demaskon intrigat, prapaskenat dhe përpjekjet për të kamufluar e manipuluar me ngjarjen e 17 janarit 1982 në Shtutgart të Gjermanisë dhe më gjerë. Ai (XH.D.) po prezanton dhe ballafaqon fakte dhe jo zhurmë sterile të ati/atyre , që n ‘brendinë e tyre janë n'panikë , por në opinion luajnë rolin , herë të shokut , e herë të viktimës . Nuk ngurroj të them , se Xhafer Durmishi është njëri nga shokët e rrallë të Jusuf Gërvallës, që me përpikëmëri të jashtëzakonshme, i ka afruar opinionit shqiptarë materiale të shumta, që në të gjitha format, shtrijnë për toke mashtruesit, sidomos gënjeshtarët që me të bamat e tyre kanë dëmtuar interesa nacionale. Duke i lexuar faktet, lexuesit të nderuar mund t'i them: Mos qajë, mos u hidhëro, vetëm kupto, sepse, ata që nuk e mbajnë mend të kaluarën, janë të dënuar ta përsërisin.

Shaban Muharremi – Sheradin Berisha

Shaban Muharremi T'falemnderit që me etiketove dhe njoftove për ketë botim të ri. N'fakt, unë e vërejta se ju e publikuat të Pashtriku.org dhe tani njoftuat edhe në facebook. T ‘them të drejtën, librin e kam marrë nga Xhaferi me 28.06. 2019, e kam lexuar dhe po përgatitesha ta publikoj, pjesë-pjesë, në faqen time në Facebook, këtë edhe do ta bëjë, po megjithate, respekt dhe gjithë të mirat për punën tuaj Sheradin Berisha.

Shaban Muharremi – Ibrahim Kelmendi

Shaban Muharremi: Me qenë se ti s'le temë pa e degraduar deri në maksimum, unë tash, po e marr me mend se sa "leht" e kanë pasë ata që kanë pasë punë me ty, tani e 37/38 vite më parë dhe asesi nuk dua të bie në nivelin tënd destruktiv, nihilist, përçarës, narcisoid dhe rrënues të çdo përpjekje për liri, tash e katër dekada. Fundja , ata (Jusufi) t'kanë lënë testamente me shkrim, që ty as dy Akademitë tona (Tiranë e Prishtinë) s'kanë me mund me të dal në ndihmë dhe unë si "lis i njomë" s’të kam faj.

Megjithëse , gjatë këtyre viteve miqësi në Fb-uk, ne të dy s'jemi pajtuar kurrë, unë të premtoj se në çdo çast dhe në çdo kohë, nëse konstatoj se t ‘kam hy në hak kam m'et kërkue falje publikisht.

Tani, ti po e sheh se, s'ia arrinë të me bësh as avokat të Xhaferit, e as "MYHYB" qorr tëndin, ashtu si ia paska arritë "Rrobaqepësi" atë botë, sipas teje dhe disave, që si duket janë penduar për të bëmat e tyre, pas 50-të viteve. Edhe n ‘ketë pikë, s'di a po me duket, apo po dal i pastër si loti, jo si ti e ke pastruar S. Blakajn, po i pastër si kristali. Nga ky këndvështrim, ti si ideolog e strateg i të gjitha kohërave, pasi që vazhdimisht po tenton të me ngulfatë me "Rrobaqepësin", se organizata e tij paska qenë "Fiktive", se ikja e tij paska qenë e kurdisur dhe ai paska arritë t'i

mashtroj Jusufin, e përralla tuaja si zakonisht, tregona tani, jo me fjalë , po prezantoje me shkrim "Marrëveshjen" e 17 janarit mes Jusufit, Kadriut dhe teje si "kurorë e bekimit" të saj. Pra , prezentoja opinionit "Marrëveshjen" e jo mua, sepse ti "Rron" për të treguar të vërtetën dhe vetëm të vërtetën .

Mos harro se, lojën tënde herë si mik e herë si armik e kam vërejtë prej se jemi miq në Fb dhe këto falenderime s'peshojnë më asgjë. Po thua se bllokimi nga ana ime nuk e bllokon të vërtetën tënde, mirë shumë. Ti po harron një fakt se bota është si teatër: Vjen, shikon dhe shkon. Thonë se më mirë është të kafshosh në jetë, se sa ta hash gjuhën tënde orë e çast, sepse e kaluara ka vetëm një bukuri; pse është e kaluar dhe asgjë tjetër.

Po Ibrahim Kelmendi, "afër lisit të thatë digjet edhe lisi i njom", këtë se luan topi, po unë jam shumë krenar që s'jam djegë afër ndonjë "Cungu" të kalbur me kundërmim dhe kjo meritë shkon në dy adresa, të Xhafer Durmishi dhe Asllan Mihaliqi (Muharremi) që m 'kanë bërë lis me rrema, e se kapë dot flaka (po t' lavdërohem pak se s'bahet nami). S'ka kuptim m'et bllokue tani që veç sa dole nga "burgu i rëndë" i Fb-ut . .

Shaban Muharremi – Ibrahim Kelmendi

Shaban Muharremi: S'ka ma keq se inati me i pri mendjes! T 'vetmen letër që ti ke dëshirë me e komentue dhe të cilës, ti pikërisht, përpiqesh t'i japësh konotacion negativ, sepse Jusufi, normal që është dashur t'ia shpjegoj faktin se zbulimi ka ndodhur nga konaku i tij, pra ti e përdorë për inate t 'vjetra me të, e mos të flasim tani për letrat tjera që t'i ka lanë testament, e të cilat, ti po mundohesh me i mbulue me batanije. Unë e njoh edhe atë letër dhe pikërisht edhe ajo letër, Jusufin e nxjerr njeri me vlera të pakontestuara, HERO të kompletuar, përveç nga ti dhe disa spurdhjak që gagarisin e gulçitën n 'pritën e parë.

Historinë dhe t 'vërtetën politike për viganin e kombit Jusuf Gërvalla, e ka vulosë për jetë e mot njëri nga shokët e afërt dhe besniku i tij i madh, Xhafer Durmishi.

Mos harro, edhe ti ke shumë merita; shkrove "Atentatet" për qefet tuaja dhe sektit tënd, "zbulove vrasësin" ashtu si e zbuloj shteti kriminal jugosllav me Tanjugun, fil pas vrasjes: "U vranë shqiptarët mes vete" dhe e shfajësove për mrekulli vrasësin e vërtetë. Pastaj, demaskove të gjithë "tradhtarët" e mbrendshëm dhe të jashtëm të te gjitha organizatave, ku ti ke qenë "melaqja" e parë, pasi pjesën dërmuese të OMLK-së i rreshtuan një nga një nëpër burgjet jugosllave, po që ty, e për ty, të gjithë kanë qenë të dyshimt ose spiun, sepse sipas teje, të gjithë të ikurit nga Kosova është dashur të vinë e të dhënë "gjevapë" para babës Sheh, apo t'ia puthin dorën e të marrin "izën" e veprimeve të mëtejme, ndërsa tek ata që t'ka hasur "sharra n 'gozhdë" ti ke bërë çmos që t'i linçosh dhe shantazhosh.

Për këto dhe shumë "merita" tjera, vërtetë, e ke pyet vetën ndonjëherë; kush ke qenë dhe kush je ti që u bie në qafë njerëzve të pafajshëm, që e kanë dashur dhe kanë punuar për liri e atdhe pa pompozitet e me urtësi?

Edhe një "meritë" e veçant që shkon n'adresën tënde, është fakti se; ti edhe pas 37-të vjetësh s'ke ndryshuar fare. Atëherë, ku po mbetët maksima jote "Sa rrojmë mësojmë"?

Më tragjikja dhe më e keqja, për ty, është se, ti ke qenë i bindur se s'ka me guxue kush me t'a kthye fjalën. Këtë e kam provue edhe vet n' ballafaqimin e parë në Fb-uk, kur m'u vërsule me miq e familjarë, më shumë për t'me frikuar se sa për të thënë diçka me mend.

E sheh se "dardha ka bisht" - mund të mashtrohesh për një kohë se e frikon dike, por jo përgjithmonë. Ti mund të shantazhosh, frikosh e linçosh shumë kë, siç ke bërë, po Xhaferin e Asllanin kurrë. Demagogjinë e shumë spurdhjakëve e kam bartë mbi supe për disa kohë, po pa fajin tim, derisa filluan të vjellin, po prapë se prapë, kam pasë shpresë dhe besim në zjarrin dhe dashurinë time për liri. E di për shumë kë se sa në t ‘vërtetë peshojnë e sa guxojnë. Guximi , thonë është virtyt i mirë, po qëndrimi është edhe shumë më i mirë.

Racionalja ime qëndron n ‘këta kufij, derisa ti nuk ndryshon kursin e debatit .

90.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 8 prill 2020

I dashur shok Xhafer!

Sa here mar letrat e tua ta them sinqerisht ndihem shume i gezuar... Ne u njohem ne nje takim me te madhin Jusuf Gervalla, dhe ti je per mua i afert dhe i rrespektuar sikur shoket e rralle qe i kam me te afermit e mi te ideali. E si mos te je ti i afert kur na bashkoj njeriu i pare i Levizjes Nacional Clirimtare te Kosoves dhe viseve Shqiptare ne ish Jugosllavi, dhe ai ishte Jusuf Gervalla! Materialin e atij shokut dhe njeherit edhe antar i LNÇKVSHJ. Po u kenaqa kur paraqiten se jane ne Levizjen e larte permendur, materiali (letren) e lexova me kenaqsi dheune dot thoja se çdo gje qe ka te beje me Jusufin duhet publikuar...Shok Xhafer dot ishte mire qe ta dergoje edhe ne Albaniapress, se une gjej shkrime te Sheradinit qe i dergon ne Albaniapress dhe ja botojn, ndoshta me vones por kurr nuk behet von.

Pershendetje Faridini

91.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 2 maj 2020

Mendime të shprehura në Facebook

Mendime nga Shaban Muharremi

Është kënaqësi e dyfisht kur vlerësohet puna (n ‘këtë rast e Xhaferit e Asllanit) nga ata që e dinë t ‘vërtetën dhe nuk hezitojnë ta thonë . Për Xhaferin , çka do që të them është pak , gjithmonë mbetët në kuotën pak...pak..pak !

Them kështu e do ta përsëris çdo herë sepse: Xhafer Durmishi është vlerë dhe krenari kombëtare e veçant! 20-të veprat e tij për ngjarjet në Shtutgart dhe më gjerë, janë dëshmi e pakontestuar dhe e pastër si loti që ai po i le historisë tonë. Personaliteti i tij kalon baladën për Gjergj Elez Alinë, ndërsa pena e tij, është penë e Marin Barletit të kohës moderne.

E mbaj mend si sot, kur flitej e debatohej për suksesin e tij në Sh. Fillore në Prilluzhë; Xhaferi me Diplomë t'Vukut...nxënës si Xhaferi....i urtë dhe i sjellshëm si Xhaferi etj...etj. Fati e deshti që disa vite më vonë, dy familjet tona u lidhën shumë fort dhe kjo miqësi vazhdon tash e më shumë se 40-të vite. Fat i dyfisht është fakti se, unë kam qenë n ‘kontakt të vazhdueshëm me Xhaferin dhe ndoshta shpesh edhe e kam bezdisë me faktin se kam insistuar që ai të flas. Mund të jem nga të parët, ndoshta fare i pari që kam pasur fatin t'i kem librat e tij para se ato të publikohen te Pashtriku.org dhe Albaniapress-i.

Përveç kësaj, me mija orë biseda telefonike, pajtime e mospajtime të shpeshta, analiza ditore, javore e mujore dhe jam mahnitur para fakteve të paraqitura nga Xhaferi. Ai me ka shpjeguar

detalisht se përse s'ka folur dhe shkruar për aq vite. Këtë fakt duhet ta kenë kuptuar tanimë edhe ata që i kanë përgjakur kokat në Kalanë e Jusuf Gërvallës ! Fat tjetër, është fakti se e bëmë Republikën dhe, përgjithmonë, barbaria kanibale serbe theu qafën! Shteti dhe bashkimi kombëtar do t 'bëhet hap pas hapi, deshtën apo jo shumë shqiptarë, shumë hileçar, tinëzar e rrogëtar, njerëz të shitur e tradhtar të lindur.

Mendime nga Asllan Mihaliqi

Të faleminderit për vlerësimin e shokut tim, Xhafer Durmishi, i nderuar Zeqir Rama! Ta marrësh barrën dhe përgjegjësinë e vazhdimit të punës së nisur së bashku me Jusuf Gërvallën s'ka qenë një punë që çdokush nga anëtarët e LNÇKVSHJ-së ka qenë ta bëjë. Xhafer Durmishi, ndonëse në moshë shumë të re, e ka përmbushur me përgjegjësi të madhe këtë detyrë. Unë për vete jam shumë krenar që kam pasur nderin të jem pranë tyre në përpjekjet tona për lirinë dhe çlirimin e Kosovës sonë të shtrenjtë.

92.Mendime nga Zeqir Rama, 2 maj 2020

Të përmendet emri i Xhafer Durmishit dhe të mos i them dy fjalë për të sikur sikur "tradhtoj" respektin tim të madh për të.

Që të ndihem rehat me vetveten me plotë gojë them se Xhafer Durmishi është një veprimtar me cilësi specifike njerëzore, me vlera të veçanta atdhetare, me një intelekt të rrallë ku shpalon aftësitë analitike nga të cilat kanë dalë vizionet e tij, që edhe sot mund të merren, si referenca edhe për të ardhmen e vendit.

Por, modestia, guximi intelektual dhe sinqeriteti i njerëzve tanë dhe i Xhaferit shkakton anashkalim dhe margjinalizim nga qarqet e hajdutërisë dhe injorancës politike në pushtet të rrëmbyer padrejtësisht.

Xhaferit i uroj të gjitha të mirat duke shpresuar se Xhaferi ka shumë për të na dhënë mbi karakterin dhe orientimet e lëvizjeve politike në vend dhe jashtë!

Për Asllanin nuk do them asgjë për shkak se të jesh bashkëveprimtar me Xhaferin do të thotë shumë.

Asllan të falenderoj për këtë rast që të them diç për të Madhin Xhafer Durmishin!

Shëndet dhe të gjitha të mirat! (Facebook)

93.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 8 janar 2021

Tungjatjeta!

Ne jemi mirë dhe mirë po kalojmë.

Shkrimin e lexova dhe dëgjova sonte, pas bisedës me Shabanin, i cili edhe më pyeti se a kisha lexuar shkrimin dhe dëgjuar debatin nga mbledhja e Qendrës Ekzekutive.

U gëzova shumë që kishe arritur ta gjesh këtë dokumet të kohës, i cili vërteton drejtësinë e qëndrimeve tua dhe të disa shokëve lidhur me të vërtetën e madhe se Kadriu dhe Ibrahimi nuk kanë qenë të ftuar natën e 17 janarit 1982... Është një mrekulli që kjo e vërtetë thuhet edhe nga gënjeshtari, Ibrahim Kelmendi.

Natën e mirë e gjithë të mirat,

Përshëndetje të përzemërta, Asllani.

94.Letër nga Shaban Muharremi për Xhafer Durmishin, 10 prill 2022

Përshëndetje edhe për ty Xhafer ,

Po , është e vërtetë se kemi komunikua tej mase , ngase unë kam pasur shumë nevojë me i sqarua shumë gjëra që nuk i kam ditur , pastaj kjo u bë edhe si rutinë . Po nga gjithë kjo unë kam pasur fat dhe privilegj të veçant që jam informuar nga dora e parë , e sidomos që shkrimet tuaja i kam marrë ende pa u bë publike . Për ketë te jam shumë mirënjohës ! Komunikimet kanë qenë të shumta , po mendoj se ia ka vlejtë , edhe pse e kuptoj se ti ke qenë më i ngarkuar , sepse ke pasë edhe njerëz tjerë që të kanë marrë kohë . Sido që të jet puna , koha iku po ishte kohë e një suksesi të madh , kohë ku u shpalos e vërteta e madhe , kohë ku përfundimisht u varros gënjeshtra . Kjo koha që iku shpejt ka edhe anën tjetër të medaljes ; aty ti ke shpalosë gjithë madhështinë , dijen dhe talentin që ke mbajtur në sirtarin tënd për vite të tëra , sirtar për të cilin unë s'jam lëkundur kurrë . Në fakt , ti ke qenë timonieri i gjithë rrjedhës ,ndërsa unë ta kam hedhë ndonjë gurë në Kalanë që ti e ke zbërthye detajisht . Borxh nuk me ke asgjë sepse unë të gjitha i kam bërë vullnetarisht , vetëm për ta dhënë një shtytje në misionin dhe detyrën tuaj ndaj shokëve me të cilët ke vepruar bashkarisht . Pra një shtytje , për ta zbardhë të vërteten e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës . Ketë punë e ke bërë me sukses të jashtëzakonshëm , andaj librat tuaj me fakte dhe dokumente të pamohueshme do t'i mbesin historisë . Respekt të pafund për ty dhe punën tuaj !

Shumë të fala edhe nga unë !

Shabani

95.Letër nga Xhafer Durmishi për Faridin Tafallarin, 16 tetor 2022

Përshëndetje i dashur shok Faridin,

Uroj të jeni mirë ne të gjitha.

Arsyeja e vetme pse t'u kam lajmruar para dy ditësh ka qenë një fjalë e jotja që ma pate thënë në një bisedë dicka në stilin:

-Pse nuk po lajmrohesh ndonjëherë.

Unë mirë po kaloj.

Kërkesën tënde për me t'i dërguar librat e mi në formë elektronike nuk e kam harruar. Shkaku i vonesës është se tekstin ekzistues nuk e kam ndryshuar por kam shtuar pjesë e citate të reja nëpër faqe të ndryshme.

Shkak tjetër është se këtë vit i kam pasur disa punë e plane me disa përkthime të cilat janë duke ma marrë tërë kohën.

Shumë të fala Xhaferi

96.Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 16 tetor 2022

Pershendetje shok i dashur Xhefer.

E para me gezon se je mire me shendetin e te tjerave jam i sigurt se me vendosmerin tende dot ju perballon. Per mos lajmrimin ta them te drejten po kam deshire qe mos me u shkput se kemi nje periudhe te gjate qe jemi shok e miq... Per librat nuk ka pse te ngutesh por kur te kesh kohe mi dergon qe ti kem ne arkivin tim.

Naten e mire tung!

97.Mendime të publikuara nga Kadri Rexhaj, 17 janar 2023

Kadri Rexhaj: "*Veprimtari dhe publicisti Xhafer Durmishi, deri më sot, për mendimin tim, është studiuesi më i përkushtuar dhe më objektiv i veprimtarisë atdhetare të Jusuf Gërvallës. Në projektin e tij madhor ai ka punuar me vite të tëra, ka bërë punë me durim, me kujdes, me objektivitet, me dashuri, me shpirt dhe me mendje, sa rezultatin e mirë që ai personalisht e ka arritur me më shumë se 20 veprat e tij kapitale, jam i sigurt, nuk do ta arrinte asnjë institucion shkencor. Nëse në veprat e shkruara të derisotme kushtuar Jusuf Gërvallës (ndër të cilat llogaris edhe librin tim) rrëfejnë autorët e tyre për Jusufin, në veprën e Xhafer Durmishit ndodhë e kundërta: në tryezën e improvizuar të ballafaqimeve për tema të caktuara, flet personalisht Jusuf Gërvalla, i cili me dëshmitë e tij autentike, të lëna me shkrim, qartë dhe kuptueshëm argumenton veprimtarinë e vet, tashmë të vulosur edhe me gjak."*
(Facebook, 17 janar 2023)

98.Mendime të publikuara nga Xhemajl Shatri, shkurt 2023

Xhemajl Shatri: "Nuk ka gjë më të turpshme kur një burr 70 vjeqe fëlliqë me gojë si një rrugaq. Unë e di se ti je shumë brutal dhe përdorë fjalor shumë të ndytë të shkollës së UDB-së.

Është më tepër se kriminale të shajsh familjen e heroit të kombit Jusuf Gërvalla vetëm se zonja Gërvalla e thotë të vërtetën për ty. Unë e di se ty të vret shumë e vërteta që e thotë zonja Suzana Gërvalla për ty dhe të bëmat e tua kundër heronjve të kombit Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Pjesa më e errët e jetës tuaj është roli i juaj dhe i shqipfolësve akoma i pazbuluar për vrasjen e tre heronjve të shtetit të Kosovës Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla të vrarë më 17 janar 1982 në atentatin terrorist të UDB-së famëkeqe!

Ibrahim, ti e din që mua nuk më bëjnë përshtypje shkrimet e tua e as sulmet e ulëta kundër meje. Edhe ti e din se unë nuk jam viktimë e askujt e aq më pak e Novosellëve apo Xhafer Durmishit. Askush nuk është më shumë se ti mall i skaduar e i kompromituar në Lëvizjen Çlirimtare të Kosovës.

Dihet botërisht se Xhafer Durmishi më shumë se askush tjetër, të ka varrosë politikisht e kombëtarisht duke ta hjekë maskën prej një gënjeshtari e komplotisti, që mision të vetëm ka pasë përçarjen, gënjeshtrat kundër Jusuf Gërvallës dhe Bardhosh Gërvallës. Padyshim Xhafer Durmishi është arkiva më autentike për veprimtarinë kombëtare të Jusuf Gërvallës dhe Bardhosh Gërvallës, i cili i ka shkrua mbi 20 libra për Lëvizjen Çlirimtare të Kosovës.

Ti e din edhe vetë se me i pas 1000 vjet jetë nuk mundesh me e mbërri Xhafer Durmishin, as me veprimtari atdhetare e as me libra të shkruara.

Për Xhafer Durmishin nuk do të them shumë se nuk jam avokat i tij, por një gjë dua të them, se sa e kam njohur nga afër kam krijue mendimin se është njeri shumë i ngritur kombëtarisht dhe intelektualisht. Xhafer Durmishi është njeri i besës dhe i shkencës, është specialist i librave, dhe është atdhetar i flakt i çështjes kombëtare. Me qenë në shtatë palë dryna në burg, ai ndihet gjallë. I tillë ka qenë gjithmonë Xhafer Durmishi, e di se ai e ka ndihmua shumë materialisht luftën e Kosovës, UÇK-në dhe popullin e Kosovës!" (Facebook, 13 shkurt 2023)

99.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 3 mars 2023

Tungjatjeta Xhafë!

Përkundër modestisë tënde kur shkruan: "*Për njerëzit e arsyeshëm dhe që bazohen në fakte ky libër nuk ka qenë i domosdoshëm*", mendoj se librat tua kanë qenë shumë të domosdoshëm për lexuesin dhe studiuesin shqiptar të tanishëm dhe të atyre që do të vijnë nesër. Them kështu sepse numri i atyre që e njohin të vërtetën lidhur me çështjet e shtruara nuk është edhe aq i madh. Pos kësaj, e vërteta është sulmuar e përbaltur nga shumë gënjeshtarë, të cilët janë demaskuar edhe nga vet Jusuf Gërvalla. Unë për vete kam mësuar shumë nga librat tua dhe të jam shumë mirënjohës dhe falënderues për to. Mendoj se pa punën tënde, e vërteta do të mbahej në errësirë dhe se do merrte shumë kohë gjersa ajo të dilte në dritë. Pa këto libra, publicistika dhe mendimi shqiptar do të ngelej shumë më i varfër. Prandaj mendoj se lexuesi shqiptar është me fat që ka në dorë librat tua. Jam i sigurte se ata, kështu si unë do të jenë falënderues dhe krenar për punën tënde.

Të faleminderit për letrën e dërguar!

Përshëndetje e të fala,

Asllani

100.Letër nga Asllan Muharremi për Xhafer Durmishin, 13 mars 2024

Tungjatjeta Xhafë!

Punën që ma ke dërguar me 8 mars, më në fund, arrita ta lexoj. Qysh në fillim më duhet të them se analiza, nga ana jote e letrave të Jusuf Gërvallës, më pëlqeu shumë. Mendoj se lexuesi ka pasur nevojë për shpjegimet tua shumë të nevojshme dhe shumë të vlefshme. Tani pas kësaj pune të shkëlqyeshme, që e ke bërë, lexuesi do ta ketë shumë më të lehtë ta mësojë të vërtetën e punëve të Jusuf Gërvallës dhe shokëve të tij. Për këtë punë të shkëlqyeshme unë të përgëzoj dhe uroj nga zemra! Mos harro se për këtë punë do të falenderojnë dhe përgëzojnë edhe brezat e ardhshëm të lexuesve dhe historianëve që ta lexojnë këtë libër me vlerë të jashtëzakonshme.

Përshëndetje të përzemërta dhe të fala, Asllani

101.Mendime të publikuara nga Kadri Rexhaj, prill 2024

Kadri Rexha

Autorin Xhafer Durmishi e përgëzoj për librin LUFTA PËR LIRI
në letrat e Jusuf Gërvallës janar 1980 - janar 1982.

Letrat e Jusufit, edhe pse të kuptueshme për ata që donë të kuptojnë, pas një mjegulle të krijuar qëllimisht sidomos dekadën e fundit, paskan pas nevojë për analizë dhe për sqarim. Një punë të kësaj natyre Xhaferi e ka bërë edhe në serinë e librave kushtuar veprimtarisë politike, organizative dhe atdhetare të Jusufit, por shqyrtimi, analiza dhe sqarimi konkret i letrave të tij në këtë libër ka dhënë kurorën thelbësore të përkushtimit njerëzor, shoqëror, solidar, përbashkues, organizues, atdhetar, idealist dhe flijues të Jusuf Gërvallës. Fatbardhësisht autori i librit ka qenë afër Jusufit, me ideal, me zemër dhe me mendje, e ka njohur mirë atmosferën e kohës, bashkëpunimin e çiltër njerëzor të Jusufit, mosmirënjohjen dhe mashtrimet në prapaskenë që iu kanë bërë atij, ka mbetur besnik i njeriut dhe i veprës atdhetare të Jusuft, ka qenë nxënës i mirë i Mësuesit të madh, prandaj puna e tij ka dhënë rezultate për lakmi në ndihmesë historisë kombëtare që do të shkruhet nesër. Pa studimet e Xhafer Durmishit, pa kujtimet e publicistit Faridin Tafallari dhe pa përkushtimin shkencor të historianit Sheradin Berisha shumëçka nga jeta, nga vepra dhe nga lufta për liri e Jusuf Gërvallës e zhvilluar në mërgim do të harrohej, do të tjetërsohej dhe do të përvetësohej.



Kadri Rexha

Puna e Xhafer Durmishit kushtuar veprimtarisë atdhetare të Jusuf Gërvallës do ta ketë mirënjohjen e brezave! (Facebook, prill 2024)

102. Letër nga Shaban Muharremi, 5 maj 2024

Me 05 maj 2024 Marly

Përshëndetje Xhafer ,

Fillimisht te përgëzoj për librin e fundit "Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës", janar 1980 - janar 1982 .

Vet titulli i këtij libri është goditës dhe pikant për shumë kë, titull që dëshmon dhe që lufton ende për t'vërtetën e pamohushme ndaj atyre që kurrë se kanë pasur qëllim lirinë, por përmes manipulimeve, gënjeshtrave dhe egove të tyre, për përfitime politike e materjale i kanë bër dëme të mëdha kësaj ngjarje historike. Aq më keq, se shumë nga ata janë shtirë si shokë të vërtetë të Jusufit.

Fatmirësisht , Jusufi ka lënë shumë dëshmi që demaskojnë në tërsi këta manipulatorë, këta gënjeshtarë, plagjiatorë e skajshmërisht t'paaftë.
Këto dëshmi që na i la Jusufi, janë brumi ma i mirë të cilat ti i ke marrë në dorë dhe nga ky brum ke bër kryevepra të vërteta për historinë dhe brezat.
Andaj, libri yt i fundit është kurorë, është tjegulla e fundit në çatinë e Kalasë së Jusuf Gërvalles. Pse po e them ketë? Sepse sinteza jote aq e sinkronizuar, aq bindëse aq e kapshme dhe aq reale, ka bërë që gjithë atë zhurmë mediatike ta shtrini për toke njëherë e mirë. Ka bër që këta zvarranik të heshtin dhe të mos thonë më asnjë fjalë. Kjo dëshmon se puna jote e vlefshme ka dhënë rezultate që do ta lakmonte edhe vet Jusufi. Fatmirësisht që ti je marrë me to dhe nuk kanë mbetur në dorën e atyre që këtë çështje e kanë bër lëmsh që as vet s'ia gjejnë fijen !

Xhafer ,
Megjithë këte , një dukuri tjetër që të lartëson shumë si njeri, si shokë i vërtetë i Jusufit, si intelektual me vlera të larta, ësht edhe fakti se ti je treguar shumë fisnik, zemërgjerë, altruist i pashoq edhe me oponentet tuaj dhe Jusufit. Je treguar i gatshem për të dhënë sqarime me aq gjakftoftësi dhe përkushtim, thua se mes jush s'ka pasur kundërthënje për asgjë. Edhe lexuesi i rëndomtë mund ta vrejë këtë mirësjellje, ketë përkushtim dinjitoz duke ballafaquar fakte që i ke lënë pa tekst edhe vet gënjeshtarët.
Prej që te njoh kam besuar në ty si person, n'aftësinë, n'atdhetarizmin, patriotizmin dhe punën tuaj me përkushtim, pa bujë e eksponime.
Është krejt tjetër çështje se dallgët e jetës t'kanë përplasë me valët e saj, këtu e dyzet vjet, mirëpo pikërisht këto valë, ky ideal i vërtetë, kjo drejtësi, t'ka nxjerrë në brigjet e përjetësisë, krah për krah me Jusufin.
Jam i bindur se kur të bëhet Shqipëria që kemi dashur dhe duam, ky shtet do ta vulosë me vulën apostolike punën tuaj të çmuar, ndërsa shkresurinave deviante dhe në thelb manipulative do t'ua tregoj rrugën kah koshi i plehrave. Akademikëve e studiusve të ardhëshem e të paanshëm u ke lënë punë te madhe.

Respekt të pafund nga unë!
Shaban Muharremi

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit
01. Protesta e Aspirata - 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës-2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-2012
06. Pa taktizime-2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-2012
09. Luga dhe Lugina-2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-2013
13. Argatët agresiv-2013
14. Pa trazime-2013
15. Skena-2013
16. Emër që u bë traditë-2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-2013

18. Testamenti-2013
19. Ilustrime-2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, janar 1980-janar 1982, 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, 2025
25. Forma të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës I-2023
26. Forma të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës II-2023

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror*." (14 janar 1981)

Shaban Muharremi: "*Xhafer Durmishi është vlerë dhe krenari kombëtare e veçantë, është yll që do t'u shndris brezave! Edhe 25 veprat e tij për ngjarjet në Shtutgart dhe më gjerë, janë dëshmi e pakontestuar dhe e pastër si loti që ai po ia le historisë tonë. Personaliteti i tij kalon baladën për Gjergj Elez Alinë, ndërsa pena e tij, është penë e Marin Barletit të kohës moderne."*

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i tetëmbëdhjetë gjuhëve të huaja.

Xhafer Durmishi-Skenderi

==========

XHAFER DURMISHI-SKENDERI - Janar 2025